

PLANPROGRAMI I PARË MËSIMOR

për
Arsimin e të Rinjve në Bioetikë



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

UNESCO Chair
In Bioethics
(Haifa)

" The translation of the First Syllabus for youth Bioethics Education in Albanian language and this publication had been realized by the Kosovo Unite of the UNESCO(Haifa) Chair in Bioethics"

Perkthimin e Planprogramit te Pare Meesimor per edukimin e femijeve ne bioetike nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe e ka kryer Njesia Kosovare e Bioetikes ne UNESCO (Haifa)Chair Of Bioethics.

PLANPROGRAMMI I PARË MËSIMOR
për

Arsimin e të rinjve në bíoetikë

Kryeredaktor
Amnon Carmí

Drejtoreshë e bordit të redaksisë
Míroslava Vasinova

Këshilltari kryesor
Gíacomo Sado

Redaksia
Luígía Melillo, Alessandra Pentone, Claudio Todesco,
Anna María Traversa, Hanna Carmí

Redaktimi grafik
Tommaso D'Agostino, Ornella Salvetti

Redaktimi gjuhësor
Cecília Tudor, Alba O'Neill

Pilot Projekt për arsimimin e të Rinjve në Biotikë

Ndihmuar nga

Qendra Evropiane për Biotikë dhe Cilësi të jetës
Njësia Italiane e Biotikës në UNESCO

dhe realizuar në bashkëpunim me

universitetin e Napolit, Pegaso

Plan programi i parë për Arsimimin e të Rinjve në Bioetikë

Hyrje

Në vitin 2001 UNESCO ka themeluar Njësinë e Bioetikës në UNESCO (Haifa) dhe ka autorizuar atë për avancimin e arsimit të etikës në institute akademike. Kjo njësi ka nxjerrë në kadencën e parë tetë libra udhëzuese, dhe ka themeluar më shumë se shtatëdhjetë njësi në të pesë kontinentet. Njësia e parë është krijuar në Itali në Qendrën Evropiane për Bioetikë dhe Cilësi të Jetës nën udhëheqjen e Kryesueses së saj, Dr. Miroslava Vasinova. Njësia italiane është përfshirë për më shumë se dhjetë vjet në aktivitete të arsimit bioetik me fëmijë dhe të rinj. Kjo njësi aktive ka ndërmarrë misionin e promovimit të një projekti pilot të plan programit të parë për Arsimimin e Rinisë në Bioetikë.

Në vitin 2005 UNESCO ka miratuar Deklaratën Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut. Deklarata mishëron një varg parimesh bioetike.

Në vitin 2008 UNESCO ka përpiluar Silabusin e Programit të Arsimit në Etikë: Kurrikulën Bërthamë për Bioetikë (KBB) që përfshinë pesëmbëdhjetë parime të Deklaratës. KBB i përgjigjet pyetjes: Çfarë duhet mësuar? Njësia ka zhvilluar një metodë të re për arsimimin në etikë që i përgjigjet pyetjes: Si duhet të mësohet bioetika. Metoda e re përbëhet prej disa komponenteve themelore.

Para së gjithash, elimini apo braktisja e fjalimeve të gjata si mjete të mësimit për arsimimin në etikë. Së dyti, fillimi dhe thirrja për pjesëmarrje aktive të studentëve në diskutime dhe vendimmarrje. Së treti, mbledhja e këtyre rasteve nga vende të ndryshme dhe varieteti i kulturave për të formuluar një metodë universale të mësimdhënies që i përshtatet çdo vendi. Në fund, pas diskutimeve në klasë, arsimtarët mund t'u japin nxënësve një definicion apo shpjegim etik të përmbledhur.

Njësia ka nxjerrë një sërë librash udhëzuese për mësimdhënësit dhe nxënësit duke përdorur metodën e re që është përpilua nga ekspertët e saj. Nëpërmjet rasteve studimore, nxënësit mund të mësojnë, para së gjithash, për të zhvilluar ndjeshmërinë për problemet etike dhe për të përshkruar një konflikt etik; së dyti, për të identifikuar dhe analizuar parimet etike dhe vlerat që janë të rëndësishme për rastin, dhe së treti, për të nxitur vendim-marrjen etike në praktikën e kujdesit shëndetësor. Qëllimi është të krijohet një mjet dhe një platformë për pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin e vendim-marrjes.

Projekti i arsimit i UNESCO-s është i dizajnuar që të krijojë një kulturë të referencës etike ndaj doktorit të pacientit. Për të arritur këtë qëllim, projekti duhet të trajtojë popullata të ndryshme: mësimdhënësit, edukatorët, studentët të mjekësisë, mjekë dhe madje edhe fëmijë e të rinj. Të rinjtë e brezit tonë do të jenë qytetarët e brezit të ardhshëm. Tradita socio-kulturore e etikës nuk mund të krijohet në klasat e shkollave mjekësore. Studentët që arrijnë në këto klasa mbajnë në shpinën dhe në zemrat e tyre historinë e tyre personale. Kjo histori përbëhet nga vlerat që ata kanë krijuar nga rinia e tyre më e hershme në familjet e tyre, në mjediset e tyre sociale, në kopshtet dhe shkollat e tyre. Aktivitete edukative në fazë të avancuar të studimeve akademike mund të jenë të efektshme në qoftë se dhe varësisht se në çfarë mase paraqiten me metodologjinë e duhur tek popullata më e re. Ky supozim më ka shpjeguar të shqyrtoj dhe filloj me krijimin e një programi të trajnimit për grupmoshat më të reja. Për të realizuar idenë, kam autorizuar Njësinë italiane që të mbledhë dhe të themelojë në Itali një grup të edukatorëve dhe profesionistëve të tjerë të cilët janë pajtuar që të përgatitin nën mbikëqyrjen time vullnetarisht një libër për bioetikë për fëmijë dhe adoleshentë. Ky libër bazohet kryesisht në metodologjinë

e arsimore të UNESCO-s. Përveç kësaj, nga autorët u kërkua që të krijojnë mjete mësimore të përshtatura për grupmosha të ndryshme.

Libri u referohet 12 parimeve të etikës së përgjithshme. Këto parime pranohen nga të gjithë, ato merren nga Deklarata Universale e Bioetikës dhe të Drejtave të Njeriut të UNESCO-s. Silabusi i librit është përpiluar për popullatën e përgjithshme të fëmijëve dhe të rinjve. Libri u referohet katër grupeve të ndara dhe ofron materiale të ndryshme udhëzuese për çdo grup, varësisht nga grupmosha të ndryshme: fëmijët e vegjël (3-5), fëmijët e shkollës fillore (6-10), adoleshentët (11-14) dhe adoleshentët tjerë (15-19). Libri është shkruar për arsimtarët dhe edukatorët. Ai përfshin materiale (tregime dhe lojëra) dhe shpjegime metodologjike për përdorimin e këtyre materialeve. Njësitë e librit janë shkruar nga autorë të ndryshëm, emrat dhe adresat e të cilëve paraqiten në fund të çdo njësie.

Libri është shkruar si një botim i parë pararendës. Njësia e bioetikës në UNESCO udhëheqë një Departament Arsimi dhe një forum ndërkombëtar të mësimdhënësve. Libri do të përcillet tek qindra profesionistë të këtyre dy institucioneve, dhe të gjitha Njësitë të Kryesisë. Nga këta ekspertë do të kërkohet të studiojnë materiale, të shqyrtojnë ato, të përdorin ato, dhe t'i bartin kritikën e tyre dhe sugjerimet për stafin e redaksisë të projektit drejt realizimit të botimit të dytë të librit. Së bashku me ushtrimin e këtij projekti prijatar, Kryesuesi do të studiojë dhe monitorojë pasojat e përdorimit të këtyre materialeve mësimore në mesin e të rinjve.

Prof. Amnon Carmi

Menaxher dhe Kryesues i Njesisë së Bioetikës së UNESCO-s (Haifa)


Deklarata Universale mbi Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut

[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 3

Dinjiteti Njerëzor dhe të Drejtat e Njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.



NJËSIA 1

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimi etik nr.3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Kutia e sekreteve”

Objektivat e mësim nxënies

- T’u jepet mundësia fëmijëve që të ngjallin kureshtjen e tyre, dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre për të përshkruar shqisat e tyre të prekurit, dëgjimit dhe nuhatjes. Pas një trajnimi të mjaftueshëm dhe kur fëmijët të jenë në gjendje t’i ndjejnë objektet material duke i përdorur shqisat e tyre (p.sh. të prekurit, dëgjimi dhe nuhatja) do të jetë e mundshme që nxënësit të njoftohen me koncepte abstrakte.

- Krijimi i kushteve të duhura për ta menduar një botë të re, të përbërë nga ndjenjat dhe parimet, për të cilat duhet të jemi të njoftuar. Kalimi prej një bote materiale në një botë jo-materiale është thelbësore për të qenë në gjendje që në të ardhmen të vetëdijesohemi lidhur me dinjitetin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Për shembull, edhe nëse dashuria ndaj lirisë nuk mund të preket apo të nuhatet, ajo mund të përshkruhet dhe shprehet në njëmijë mënyra të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e lirisë apo nevojat kryesore të tyre.

Loja

Shembulli nr. 1

Në “kutinë e sekreteve” ne do ta fshehim një zare të gëzoftë. Ne do t’i pyesim fëmijët që ta përshkruajnë se çfarë do të prekin, duke ua bërë, nëse është e nevojshme, disa pyetje (për shembull: A është e fortë apo e butë në prekje? Çfarë arome ka? Çfarë forme ka?). Është me rëndësi që mësimdhënësi të mbledhë të gjitha komentet, përgjigjet dhe supozimet, dhe i shmanget ndërhyrjes gjatë lojës sa më shumë që është e mundur.

Shembulli nr. 2

Ne do ta fshehim në kuti një fletë të kuqe të letrës. Qëllimi ynë është që ta përshkruajmë këtë ngjyrë. Në fillim fëmijët, të cilët janë mësuar të ndër-veprojnë me objekte të ndryshme materiale duke i përdorur organet e tyre të shqisave, do të hutohen. Do të varet nga

mësimdhënësi se si do t'i orientojë fëmijët në përdorimin e të dhënave dhe shembujve për ta nxitur imagjinatën e tyre. Supozimi i ngjyrës paraqet pikën e kthimit që dëshmon se fëmijët kanë arritur t'i përshtaten botës materiale si dhe asaj jo-materiale, ku edhe fillon procesi i parë i abstraksionit. Secila ngjyrë ekziston në botën që na rrethon, por nuk ne nuk mund ta prekim, ta dëgjojmë dhe ta nuhasim apo ta shohim atë si ngjyrë të veçantë.

Shembulli nr. 3

Në kutinë e sekreteve, ne do ta fshehim ndjenjën e frikës.

Në këtë rast, ne mund të vendosim në kuti një foto të një fëmije të frikësuar apo një maskë që përfaqëson një përbindësh. Mësimdhënësi do t'i udhëzojë fëmijët duke u ofruar atyre disa të dhëna. Frika mund të ndërlidhet me ngjyrën (për shembull, ngjyra e zezë në kulturën perëndimore), deri tek shprehja e fytyrës, si për shembull, kërcëllima e dhëmbëve apo ndjenja e dridhjes nga frika. Mund edhe të tregohen tregime për fantazma apo përbindësia për t'i frikësuar fëmijët, në mënyrë që t'i përgatisim ata për lojën. Në fund, do të ishte mirë që të shënohen vërejtjet dhe ndjenjat e fëmijëve në një pllakat apo dërrasë të zezë, të shprehura jo vetëm gjatë lojës por edhe kur ata fillojnë ta ndjejnë frikën, për të paraqitur procesin e të menduarit të tyre. Kjo metodë mund të ndihmojë në “përfaqësimin” dhe “personalizimin” e frikës në grup, ndërsa pllakati mund të pasurohet me vizatime të frikës që i bëjnë fëmijët apo foto të tyre ku pasqyrohet mënyra se si e shprehin ata frikën.

Shembulli nr. 4

Në kuti ne do ta fshehim lirinë, të paraqitur, për shembull me një foto apo vizatim të një zogu duke dalë nga kafazi. Gjatë dhënies së shpjegimeve, (me këtë rast duhet të ofrohen disa të dhëna), mësimdhënësi mundet, nëpërmjet ngjyrës (ngjyrë e bardhë dhe e verdhë që i ngjanë dritës apo ylberit, varësisht nga kulturat e ndryshme), lëvizjes (frymëmarrja e thellë, vrapimi), një shprehje e fytyrës (buzëqeshja, shenjë lehtësimi), angazhimi i të gjitha mjeteve për të përshkruar diçka jo-materiale. Nëpërmjet shqisave tona, ne e dimë që jemi pjesë e racës njerëzore. Në fund të këtij ushtrimi, do të ishte mirë që të merren në shënim të gjitha vërejtjet e fëmijëve në pllakat apo dërrasë të zezë. Duke vepruar në këtë mënyrë, do të jetë e mundshme që të merren të gjitha komentet që fëmijët i bëjnë gjatë lojës së supozimit. Atëherë do të bëhet e qartë se çfarë është liria dhe si mund të paraqitet ajo nga ana e grupit (në pllakat do të jetë e mundshme që të shtohen vizatimet të cilat i bëjnë fëmijët apo fotot e tyre kur ata e “shprehin” lirinë).

Metodologjia e mësimdhënies

Qëllimi i kësaj loje është shumë i thjeshtë: të zbulohet se çfarë fshihet në “kutinë e sekreteve”. Lojën e fillojmë duke përdorur shqisën e të prekurit: secili fëmijë e ka mundësinë që ta fus dorën e vetë në kuti dhe të provojë, duke e prekur objektin, t'ia qëllojë se çfarë objekti fshihet në kuti. Përderisa secili fëmijë e shprehë mendimin e vetë, mësimdhënësi i mbledhë të gjitha informatat, i shënon ato dhe ofron copëza të informatave deri sa të zbulohet/identifikohet/njihet objekti i fshehur.

Pastaj, ne do ta hulumtojmë shqisën e të dëgjuarit. Shqisat e fëmijëve do të stimulohen duke përdorur objekte që lëshojnë tinguj e që mund të dëgjohen kur e shkundim kutinë, dhe, si në ushtrimin e fundit, shqisa e tyre e nuhatjes do të stimulohet duke i nuhatur objektet. Ekziston mundësia që të fshihen objektet që mund të stimulojnë më shumë se një shqisë në të njëjtën kohë. Kohëzgjatja e këtij aktiviteti duhet të definohet sipas asaj se sa shpejtë fëmijët do ta qëllojnë objektin, nivelin e tyre të koncentritimit/lodhjes dhe, natyrisht, nivelin e vështirësisë

për t'ia qëlluar se për çfarë objekti bëhet fjalë.


Hapi i ardhshëm do të jetë më i ndërlikuar, e që është përshkrimi i “objekteve jo-materiale”: Në kuti do të jetë e fshehur një vizatim apo një foto që në njëfarë mënyre e paraqet një ndjenjë apo parim. Fëmijët do të vetëdijesohen lidhur me botën jo-materiale e cila është e pasur me vlerat themelore të domosdoshme në jetën e tyre.

Ky aktivitet mund të përdoret me fëmijët e dy grup moshave të ndryshme (3-5 vjet) dhe (6-10 vjet): objektet, ndjenjat dhe parimet e fshehura në kuti do të kenë, natyrisht, nivele të ndryshme të vështirësisë, të përshtatura varësisht nga mosha dhe kapacitetet e fëmijëve.

Materialet mësimore

Krejt çfarë na nevojitet është një kuti kartoni me madhësi mesatare, ku ne mund t'i vendosim objektet të cilat duhet t'i qëllojmë. Vrima në kuti nuk bënë të jetë më e madhe se dora e një fëmije. Kutia duhet të jetë e mbyllur nga të gjitha anët tjera. Kohë pas kohe, do të ishte mirë që të zgjedhim se çfarë objekte apo koncepte do të qëllohen....

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com



NJËSIA 2

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimet etike nr. 3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Arti & llojet tjera.”

“Prej se ka filluar lufta në mendjet e njerëzve, mu në mendjet e njerëzve duhet të ndërtohet mbrojtja e paqes”

Kushtetuta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, 16 nëntor 1945, preambula.

Objektivat e mësim-nxënies

- Duke e pasur parasysh kuptimin më të rëndësishëm të këtij koncepti, arti paraqet të shprehurit kryesor të qenieve njerëzore dhe thelbin e tyre. Nëpërmjet formave të gjëra të tij, arti është në gjendje të shfaq në aspektin real parimet dhe emocionet, të cilat artisti i përkthen në një gjuhë universale dhe të përdorshme më anë të pikturës, skulpturës, poezisë, muzikës, vallëzimit, etj. Shpesh arti është mënyra e vetme për të komunikuar në mendjen tonë, për ta shprehur vetveten, kështu që arti nganjëherë bëhet shembull dhe vërejtje për njerëzimin në përgjithësi.

- Të mësuarit e artit me anë të mjeteve artistike për ta lartësuar dinjitetin e qenieve njerëzore, të drejtat dhe liritë themelore, për t'i nxitur njerëzit që jo vetëm ta zhvillojnë kreativitetin e tyre por, më veçanërisht, ta njohin të shprehurit universal të artit në identifikimin dhe transmetimin e vlerave dhe parimeve.

Loja

Shembulli nr. 1

Ekzistojnë një mori e punimeve artistike që paraqesin imazhe, në mënyrë simbolike ose jo, që na e kujtojnë idenë e paqes, lirisë, solidaritetit, e të ngjashme. Ne i kemi përzgjedhur disa shembuj të kryeveprave që mund të përdoren për t'i paraqitur disa parime etike dhe për t'i transmetuar ato tek fëmijët nëpërmjet vizatimeve, të bëra me ngjyra të ndryshme siç janë ngjyrat tempera, flomastera dhe ngjyra dylli. Riprodhimi i një kryevepre për çdo fëmijë paraqet një mundësi për të menduar dhe për t'u përqendruar për të krijuar në mendjen e vet një imazh konkret të cilin mund ta ndërlidhë me një parim abstrakt. Për më tepër, do të ishte mirë që fëmijët si grup ta krijojnë një kryevepër: imazhi do të mund të kopjohej apo modifikohej duke e personalizuar atë si një vendim të grupit. Secili fëmijë do ta bënte një pjesë të saj, si një mozaik, duke e mbështetur idenë e bashkëpunimit dhe solidaritetit, duke e vizatuar parimin e lirisë apo paqes, dhe duke dëshmuar se në jetën reale kontributi i individit është i nevojshëm.

Ne i kemi përzgjedhur dy kryevepra të Pikasos (Pëllumbi, 1949, dhe Fëmija me Pëllumb, 1901) për ta paraqitur paqen, si dhe një nga Pëllumbat e Magritte-s për ta paraqitur lirinë, si dhe “Pema e Jetës” e Gustav Klimt (1905) për ta paraqitur ciklin e jetës. Ne mund të “varim” në këtë pemë, foto të vogla të fëmijëve të grupit me qëllim që ta bëjmë më personale.

Natyrisht, shumë piktura të artistëve tjerë mund të merren parasysh, dhe ne duhet të harrojmë t’u sqarojmë se çfarë jemi duke riprodhuar dhe pse po e riprodhojmë atë (për ta “bërë të dukshëm” parimin me të cilin ndërlidhet) dhe gjithmonë duke theksuar se, si gjatë vizatimit apo krijimit të një mozaiku në grup, paqja, liria dhe të drejtat e njeriut mund të arrihen vetëm me kontributin e çdo njeriu.

Shembulli nr. 2

Poezia mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të transmetuar thellësisht vlerat etike dhe për të kultivuar respekt për të drejtat e njeriut. Jeta e disa burrave dhe grave do të jetë emblematike për t’i lartësuar parimet e tilla si dinjiteti njerëzor, respekti për të tjerët, përkushtimi për paqe dhe liri.

Ne i kemi zgjedhur dy persona me reputacion universal, jeta e të cilëve ka qenë shembull, siç është Nëna Terezë nga Kalkuta dhe Mahatma Gandhi. Duke e lexuar, duke e mësuar dhe duke e përvetësuar një nga poemat, mund të përdorët për t’ua mësuar grupit, në bazë të moshës dhe karakteristikave të grupit, idetë e prezantuara.

Nëna Terezë nga Kalkuta: JETA

Jeta është mundësi, përfito nga ajo. – Jeta është bukuri, adhuroje. – Jeta është lumturi, shijoje. – Jeta është ëndërr, realizoje. – Jeta është sfidë, ndeshu me të. – Jeta është obligim, përmbushe atë. – Jeta është lojë, luaje atë. – Jeta është e shtrenjtë, kujdesu për te. – Jeta është pasuri, ruaje. – Jeta është dashuri, kënaqu me të. – Jeta është mister, kuptoje atë. – Jeta është premtim, përmbushe atë. – Jeta është dhembje, tejkalaje atë. – Jeta është këngë, këndoje atë. – Jeta është betejë, pranoje atë. – Jeta është tragjedi, përballu me te. – Jeta është aventurë, sfidoje atë. – Jeta është fat, krijoje atë. – Jeta është shumë e çmuar, mos e shkatërro atë. – Jeta është jetë, lufto për te.

Mahatma Gandhi – Zbulojeni dashurinë

Merre një të qeshur dhe dhuroja atij që kurrë nuk ka qeshur.

Merre një rreze dielli dhe bëje të fluturojë atje ku sundon errësira.

Merre një lot dhe vendose në faqen e atij që kurrë nuk ka qarë.

Merre guximin dhe vendose në shpirtin e atyre që nuk mund të luftojnë.

Zbulojë jetën dhe përshkruajua atyre që nuk mund ta kuptojnë atë.

Merre shpresën dhe jeto në dritën e saj.

Merre mirësinë dhe dhuroja atyre që nuk mund ta dhurojnë atë.

Zbulojë dashurinë dhe bëje atë ta shoh botën.

Shembulli nr. 3

Derisa dëgjojmë muzikë është e mundshme që t’i edukojmë nxënësit dhe të transmetojmë vlera etike. Muzika në të gjitha llojet e veta paraqet para së gjithash një harmoni të pastër: prej muzikës klasike e deri tek muzika pop kemi një numër të pakufi mundësish për të zgjedhur. Ne i zgjedhim tri këngë me melodi që njihen në gjithë botën dhe tekstet e tyre që i kemi të regjistruara në kokat e secilit person. Këto fjalë të mrekullueshme mund të jenë një mundësi për të reflektuar dhe menduar. Këngët mund të mësohen edhe në versionin e tyre origjinal, mirëpo ne duhet gjithmonë ta shpjegojmë kuptimin e tyre. Në fakt, çdo këngë apo poezi duhet të paraqitet duke e shpjeguar tekstin ose duke e prezantuar qëllimin e autorit kur e ka krijuar

atë. Shpjegimi duhet, pak a shumë, të thjeshtësohet varësisht nga mosha apo karakteristikat e grupit.

IMAGINE - John Lennon

PËRTEJ YLBERIT – muzika e Harold Arlen, teksti i E.Y. Harburg

FLUTURON NË ERË - Bob Dylan

Shembulli nr. 4

Fëmijëve u pëlqen shumë të shprehurit artistik të vallëzimit. Edhe më këtë rast, duke llogaritur në zgjedhjen e mësimdhënësit si dhe imagjinatën e fëmijëve, është e mundshme që të improvizohet , për shembull, vallëzim fëmijësh derisa e përsërisim poezinë vijuese.

GIANNI RODARI - Memo


Në fund, të gjithë e përqafojmë njëri tjetrin. Ne mund të përdorim pjesë të ndryshme të muzikës, madje edhe muzikë klasike (si për shembull, valsën e luleve të Çajkovskit apo pjesë tjera nga opera e tij "the Nutcracker" apo nga opera e Mozart-it Flauta Magjike, etj.), dhe të përgatiten pak a shumë koreografi të thjeshta duke u kapur për dore, duke u afruar njëri me tjetrin për të kujtuar vëllazërinë dhe paqen ndërmjet njerëzve.

Metodologjia e mësimdhënies

Kjo njësi u ofron mësimdhënësve dhe nxënësve të tyre një varg të mundësive për t'i kuptuar dhe shprehur parimet themelore etike. Gjëja më e rëndësishme është se secili aktivitet nuk është qëllim në vetëvete. Sipas moshave të ndryshme dhe karakteristikave të grupit, është e mundshme që të ndiqen shtigje të ndryshme, nga ato më të thjeshtat e deri tek ato më të ndërlikuarat. Nganjëherë mund të paraqitet si kryevepra e autorit, jeta dhe idealet e tij/saj, apo thjesht duke u përpjekur që të riprodhohet vet kryevepra, madje edhe në versionin e personalizuar nga fëmijët, në mënyrë që të jetë më e përdorshme për ta.

Alessandra Pentone

alesspent@hotmail.com



NJESIA 3

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimet etike nr. 3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Giorgio dhe qentë e tij”

Objektivat e mësim-nxënies

- Vëzhgimi i dimensioneve të zhvillimit personal, shoqëror, intelektual dhe socio-etik.
- Zhvillimi i rrugës së të mësuarit në drejtim të identitetit, autonomisë, kompetencës dhe qytetarisë duke zhvilluar identitetin personal, dhe duke qartësuar perceptimin e nevojave të tyre personale dhe ndjenjat, dhe duke ngjallur interesim në historinë e tyre personale.
- Të shprehurit e emocioneve të tyre, ndërlidhja me bashkëmoshatarë, zhvillimi i emocioneve të tyre në lidhje me familjen dhe marrëdhëniet shoqërore, duke marrë një qasje bashkëpunuese me të tjerët, duke e jetuar një jetë të qetë, dhe duke respektuar të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar zëri i tyre dhe për të shprehur opinionet e tyre.

Rasti

Në fshatin e lumtur dhe plotë gjelbërim të quajtur Pallapalla, ku jetojnë kafshë jashtëzakonisht të bukura, jetonte një djalë i quajtur Giorgio, i cili dukej si një këpurdhë e vogël me një kapelë të madhe, sepse ai e kishte kokën shumë të madhe.

Që nga mosha e re, ai e kishte të vështirë të shoqërohej me fëmijët e tjerë, sepse ata e ngacmonin për kokën e tij të madhe.

Përveç kësaj, shokët e tij mendonin se ai ishte person i mbyllur në vetvete dhe jo-social, ndërsa pamja e zyrtë dhe e pikëlluar e Giorgio 's nuk e lehtësonte shoqërimin me te. Ai shpesh qëndronte mënjane nga frika se nuk do të pranohej, edhe pse do të donte të luajë dhe të argëtohej me shokët e tij.

Mirëpo, kur ishte vetëm në shtëpi, ai kryente shumë punë: e ndihmonte babanë të copëtojë dru, ngjitej në lisa për të mbledhur gogla, ai që në gjendje ta ndërtojë një kasolle në pemë me ndihmën e nënës dhe babait, por, mbi të gjitha, ai i donte qentë shumë të cilët vraponin tek ai dhe e përshëndetnin me entuziazëm. Një ditë, dy qenë duke lehur i ndiqnin shokët e tij, të cilët nga frika filluan të ikin. Giorgio menjëherë ndërhyri dhe për t'i qetësuar qentë duke i përkëdhelur dhe puthur ata. Pastaj thirri shokët duke u thënë që t'u ofrohen të dy kafshëve të cilat, si me magji, pranuan me kënaqësi të përkëdheleshin nga fëmijët.

Që nga ajo ditë, të gjithë fëmijët e kërkonin Giorgio, duke e ftuar që të luaj me ta. Ndërsa gjatë lojërave, Giorgio u tregonte atyre për gjitha punët që ai i bënte në shtëpi, dhe kështu e fitoi respektin dhe admirimin e tyre.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Mësimdhënësi i fton fëmijët që të shprehin opinionet e tyre lidhur me Giogio dhe shokët e tij, duke i shprehur edhe emocionet e tyre.

Fëmijët

- Edhe unë e kam kokën e madhe: shoku im Martini, i cili duket si një top i madh, e thotë këtë...
- Edhe unë kam telashe kur luaj me shokët e mi, sepse ata më thonë se jam i ngadalshëm dhe nuk mund të luaj...
- Në shtëpi, nëna gjithmonë më bërtet sepse kur luaj unë bëj shumë zhurmë...
- Mirëpo, unë qëndroj në shtëpi me shokët e mi, dhe i tregojmë njëri tjetrit shumë tregime.
- Pastaj vjen nëna ime dhe i dëgjon të gjitha tregimet tona...
- Babai nuk më dëgjon sepse ai nuk ka kohë. Ai thotë se unë flas marrëzira, ndërsa nëna më thotë se duhet ta pastrojë dhomën...

Afër shtëpisë sime është një fëmijë që qanë çdo ditë sepse ai dëshiron të ketë një mace. Mirëpo, prindërit e tij nuk duan të dëgjojnë fare për këtë...Ata i thonë se nuk duan kafshë shtëpiake në shtëpi...

Fazat e aktivitetit:

- Aktivitete të shkurtra që realizohen lehtë dhe që ngjallin interesimin e fëmijëve;
- Aktivitete të artikuluar dhe të diferencuara që u mundësojnë fëmijëve që të zhvillojnë strategjitë e tyre specifike të mësim-nxënies;
- Aktivitete të strukturuar dhe progresive që bazohen në atë se çfarë nxënësit tashmë kanë mësuar e që u mundësojnë fëmijëve t'i ngritin njohuritë dhe shkathtësitë e tyre; lojëra simbolike; imitim/modelim; eksperimentime/zbulime; luajtja e roleve.

Faza I

- Biseda të lira por të orientuara, me qëllim të identifikimit të preferencave të fëmijëve kur flasim për studimin e natyrës dhe kafshëve.

Faza II

- Përmbyle diskutimin duke i përzgjedhur personazhet e preferuara të fëmijëve në tregim.
- Përgatite një listë me preferencat e secilit fëmijë.
- Krijimi i karaktereve të përzgjedhura me anë të aktiviteteve manipuluese. Manipulimi është mjet për t'i dhënë kuptime tjera materialit në shfrytëzim duke e përdorur fantazinë dhe imagjinatën. Kur fëmija është në gjendje të thellohet në një aktivitet, në fund ai/ajo do të jetë i/e lumtur dhe i/e kënaqur, edhe pse puna e tij/saj nuk e ka marrë formën përfundimtare. Pra, rëndësia e aktiviteteve manipuluese është para së gjithash, në proceset kreative dhe imagjinuese që nxiten nga materiali në shfrytëzim.
- **Eksperimentimi me rolet**

Faza finale: Kontrolllo, me anë të vëzhgimit, kohë pas kohe dhe në mënyrë sistematike, ta balancosh në mënyrë konstante procesin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies.

Giuseppina Iommelli
giuseppina.iommelli@alice.it

NJËSIA 4

Grup mosha III: 11 -14 vjet

Parimet etike nr. 3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Një tregim fantastik-shkencor”

Objektivat e mësim-nxënies

- Njoftimi me të drejtat dhe liritë themelore dhe Nenin 3 të Deklaratës Universale për Bio-etikë dhe të Drejtat e Njeriut.
- Vetëdijesimi se të drejtat dhe liritë themelore të çdo qenie njerëzore duhet të garantohen.
- Vetëdijesimi i të gjithëve lidhur me faktin se të drejtat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet mbi interesat e thjeshta të shkencës dhe shoqërisë.

Rasti

Në një vend të panjohur në një “të ardhme të largët”, një murtajë e rëndë kishte shkaktuar me mijëra viktima. Kjo sëmundje ishte e panjohur dhe vdekjeprurëse, dhe njeriu mund të infektohej thjesht me anë të shikimit. Efektet e saj ishin shkatërruese, dhe gjaku i pacientëve për një kohë shumë të shkurtër trashej dhe nuk mund të qarkullonte nëpër trup kështu që personi bëhej pothuaj si mumie. Shkencëtarët punonin pandërprerë për ta gjetur ilaçin kundër kësaj epidemie të tmerrshme. Një ditë, pothuaj rastësisht, një mjek e zbuloi një ilaç efektiv; ishte një ilaç që fitohej nëpërmjet distilimit të gjakut të gjakut të tij personal e që i takonte një grupi të rrallë të gjakut. Mjaftonin vetëm disa pika të injektoheshin në trupin e pacientit që të ndalej koagulimi i gjakut dhe të kthehej në formë të lëngët përsëri.

Shkencëtari ishte shumë i gëzuar që e kishte bërë një zbulim kaq të rëndësishëm mirëpo, për fat të keq, ai i kishte edhe mangësitë e veta: ndodhi që grupi i gjakut që nevojitej për prodhimin e këtij ilaçi ishte aq i rrallë sa vetëm disa njerëz e kishin. Kjo nënkuptonte se, për të shpëtuar jetën e shumë njerëzve, ishte e domosdoshme që të sakrifikohej disa prej tyre. Për këtë arsye, shkencëtari nuk ishte i sigurt nëse do të duhej ta bënte publik zbulimin e tij apo jo. Ai e mblodhi familjen e tij dhe kërkoi këshillë nga ata, mirëpo rezultati nuk ishte i kënaqshëm meqenëse opinionet e familjarëve ishin të ndryshëm. Nëna e tij reagoi menjëherë duke thënë se ai do të duhej ta mbante të fshehtë zbulimin e tij, sepse nuk është e drejtë të përdorën praktika mjekësore që disave u ofrojnë përfitime në dëm të tjerëve. Në anën tjetër, djali i tij ishte i mendimit se ishte e drejtë që të sakrifikohej jeta e disa vetave me qëllim që të shpëtohen të tjerët. Gruaja e tij tha se mund të gjendej një mes: të shpëtohen sa më shumë njerëz që është e mundur, duke u përpjekur që të mos rrezikohet jeta e dhuruesve të gjakut. Vajza e tij pohoi se qëndrimi i nënës së tyre ishte i arsyeshëm por problemi më i madh është se

si do të mund të vendos dikush se kënd duhet shpëtuar e kënd jo? Kush do ta kishte të drejtën të vendos për jetën apo vdekjen e dikujt? Për këtë arsye ajo propozoi që gjërat të mbesin ashtu si janë dhe të mos përdorët ai ilaç.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi e prezanton rastin para klasës. Për ta lehtësuar diskutimin ndërmjet nxënësve, mësimdhënësi i formon dy grupe, ku secili grup ftohet të reflektojë se cila do të mund të ishte zgjidhja më e përshtatshme etike.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk ofron sugjerime konkrete, por thjesht e udhëheq diskutimin. Pasi të kenë vendosur (ndoshta me shumicë) për zgjidhjen më të mirë, secili grup ia paraqet zgjidhjen e tyre grupit tjetër duke luajtur role. Në veçanti, disa nxënës mund të marrin përsipër rolin personazheve të ndryshme në këtë tregim duke i mbështetur qëndrimet e tyre deri sa të arrijnë ta paraqesin zgjidhjen e pranuar për ta.

Pas prezantimit, çdo nxënës, nëse të dy grupet kanë prezantuar zgjidhje të ndryshme, e shpreh mendimin e tij/saj lidhur me në zgjedhjen e bërë nga grupi tjetër.

Në këtë pikë, mësimdhënësi e sqaron kuptimin e “të drejtës” dhe “lirisë”, terma këto që shfaqen në Parimin 3 të Deklaratës Universale mbi Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut, ku thuhet se:

- *Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.*
- *Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të kenë përparësi ndaj interesave të thjeshta të shkencës ose të shoqërisë.*

Mësimdhënësi, në veçanti, thekson se rasti i propozuar tregon një konflikt ndërmjet interesave të individëve dhe atyre të shoqërisë.

Në dritën e këtyre fakteve të reja, mësimdhënësi e fton klasën t’i rishikojnë zgjidhjet që i kanë bërë më herët dhe t’i modifikojnë ato nëse e shohin të nevojshme. Në këtë fazë, mësimdhënësi e drejton diskutimin dhe, duke përdorur teknikën brainstorming, e shfrytëzon rastin që t’u ndihmojë fëmijëve të mendojnë për të drejtat dhe liritë tjera që ata i konsiderojnë si themelore.

Kjo punë pastaj mund të përdoret nga mësimdhënësi që t’i motivojë nxënësit të reflektojnë edhe më shumë lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 5

Grup mosha III: 11 -14 vjet

Parimet etike nr. 3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Ruleti rus: të drejtat e mohuara në CDA (Qendrat e emigracionit)”

Objektivat e mësim-nxënies

- Denoncimi i praktikave çnjerëzore dhe shkeljeve të drejtave themelore të njeriut që kanë të bëjnë me imigrantët brenda Qendrave të emigracionit;
- Vetëdijesimi i të rinjve që të respektojnë barazinë e të gjitha qenieve njerëzore për sa i përket në dinjitet dhe të drejtave të tyre, në mënyrë që të gjithë të trajtohen në mënyrë të drejtë.
- Përshkrimi i anës së errët të Qendrave të emigracionit: “nënstacionet diktatoriale dhe të legalizuara” në vendet demokratike.

Rasti

“Unë jam askush, unë nuk kam çfarë t’u ofrojë përveç jetës dhe dinjitetit tim”.

Ne erdhëm këtu me barkë dhe ishte errësirë. Ishte ftohtë dhe dielli akoma nuk kishte lindur kur ne i pamë dritat në largësi duke shndritur.

Dikush nga barka thirri “Toka!” dhe ne të gjithë i drejtuam sytë në atë drejtim.

Batanijet dhe xhaketat tona ishin të lagura në tërësi nga lagështia dhe burimi i vetëm i nxehtësisë për ne ishin trupat tonë të grumbulluar një mbi një.

Pas pak, disa anije u afruan me drita të fuqishme projektori. Një njeri me uniformë na pyeti nëse në barkë kishte të vdekur apo të zhdukur, dhe i vetmi person në mesin tonë i cili e fliste gjuhën e personit me uniformë filloi t’i përmend emrat e atyre që nuk ishin më. Veç kishte aguar dhe rojet bregdetare na shoqëruan deri në breg të detit.

Pasi zbritëm nga barka dhe pas disa procedurave administrative, ata na çuan në një kompleks të çuditshme me një ndërtesë në qendër të atij kompleksi.

Aty gjetëm njerëz të tjerë të pafat si ne, duke pritur dikë që do t’ua kthente shpresën që e kishin para se të largoheshin nga vendi i tyre.

Ne u detyruam që t’i heqim rrobat tona të ndyta që mbanin erë, e pastaj na dhanë për të ngrënë. Çdo gjë dukej në rregull, mirëpo qëndrimi ynë në ato objekte vazhdoi me ditë, javë, muaj.

Edhe sot, “unë ushqehem” me tasa si një kafshë, nuk kam ujë të nxehtë për t’u larë, dhe unë nuk kam as emër. Për ta këtunë jam askush. Unë nuk kam letërnjoftimin tim me vete, prandaj identifikohem me një akronim që përbëhet nga numrat dhe shkronjat. Të vetmit që e dinë identitetin tim janë shokët e mi me të cilët e kam lëshuar vendin tim, të paktën ata që janë akoma gjallë. Aliu, Mustafa dhe Faresi më thërrasin me emër “Chaouki”, në mënyrë që unë mund ta mbajë mend vendin tim, zërin e nënës duke më thirrur. Atyre u jam pafundësisht mirënjohës për këtë.

Ndoshta do të na kthejnë të gjithëve në vendin prej nga kemi ikur. Vetëm ideja ai makth mund të përsëritet më tmerron.

Edhe një herë, i privuar nga liria ime, identiteti im, dhe më keq, nga dinjiteti im si njeri, pyes veten nëse do të kishte qenë më mirë sikur të kisha vdekur gjatë rrugës, në det, sikur disa nga miqtë e mi.

Të paktën, në thellësitë e detit, dinjiteti i qenieve njerëzore nuk mund të nëpërkëmbet. Tani po më mungon dinjiteti.

Metodologjia e mësim-dhënies

Dilema

Lëvizja nëpër hapësirat gjeografike ka qenë gjithmonë prerogativë e njeriut. Megjithatë, me paraqitjen e “shteteve - kombe” dhe, në vitet e fundit, nga frika e terrorizmit ndërkombëtar, pas sulmit mbi Kullat Binjake në Nju Jork, kufijtë politikë janë forcuar dhe, në të njëjtën kohë, ksenofobisë po përhapet në popullsinë e vendeve perëndimore.

Çdo emigrant që vjen në vendet perëndimore konsiderohet si një terrorist potencial dhe vrasës i demokracisë kapitaliste. Kontrollat janë intensifikuar dhe po hapen qendra të reja të emigracionit.

Këto vende definojnë si “diktatura të legalizuara”, ku shtetet demokratike perëndimore mund t’i kenë duart e lira për sa i përket frikës dhe çoroditjeve të ksenofobisë. Dhuna dhe shkeljet e të drejtave themelore të njeriut janë rutinë e përditshme në këto qendra.

Emigrantët janë të privuar nga çdo gjë, duke përfshirë edhe gjërat që i posedojnë dhe identiteti i tyre. Kështu, një proces kritik i tjetërsimit, që e detyron individin ta humb vetveten, fillon dhe, në të njëjtën kohë, frika e kthimit prej nga kanë ardhur, dhe përjetimi i makthit të vjetër ende kërcënon mirëqenien e tyre.

Në vitet e fundit, megjithatë, raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe dëshmitë e drejtpërdrejta nga videot, të atyre që e përjetojnë dhunën e përditshme në këto qendra, e kanë detyruar popullatën të ngrihen kundër kësaj dukurie dhe në përkrahje të këtyre njerëzve të pafat në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të jetuar.

1. Mësimdhënësi do ta lexojë tekstin e lartpërmendur me nxënësit dhe secili prej tyre do ta shkruajë temën dhe vendet ku, sipas mendimit të tyre zhvillohet kjo ngjarje.
2. Punimet e nxënësve janë anonime, lexohen me zë dhe krahasohen. Mësimdhënësi nuk e përzgjedh përgjigjen e saktë.
3. Nxënësit do ta shikojnë një dokumentar, ku përshkruhet përvoja tragjike e emigrantëve në CDA. Mësimdhënësi do ofrojë, me ndihmën e mjeteve vizuale, një shpjegimin shkurtër të jetës në CDA, duke sqaruar pse quhen edhe si “vende të diktaturës së legalizuar në kontekst demokratik”.
4. Më në fund, pasi të bëhet e qartë tema e tekstit, nxënësit do të përpiqen ta identifikojnë

veten me emigrantët, duke përshkruar emocionet që ata mund t'i kenë nëse privohen nga gjërat që i posedojnë.

Mjetet

Linqet e mëposhtme kanë të bëjnë me videot në gjuhën italiane dhe imazhet që paraqiten janë të përshtatshme për gjithë njerëzit në botë:

<https://www.youtube.com/watch?v=uADVre1vxNs>

<https://www.youtube.com/watch?v=HNkwVqoPesk>

<https://www.youtube.com/watch?v=PQLZeUsA76E>

<https://www.youtube.com/watch?v=PX3IDMdwjgk>

Gennaro Borrelli

over_therainbow@live.it

18



NJËSIA 6

Grup mosha IV: 15 -19 vjet

Parimet etike nr. 3: Dinjiteti njerëzor dhe të Drejtat e njeriut

1. Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të respektohen plotësisht.
2. Interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet ndaj interesit të thjeshtë shkencor apo të shoqërisë.

Titulli

“Gjithë çfarë dua është arsimimi”

Objektivat e mësim-nxënies

- Si u ndihmon arsimimi qenieve njerëzore që ta përmirësojnë vetveten.
- Përfitimet shoqërore nga arsimi
- Pse duhet arsimi të jetë i hapur për të gjithë
- Si mund të ndikojë në shoqëri guximi individual dhe fuqia e idesë

Rasti

Malala Yousafzai: arsimi si e drejtë e njeriut

Malala Yousafzai është fituesja më e re ndonjëherë e çmimit Nobel. Ajo është e njohur kryesisht për avokimin e të drejtave të njeriut për arsimim dhe për gratë në vendlindjen e saj në Luginën Suat, në provincën e Khyber Pakhtunk- hwa në veriperëndim të Pakistanit, ku talebanët lokal ua kishin ndaluar vajzave shkollimin. Që ng ajo kohë, avokimi i Yousafzai është rritur në një lëvizje ndërkombëtare.

Familja e saj i drejton disa shkollave në rajon. Në fillim të vitit 2009, kur ishte 11-12 vjeçare, Yousafzai e shkroi një blog me pseudonim për BBC, duke e përshkruar në hollësi jetën e saj nën pushtimin e talebanëve, përpjekjet e tyre për ta marrë nën kontroll luginën, dhe pikëpamjet e saj për ta promovuar arsimin e vajzave në Luginën Suat. Verën e ardhshme, gazetari Adam B. Ellick e përgatiti një dokumentar për New York Times lidhur me jetën e saj, në kohën kur ushtria pakistaneze kishte ndërhyrë ushtarakisht në atë rajon. Yousafzai u bë figurë e njohur, jepte intervista për shtyp dhe për televizion, dhe ajo u nominua për Çmimin Ndërkombëtar të Paqes për Fëmijë nga aktivisti i Afrikës së Jugut Desmond Tutu.

Në pasditen e 9 tetorit 2012, Yousafzai hipi në autobusin e saj të shkollës në rajonin Suat në veriperëndim të Pakistanit. Një person i armatosur e pyeti për emrin e saj, pastaj ia drejtoi revolen dhe qëlloi me tri të shtëna. Një plumb e goditi Yousafzain në anën e majtë të ballit, i kaloi nën lëkurën në gjatësinë e fytyrës së saj, dhe u ndal në shpatullën e saj. Disa ditë pas sulmit, gjendja e saj ishte kritike dhe ajo ishte në gjendje të pavetëdije, mirëpo më vonë gjendja e saj u përmirësua mjaftueshëm dhe ajo u dërgua në Spitalin Mbretëresha Elizabeth në

Birmingham, në Angli, për rehabilitim intensiv. Më 12 tetor, një grup prej 50 klerikëve islamikë në Pakistan e shpallën një fatwa kundër atyre që u përpoqën ta vrasin Yousafzain, mirëpo talebanët e ritheksuan qëllimin e tyre për të vrrarë atë dhe babanë e saj Ziauddin Yousafzai.

Përpjekja për vrasjen e Yousafzai shkaktoi një mbështetje të madhe në nivel vendi dhe ndërkombëtare për te. Deutsche Welle, në janar të vitit 2013, shkroi se Yousafzai mund të jetë bërë “adoleshentja më e famshme në botë”. I Dërguari i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Arsim Global, Gordon Brown nisi një peticion të OKB-së në emër të Yousafzait, duke kërkuar që të gjithë fëmijët në mbarë botën të ndjekin shkollimin deri në fund të vitit 2015; e që ndihmoi në ratifikimin e parë të Ligjit për të Drejtën në Shkollim në Pakistan. (Burimi: Wikipedia; http://en.wikipedia.org/wiki/Malala_Yousafzai).

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Arsimi, në ditët e sotme, njihet botërisht si e drejtë themelore e njeriut, por, në disa raste, madje edhe kjo e drejtë nuk respektohet. A duhet një qenie njerëzore të vendosë se kush mund të arsimohet e kush jo? A duhet kjo e drejtë të vendoset në bazë të gjinisë dhe paragjykimeve fetare?

Mësimdhënësi e paraqet shkurtimisht historinë e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, duke theksuar, në veçanti, nenin që ka të bëjë me të drejtën për arsimim.

Pas themelimit më 1945, Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut (UDHR): parimi 26 i Deklaratës i thekson parametrat e arsimit si një e drejtë e njeriut, si më poshtë:

(1) Gjithkush e ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në nivel fillor dhe themelor. Arsimi fillor duhet të jetë i obligueshëm. Arsimi teknik dhe profesional, në përgjithësi, duhet të jetë i qasshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet të jetë i qasshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë në bazë të meritave.

(2) Arsimi duhet të orientohet në zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe në fuqizimin e respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Arsimi do të promovojë të kuptuarit, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet gjithë popujve, grupeve racore ose fetare, dhe do t'i shtyjë tutje aktivitetet e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

(3) Prindërit e kanë të drejtën paraprake që ta zgjedhin llojin e shkollimit që do ta ndjekin fëmijët e tyre.

Mësimdhënësi i lejon nxënësit që ta shikojnë videon me fjalimin e Malala-së në Kombet e Bashkuara (<https://www.youtube.com/watch?v=3rNhZu3ttIU>), pastaj i fton nxënësit që të reflektojnë mbi rëndësinë e fjalëve të saj. Çdo nxënës e shënon atë që ai/ajo e konsideron si “fjalët kyçe” në fjalimin e Malala-së. Luteni që të keni parasysh që nxënësit duhet thjesht t'i shprehin ndjenjat e tyre pa u ndikuar nga mësimdhënësi apo shokët tjerë të klasës; kështu që, në këtë pikë, propozohet puna individuale. Pasi ta kenë bërë një listë të fjalëve mbresëlënëse kyçe të fjalimit, nxënësit duhet ta kenë parasysh se historia e Malala-së është vetëm një shembull i njohur i mohimit të së drejtës për shkollim. Ne mund të gjejmë raste të shumta në vende të ndryshme ku ndjekja e shkollimit paraqet një privilegj të veçantë dhe jo një të drejtë që duhet përmbushur. A u kujtohet nxënësve ndonjë rast apo tregim tjetër në lidhje me këtë temë?

Mësimdhënësi do të udhëheq një diskutim të shkurtër duke u bazuar në pyetjen, pastaj do t'i ftojë nxënësit të marrin pjesë në tregimin e kësaj ngjarje. Në fund, të rinjtë, duke punuar në

çifte, do ta shkruajnë një tregim të shkurtër duke u bazuar në pyetjen vijuese: çfarë do të bëja po të isha i/e privuar nga arsimimi?

Për lexim

http://en.wikipedia.org/wiki/Malala_Yousafzai

<https://www.youtube.com/watch?v=3rNhZu3ttIU>

<http://www.bbc.com/news/world-asia-23241937>

http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2014/yousafzai-lecture_en.html

<https://secure.aworldschool.org/page/content/the-text-of-malala-yousafzais-speech-at-the-united-nations/>

<http://www.theguardian.com/world/video/2014/dec/10/malala-yousafzai-accepts-nobel-peace-prize-video>

Daniela Caruso

daniela.caruso@unipegaso.it



Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 4

Përfitimi dhe Dëmi

Në aplikimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë përkatëse, përfitimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për pacientët, pjesëmarrësit në hulumtim dhe individët tjerë të prekur duhet të shtohen dhe çdo dëm i mundshëm ndaj individëve të tillë duhet të minimizohet.

BENEFITS



DAMAGES

NJËSIA 7

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimi etik nr. 4: Përfitimi dhe dëmi

Në aplikimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë përkatëse, përfitimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për pacientët, pjesëmarrësit në hulumtim dhe individët tjerë të prekur duhet të shtohen dhe çdo dëm i mundshëm ndaj individëve të tillë duhet të minimizohet.

Titulli

“Muzika dhe vallëzimet nga mbarë bota”

Për të parandaluar çështjen e mundshme të përjashtimit social të fëmijëve që vijnë nga kultura dhe zakone të ndryshme.

Objektivat e mësim-nxënies

- Zhvillimi i identitetit të fëmijës
- Fitimi i vetë-besimit
- Raportet me të tjerët
- Të mësuarit se si të mbështetemi tek të tjerët
- Njoftimi me njëri tjetrin
- Respektimi i dallimeve kulturore
- Zhvillimi i kapaciteteve për vetë-orientimin e nxënësve në një mjedis të panjohur.

Loja

Dilema

Shokët e mi të klasës janë në shumë mënyra të ndryshëm nga unë. Ngjyra e lëkurës sime dallon nga ajo e tyre, ata nuk i njohin zakonet dhe traditat e mia: a të përpiqem që t’i njoh më mirë ata apo t’u shmangem atyre?

Për të parandaluar çështjen e mundshme të përjashtimit social të fëmijëve që vijnë nga kultura dhe zakone të ndryshme.

Mjedisi

- Një hapësirë e madhe që u mundëson të gjithëve që të lëvizin;
- Një grup heterogjen i fëmijëve, në mënyrë që fëmijët më të rritur do t’i nxisin fëmijët më të vegjël t’i imitojnë sjelljet e tyre.

Materialet

- Muzika dhe vallëzimet nga vendet e tyre të origjinës;
- Veshja tipike nga kultura e fëmijëve;
- Grimi dhe modeli i flokëve tradicional.

Loja

- Fëmijët me veshje nga vendet e tyre të origjinës;

- Mësimdhënësi propozon ushtrime për fillim të orës ,ësimore;
- Pas këtyre ushtrimeve fëmijët ulen në dysheme në formë të rrethit;
- Secili fëmijë prezantohet duke e thënë emrin e tij/saj dhe vendin e origjinës;
- Çdo fëmijë do ta prezantojë një këngë apo një valle nga vendi i tij/saj i origjinës, duke veshur rroba tradicionale.

Kur të ndalet muzika, propozohet një lojë e re:

- Fëmijët e vegjël do të ulen në rreth dhe do t'i shikojnë shokët më të vjetër;
- Fëmijët e moshës 5 vjeçare do të ndahen në çifte;
- Njëri nga fëmijët në çift do t'i ketë sytë e mbyllur;
- Fëmija tjetër në çift i ndihmon partnerit të vetë me sy të mbyllur, ngadalë duke e vënë dorën e tij në supin e partnerit dhe duke e udhëhequr në drejtim të duhur;
- Më pastaj, në bazë të sinjalit të mësimdhënësit, loja do të ndryshojë;
- Një fëmijë me sy të mbyllur do t'i ndjekë udhëzimet e fëmijëve tjerë (të cilët ende qëndrojnë ulur në dysheme në formë rrethi) pastaj, duke u ndërruar, ata do të fillojnë ta tërheqin vëmendjen e tij/saj duke përdorur zërin apo duke bërë zhurmë;
- Kur mësimdhënësi thotë: “ndal”, detyra e fëmijës me sy të mbyllur do të jetë që t'ia qëllojë se në cilën pjesë të dhomës gjendet ai.

Metodologjia e mësim-dhënies

Takimi me kulturat dhe zakonet tjera do të mundësojë të kuptuarit më të mirë të këtyre të ashtuquajturave “dallimeve”; nëpërmjet kësaj njësie mësimore, dallimi do të bëhet burim për pasurimin personal të karakterit e jo rrezik për identitetin etnik të fëmijës.

Kjo njësi mësimore ka për qëllim që t'i qaset problemin e zhvillimit të ndjenjës ndër-kulturore të përkatësisë së të njëjtës shoqëri (qytetaria ndër-kulturore). Në mënyrë që të arrihet sukses në këtë detyrë, nevojitet një eliminim gradual i stereotipave dhe paragjykitimeve. Kjo qasje do të jetë një ndihmesë e madhe në parandalimin e efekteve të marginalizimit të mundshëm dhe shpresojnë të marginalizimit ekzistues; me fjalë të tjera, kjo qasje duhet të kontribuojë në mënyrë aktive në rritjen e balancuar dhe harmonike të fëmijës, duke e rritur vetë-besimin e tij/saj dhe duke përmirësuar marrëdhëniet personale të tij/saj me shokët e klasës.

Antonella Migliore
antonella.migliore@icloud.it



NJËSIA 8

Grup mosha II: 6 - 10 vjet

Parimi etik nr. 4: Përfitimi dhe dëmi

Në aplikimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë përkatëse, përfitimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për pacientët, pjesëmarrësit në hulumtim dhe individët tjerë të prekur duhet të shtohen dhe çdo dëm i mundshëm ndaj individëve të tillë duhet të minimizohet.

Titulli

“Ëndrra e madhe e Pasit dhe Tatit”

Objektivat e mësim-nxënies

- Promovimi i respektit dhe njohuritë lidhur me kafshët e vogla në rajonin tonë;
- Të jemi në gjendje të mendojmë për frikën tonë nga kafshët në mënyrë që ta tejkalojmë atë;
- Rehabilitimi i kafshëve të cilat janë shpesh viktime të paragjykimeve të pabaza;
- Nxitja e njohurive mbi jetën dhe mjedisin e qenieve të gjalla;
- Ngritja e vetëdijes që çdo krijesë meriton të jetojë me respekt;
- Ngritja e vetëdijes që askush nuk duhet të privohet nga shëndeti dhe liria e tyre për hir të krijesave tjera;
- Ngritja e vetëdijes që çdo specie është e ndryshme, mirëpo aftësia për të vuajtur është e njëjtë për qeniet njerëzore dhe qeniet jo-njerëzore.

Rasti

Në fshatin Biglandia, Pasi dhe Tati janë dy mace të shkreta të mbyllura në dy kafaze të ndara nga njerëzit që bëjnë hulumtime në kafshë. Dy macet e ëmbla vuajnë shumë në këtë mjedis mizorë dhe të shëmtuar.

Të dy macet e pafat janë viktime të eksperimenteve mizore që udhëhiqen nga hulumtuesit, të cilët injektojnë barna në trupat e maceve, në mënyrë që t'i studiojnë efektet e tyre. Nëse reagimet e trupave të tyre janë pozitive, studiuesit mund të vendosin që t'i aplikojnë këto barna në njerëz, nëse jo, kafshët e gjora janë të destinuara jo vetëm të torturohen, por edhe të vdesin.

Të dy macet bëhen miq. Një ditë ato vendosin që të ikin, mirëpo vendi ku ato strehohen është mjaft armiqësor, ku ato përballen me të ftohtit dhe urinë. Kafshët nuk mund të flasin, por ato vuajnë njëjtë si ne.

Macet e shkreta, të lodhura dhe të pafuqi, takohen me një familje të vogël por të mirë, që të shtyrë nga dhembshuria ndaj tyre dhe të shqetësuar nga gjendja e tyre, i marrin macet në shtëpinë e tyre të ngrohtë, dhe i adoptojnë ato.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

- Kush është i ndryshëm? Kush është në telashe?
- Si trajtohen macet? Kush u ndihmon atyre?
- Unë do t'u kisha ndihmuar maceve të shkreta për të ikur, mirëpo babai im thotë se këto eksperimente në kafshë ndihmojnë në shpëtimin e qenieve njerëzore nga sëmundjet.
- Mësimdhënësi ynë shpjegoi se nganjëherë hulumtimet mund të jenë të dobishme, mirëpo nganjëherë ato janë të panevojshme.

Qasjet e llojllojshme dhe aktive të mësimdhënies sipas llojit socio-konstruktivist; mësimdhënia mbi laboratorin, mësim-nxënia bashkëpunuese.

Dramatizimi

Secili grup e rishikon tekstin e tregimit, duke e shndërruar në një skenar të thjeshtë (ata mund ta ndryshojnë tekstin, madje edhe të fusin personazhe të reja).

- Në secilin grup, janë nxënësit ata që ia caktojnë njëri tjetrit rolet e ndryshme.
- Nxënësit i përsërisin pjesët e tyre në çifte për ta kuptuar më mirë përmbajtjen.
- Secili grup e përgatitë vetvetiu paraqitjen në skenë, duke përdorur posterë të thjeshtë dhe maska që përfaqësojnë disponimet e personazheve kryesore në tregim.
- Në sallën e teatrit secili grup e përgatitë skenarin për të dalë në skenë.
- Diskutimi përmbylles

Mësimdhënësi i fton nxënësit që të adoptojnë kafshë që janë shpëtuar nga laboratorët.

Giuseppina Iommelli
giuseppina.iommelli@alice.it



Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 5

Autonomia dhe Përgjegjësia Individuale

Autonomia e personave për të marrë vendime, përderisa marrin përgjegjësinë për ato vendime dhe respektojnë autonominë e të tjerëve, duhet të respektohet. Për personat të cilët nuk janë të aftë të ushtrojnë autonominë, duhet të ndërmerren masa të veçanta për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.



NJËSIA 9

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimi nr. 5: Autonomia dhe Përgjegjësia Individuale

Autonomia e personave për të marrë vendime, përderisa marrin përgjegjësinë për ato vendime dhe respektojnë autonominë e të tjerëve, duhet të respektohet. Për personat të cilët nuk janë të aftë të ushtrojnë autonominë, duhet të ndërmerren masa të veçanta për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

Titulli

“Pasqyra: Të mësuarit e komunikimit”

Objektivat e mësim-nxënies

- Përmirësimi i autonomisë dhe përgjegjësisë individuale si rezultat i një procesi të ndërlikuar dhe progresiv që çon në vetëdijesim të vetvetes dhe vetëdijesim të tjerëve si dhe në aftësinë për të komunikuar me njerëzit tjerë.

- Përdorimi i pasqyrës si një mjet i dobishëm për të mësuar si ta kuptojmë komunikimin jo-verbal që na mundëson t'i shqyrtojmë dhe t'i deshifrojmë shprehjet e fytyrës dhe qëndrimet e trupit tonë, si edhe të tjerëve, në mënyrë që t'i kuptojmë më mirë njerëzit me të cilët bashkëveprojnë. Në të vërtetë, vetëm me gjuhë të qartë dhe të vetëdijshme ne jemi në gjendje që t'i shprehim në mënyrë të përgjegjshme vendimet që do t'i marrim.

Loja

Hapi 1

Pasqyrë, pasqyrë në mur, kush është më e bukura nga të gjitha në këtë vend?

Duke u inspiruar nga tregimi për Borëbardhën, ne mund ta “pyesim” fëmijën që e shikon veten në pasqyrë. Derisa ai/ajo qëndron atje, ne e pyesim fëmijën të përshkruajë se çfarë po sheh dhe vëzhgon. Kjo qasje e thjeshtë është një mënyrë efektive për t'i ilustruar reagimet e ndryshme që çdo fëmijë i përjeton gjatë këtij aktiviteti. Vetëdijesimi për vetveten mund të rezultojë që fëmija të ketë më shumë vetëbesim, duke ia ofruar mundësinë fëmijës t'i vërejtë shumë aspekte të tij/saj që përndryshe nuk do të ishte në gjendje t'i vlerësojë.

Nëse kjo nuk është e mundur për fëmijën, për arsye të ndryshme (p.sh. druajtja, vetëbesimi i dobët, etj.) mësimdhënësi mundet thjeshtë ta pyes atë të përgjigjet në pyetjet paraprake të shënuara më poshtë:

Si quhesh? Sa vjeçar je? Cilën ngjyrë e preferon? E kështu me radhë. Pas kësaj, mësimdhënësi vazhdon me pyetje tjera, siç janë:

Ku i ke buzët? A janë ato të trasha apo të holla? Ku i ke sytë? Çfarë ngjyre i ke sytë? A ka dikush në familjen tënde ngjyrë të ngjashme të syve? E kështu me radhë.

Derisa fëmija i shikon sytë e vet në pasqyrë, kjo teknikë e thjeshtë e intervistës i jep atij

mundësinë të krijojë një raport miqësor me vetveten dhe me imazhin që ajo/ai e sheh në pasqyrë, duke rezultuar në një ndjenjë të thellë të vetë-besimit. Ky aktivitet i adreson çështjet themelore në zhvillimin e autonomisë dhe vetëdijesimit të fëmijës. Ky ushtrim i parë mund të bëhet në mënyrë individuale, me secilin fëmijë nga grupi, duke ndarë kohë të nevojshme për secilin prej tyre.

Kjo është e rëndësishme sidomos kur është fjala për fëmijë të turpshëm, në mënyrë që t'u mundësohet atyre ta shprehin veten larg nga sytë kureshtarë apo ngacmimet e bezdisshme të shokëve të tij/saj.

Më pastaj, fëmijës i jepet mundësia të "luajë" duke bërë fytyra në pasqyrë, duke u shtirë si personazhe të tilla si palaçoja apo përbindëshi, apo çfarëdo që fëmija dëshiron të bëjë: kjo i ndihmon fëmijës të vejë "kontakt" me vetveten.

Hapi 2

Një tjetër ushtrim përbëhet nga fëmijë që ndahen në çifte, të cilët qëndrojnë ballë për ballë me njëri tjetrin, në largësi prej një metër. Njëri prej tyre vepron si udhëheqës, ndërsa tjetri e aktron "pasqyrën". Duke bërë lëvizje prej belit lartë, udhëheqësi fillon të bëjë lëvizje të thjeshta. "Pasqyra" e tij/saj imiton këto lëvizje me saktësi, siç do ta bënte një pasqyrë. Pas një kohe, ata mund t'i ndërrojnë rolet, kështu që "pasqyra" bëhet udhëheqës, dhe anasjelltas. Qëllimi i këtij ushtrimi është jo vetëm që të përmirësohet koordinimi i lëvizjeve, por edhe të mësojmë se si ta shikojmë dikë tjetër që të ndjehemi rehat me mënyrat alternative të komunikimit.

Hapi 3

Fëmijët të rreshtuar përballë mësimdhënësit përpiqen t'i imitojnë lëvizjet e instruktorit (udhëheqësit). Ky ushtrim mund të bëhet edhe me një grup më të madh të fëmijëve. Udhëheqësi mundet, për shembull, të bëjë pantomimë të aktiviteteve të thjeshta, siç janë larja e fytyrës, veshja e rrobave, pastrimi i dhëmbëve, etj. Ky ushtrim nxit kreativitetin, lojën, kohën dhe koordinimin: fëmijët duhet të inkurajohen që të jenë sa më specifik që mundën kur i bëjnë lëvizjet e caktuara. Kur fëmijët të aftësohen mjaftueshëm, ne mund të provojmë t'i pasqyrojmë emocionet si për shembull, lumturia, pikëllimi, e kështu me radhë. Udhëheqësi mund ta përsëris një fjalim të njohur ose të këndoj një këngë të njohur, ndërsa fëmijët tjerë përpiqen ta përcjellin atë, duke e përsëritur fjalimin apo këngën. Komunikimi bëhet më e vështirë duke përdorur tri kanalet e komunikimit (syri, lëvizja dhe veshi) në të njëjtën kohë. Një ushtrim tjetër ku përdoret kanali i dëgjimit, në mënyrë që të tregojmë rëndësinë, dhe në të njëjtën kohë, vështirësinë në komunikim, është Loja Morale nr. 12, ose e ashtuquajtura "telefoni". Fëmijët ulen në rreth dhe pëshpëritin një mesazh prej një personi tek personi tjetër. Kur mesazhi kthehet tek burimi origjinal, ai padyshim ka pësuar ndryshime. Mësimdhënësi e tregon mesazhin origjinal, dhe shpjegon rëndësinë e komunikimit të saktë. Këto ushtrime të thjeshta dhe të fuqishme e përmirësojnë dhe e mprehin aftësinë e vëzhgimit dhe përqendrimit, zhvillojnë vetëbesimin dhe vetë-kontrollin që janë elemente themelore në zhvillimin e autonomisë dhe përgjegjësisë individuale.

Metodologjitë e mësimdhënies

Ushtrimi i pasqyrës paraqet një burim shumë të frytshëm dhe të papritur: mund të zhvillohet lehtësisht të përdoret në shumë mënyra. Prandaj ne e konsiderojmë atë si një mjet shumë të çmueshëm që na vë përballë imazhit tonë. Edhe pse në dukje ushtrim i thjeshtë, qasja jonë para një pasqyre mund të zbulojë aty për aty tiparet tona themelore të dukshme dhe të personalitetit të fëmijëve duke iu ofruar të gjithëve mundësinë që të zhvillojnë vetëbesimin dhe vetë-kontrollin, e që janë shkathtësitë themelore në zhvillimin e autonomisë dhe përgjegjësisë individuale.

Alessandra Pentone
lesspent@hotmail.com

NJËSIA 10

Grup moshë I: 3 - 5 vjet

Parimi nr. 5: Autonomia dhe Përgjegjësia Individuale

Autonomia e personave për të marrë vendime, përderisa marrin përgjegjësinë për ato vendime dhe respektojnë autonominë e të tjerëve, duhet të respektohet. Për personat të cilët nuk janë të aftë të ushtrojnë autonominë, duhet të ndërmerren masa të veçanta për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

Titulli

“Ishulli: Mesazhi në shishe”

Objektivat e mësim-nxënies

Zhvillimi i qëllimeve në nivele të ndryshme, dhe sipas grup moshave në shkallë të ndryshme të vështirësisë:

- Përpijke për t'i nxitur fëmijët të mendojnë se cilat janë elementet themelore për mbijetesën e qenieve njerëzore;
- Të theksohet rëndësia e mbrojtjes së ekosistemit tonë, njoftimi me parimin e autonomisë dhe përgjegjësisë që çdo person e ka ndaj vetvetes;
- Përfshirja e grupit/klasës si tërësi.

Shembulli nr. 1

Për t'i kuptuar elementet thelbësore që janë të nevojshme për të mbijetuar në një ishull të shkretë nga një person i braktisur nevojiten disa njohuri bazike shkencore. Mësimdhënësi/edukatori do të shpjegojë se çfarë elemente janë të domosdoshme për jetën e njeriut, siç janë, uji i pijshëm, ushqimi, zjarri, etj. Për shembull, duke shpjeguar se si njeriu mund të sigurojë ujin e pijshëm duke e filtruar ujin e detit, mësimdhënësi mund ta theksojë rëndësinë e ujit të pijshëm dhe të pastër. Për më tepër, ne mund të theksojmë se peshqit mund të mbijetojnë vetëm në ujin që nuk është i ndotur. Ne mund t'i përdorim peshqit si burim të rëndësishëm të ushqimit. Ne, po ashtu, mund të theksojmë se drunjtë mund të shfrytëzohen për të ndezur zjarrin, disa pemë tjera na japin fruta për t'u ushqyer, dhe ne mund ta shpjegojë rëndësinë e vegjetacionit që na jep oksigjen nëpërmjet fotosintezës, e kështu me radhë. Elementet thelbësore do të përmbledhen dhe të shënohen në një pllakat, ku ne do të mund, në mënyrë sintetike nëpërmjet vinjetave, t'i shohim rezultatet e zhvilluara nga grupi. Pra, jeta jonë në Tokë varet nga disa elemente themelore të natyrës. Autonomia jonë, sa i përket aftësisë tonë fizike për të mbijetuar, është ngushtë e lidhur me natyrën. Mbrojtja e natyrës shkon krah për krah me të kuptuarit e rëndësisë së botës që na rrethon dhe të gjitha krijesave që jetojnë në te, si dhe të kuptojmë që ndërmarrja e këtyre veprimeve është e domosdoshme për vetëmbrojtje.

Shembulli nr. 2

Nga çdo fëmijë do të kërkohet që “të shkojë në ishull”, dhe t'i merr me veti vetën dy apo tri sende, dy apo tre persona ose kafshë pa të cilat ai/ajo nuk mund të jetojë. Mësimdhënësi/edukatori do t'i përmbledhë të gjitha këto sugjerime në letër ku fëmija do t'i shënojë të gjitha

elementet që ai/ajo i ka zgjedhur. Pastaj, kjo fletë e letrës do të vendoset në një shishe të vogël plastike me emrin e fëmijës në të. Të gjitha shishet mund të lidhen në një pllakat apo në një pemë palme. Autonomia e secilit individ varet rreptësisht nga më të e varur nga të dashurit tanë. Autonomia nuk varet thjeshtë nga mbijetesë jonë fizike, ajo është e lidhur ngushtë edhe me marrëdhëniet që i kemi me familjet tona, miqtë, madje edhe me kafshët që i mbajmë në shtëpi. Çfarë do të ishte jeta jonë sikur të kishim vetëm ushqim, ujë, dhe asgjë tjetër? Edhe një herë, autonomia jonë, do të thotë, aftësia jonë për ta jetuar një jetë kuptimplote dhe të qëllimshme, varet nga respekti dhe dashuria që kemi për më të dashurit tonë me anë të cilëve ne e kultivojmë respektin dhe dashurinë për vetveten.

Shembulli nr. 3

Nëse fëmijët prej 6 deri në 10 vjet e luajnë këtë lojë, secili fëmijë do të zgjedhë diçka që ai/ajo mendon se është e rëndësishme për mbijetesën e grupit në këtë ishull, elementet materiale dhe jo-materiale (si guximi, solidariteti, paqja, bashkëpunimi, miqësia, etj.). Të gjitha sugjerimet e tyre do të përmbledhen në një fletë letre, e pastaj fëmijët do t'i ilustrojnë zgjidhjet e tyre. Ky mesazh do të vendoset brenda një shishe të madhe, ku ne do ta shënojmë emrin e klasës dhe të gjithë të braktisurve.

Autonomia dhe përgjegjësia janë elemente themelore për ekzistencën e marrëdhënieve njerëzore, jo vetëm si një individ i vetëm, por edhe si pjesë integrale e shoqërisë, pavarësisht nga madhësia e saj. Të mësuarit për të jetuar së bashku në një komunitet do të thotë të jemi përgjegjës ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve duke lejuar që autonomia jonë dhe autonomia e të tjerëve të bëhen një.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi/edukatori do të krijojë, nëpërmjet tregimit dhe mjetet mësimore, kushtet për ta imagjinuar jetën e personit të braktisur në ishullin e shkretë, duke theksuar nevojat primare dhe reale të tij/saj, së pari nevojat e materiale, dhe pastaj nevojat emocionale të secilit person veç e veç e pastaj të grupit në tërësi. Natyrisht, gjuha dhe shembujt që ne do t'i përdorim do të jenë, pak a shumë, të thjeshtë në përputhje me moshën dhe pjekurinë e grupit. Mësimdhënësi/edukatori, si zakonisht, do t'i menaxhojë dhe stimulojë observimet e fëmijës lidhur me mjetet për të mbijetuar, duke mos harruar që t'i përmbledhë të gjitha. Ne i përfshijmë të mirat materiale, si për shembull, uji i pijshëm, zjarri, ushqimi, e kështu me radhë. Në këtë mënyrë ne do të kuptojmë se sa gjëra në jetën tonë të përditshme nuk janë të nevojshme ose thënë më mirë, të tepërta dhe të padobishme (në veçanti, në botën e konsumit në të ashtuquajturat vende të zhvilluara). Ne, si qenie njerëzore, jemi të lidhur me natyrën, ashtu siç janë bimët dhe kafshët të varura nga elementet themelore për të mbijetuar në këtë planet. Pas elementeve materiale esenciale që nevojiten për mbijetesën tonë fizike, ne do t'i analizojmë gjërat, kafshët dhe njerëzit që janë të domosdoshme për jetën tonë emocionale, duke kërkuar nga çdo fëmijë se pa cilat gjëra/kafshë/njerëz ai/ajo nuk mund të jetojë. Në këtë mënyrë, ne do ta hulumtojmë jetën private të fëmijës dhe ta nxisim të menduarit lidhur me shkallën e autonomisë, jo vetëm fizike por edhe emocionale. Çdo person e ka botën e tij/saj të përbërë nga elemente të ndryshme që janë karakteristike, dhe që na mundëson ta bëjmë dallimin në mes të njerëzve, ku secili individ është në mënyrë absolute i veçantë.

Nëse fëmijët prej 6 deri në 10 vjet e luajnë këtë lojë, ne do të kërkojmë nga çdo fëmijë se cilat do të ishin elementet materiale dhe jo-materiale që u kanë mundësuar grupit të mbijetojnë, në frymën e parimit të autonomisë së përgjithshme dhe përgjegjësisë. Ne nuk duhet të harrojmë të theksojmë se çfarë mënyre një vendim i tillë, sipas këtyre parimeve, ndikon në secilin person, në grup dhe në mjedisin që na rrethon. Pastaj, ne do t'i mbledhim të gjitha observimet lidhur me mbijetesën e grupit, që kanë të bëjnë me elementet materiale dhe jo-materiale: të gjitha këto elemente do të bëhen "mesazhe në shishe" të cilat të braktisurit do t'i lëshojnë në det.

Artikujt e nevojshëm

Për të krijuar një mjedis të një ishulli të shkretëtë, ne na duhet një qilim të gjelbër ose ngjyrë kafe, dhe ne duhet ta imagjinojmë se jemi të rrethuar nga uji. Ne mund të formojmë një pemë palme, duke përdorur stiropor apo karton në trajtën e një palme, që mund të ngjyroset nga fëmijët. Ne do të na nevojitet:

- Shishe plastike të ngjyrosura (një shishe e madhe dhe disa shishe të vogla për çdo fëmijë)
- Fletë letre
- Ngjyra
- Një tabelë për pllakate
- Dhe çdo gjë që mësimdhënësit i nevojitet për ta realizuar/personalizuar këtë projekt.

Për lexim

Një mjet i mirë mund të jetë libri i Daniel Defoe's "Jeta dhe Aventurat e Çuditshme të Robinson Kruzos", në origjinal apo në versionin e thjeshtëzuar për fëmijë.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com



NJËSIA 11

Grup mosha II: 6 - 10 vjet

Parimi nr. 5: Autonomia dhe Përgjegjësia Individuale

Autonomia e personave për të marrë vendime, përderisa marrin përgjegjësinë për ato vendime dhe respektojnë autonominë e të tjerëve, duhet të respektohet. Për personat të cilët nuk janë të aftë të ushtrojnë autonominë, duhet të ndërmerren masa të veçanta për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

Titulli

“Ora e rërës”

“Vetëm ata që rrezikojnë të shkojnë shumë larg mund ta dinë se sa larg mund të shkojë një njeri”. T.S. Eliot.

Objektivat e mësim-nxënies

- Vetëdijesimi për atë se çfarë është koha dhe sa e vlefshme është ajo, në mënyrë që të jemi autonom dhe të kemi një ndjenjë të përgjegjësisë individuale dhe të përbashkët: Koha nuk mund të blihet, dhe ne shpesh e kuptojnë rëndësinë e kohës vetëm kur e kuptojmë se nuk na ka mbetur kohë e mjaftueshme.

- Për të mësuar se si ta pranojmë dhe organizojmë kohën, ne mund ta shfrytëzojmë maksimalisht energjinë tonë, dhe ta jetojmë jetën tonë në mënyrë më të plotë, dhe të marrim pjesë në mënyrë më aktive në shoqëri, të cilës edhe i përkasim.

Hapi 1

Për ta pasqyruar kohën duke kaluar, ne mund ta krijojmë një orë rëre. Së pari, do të ishte mirë të shpjegohet se çfarë është ora e rërës, dhe si punohet ajo, mundësisht duke jua prezantuar fëmijëve një orë rëre të vërtetë. Ora e rërës mund të punohet në disa mënyra. Për shembull, për të bërë dy poçe të orës së rërës ne mund t'i përdorim dy shishe plastike, dy kavanoza të vegjël nga qelqi, apo dy poçe elektrike. Varësisht nga materiali që dëshirojmë ta përdorim, ne do të kemi nevojë për mjete të ndryshme për t'i ngjitur mes veti ato. Ne do të na nevojiten disa kartonë si bazament ndërmjet dy gjysmave të orës së rërës: ne e bëjmë një vrimë në qendër të saj nëpër të cilën do të rrjedhë rëra, në mënyrë të kontrolluar, nga njëra anë në tjetrën. Për të parë se sa kohë ka kaluar kur e gjithë rëra zbrazet, ne duhet ta matim kohën dhe duhet ta rregullojmë sasinë e rërës në mënyrë përkatëse, varësisht se çfarë kohe dëshirojmë që ora e jonë e rërës të tregojë. Ora e rërës mund të përfundohet në mënyra të ndryshme (p.sh. e ngjyrosur, e zbukuruar me guaca, me gjëra shkëlqyese, etj.). Mirëpo, gjëja më e rëndësishme është që të bëhet mjet shumë të thjeshtë me anë të cilit ne do të fillojmë parafytyrojmë kalimin e kohës duke i matur aktivitetet e përditshme që i kryejnë çdo ditë, siç janë, vizatimi, ngjyrosja, leximi, shkrimi, e kështu me radhë. Ky është hapi i parë për t'u vetëdijësuar se si kalon koha.

Hapi 2

Historia e pajisjeve që matin kohën

Ka mënyra të ndryshme si me e realizua këtë aktivitet. Ne do të mund t'i pyesnim fëmijët të reflektojnë lidhur me këtë temë, mundësisht me ndihmën e shokëve të klasës dhe/apo

të prindërve të tyre. Pastaj, ata mund t'i ndajnë rezultatet e tyre me anë të vizatimeve ose fotografive që paraqesin pajisje të ndryshme për matjen e kohës gjatë shekujve. Ajo do të ishte ideale që të vizitohet një muze ku të gjitha këto instrumente ekspozohen: nga orë diellore deri tek ora e rërës, nga ora me ujë deri tek ora me lavjerrës, e deri tek orët bashkëkohore me kuarc dhe atomike që ne i kemi zbuluar gjatë rrugëtimit tonë. Njeriu e ka kuptuar vlerën e kohës dhe rëndësinë për ta matur kohën, dhe si rezultat, progresi i njerëzimit u përshpejtua. Edhe pse ky ushtrim nuk mund të jetë shkencor në mënyrë të saktë, ai luan një rol thelbësor në kuptimin e rëndësinë që e luan kohë në të jetuarit në mënyrë të përgjegjshme dhe autonome.

Hapi 3

Ka shumë mënyra për të demonstruar se si kalon koha dhe sa kohë ka kaluar duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme të përshtatshme për grup mosha të caktuara. Për shembull, ne mund të organizojmë gara siç janë garat e vrapimit, teste durimi, mundësisht duke i përfshirë ekipet (edhe pse është e mundur që pjesëmarrja të jetë edhe individuale). Një alternativë tjetër e mundshme do të ishte zgjidhja e problemeve matematikore apo gjëgjëzat sa më shpejt që është e mundur duke përdorur një matës kohe, apo edhe duke bërë gara në bashkimin e copëzave të figurave apo kolazhe. Edhe pse luajnë, fëmijët mund të fokusohen në shpejtësinë ose durim, e qëllimi i këtyre lojërave është që t'u ndihmohet atyre të kuptojnë se ka mënyra të ndryshme që ata mund t'i zgjedhin për ta kaluar kohën e tyre. Të mësuarit se si me e shfrytëzua kohën, në mënyrë cilësore dhe sasiore, do të thotë të zhvillohet autonomia dhe përgjegjësia në aktivitetet tona të përditshme, si dhe në zgjidhjet që ne i bëjmë.

Hapi 4

Ne mund t'i ndajmë fëmijët në grupe të vogla, të cilat përfaqësojnë ekipe të ndryshme në garën me stafeta. Në lojën gara me stafeta, çdo vrapues duhet t'ia kalojë stafetën vrapuesit tjetër brenda një zone të caktuar. Në garën e shpejtë me stafeta, vrapuesit zakonisht bëjnë "kalimin e verbër të stafetës", ku vrapuesi i dytë qëndron në një vend të paracaktuar dhe fillon të vrapojë kur vrapuesi i parë e prek shenjën e dukshme në shteg. Vrapuesi i dytë e hap dorën pas disa hapave, në kohën kur vrapuesi i parë e arrin atë dhe ia dorëzon stafetën. Zakonisht vrapuesi jep një sinjal me zë, si p.sh. "shkopi!" duke e përsëritur disa herë, në mënyrë që pranuesi i stafetës të di kur ta hapë dorën. Në vend të "shkopi" vrapuesi i parë duhet të thotë: "Mos na e humbni kohën!" ndërsa vrapuesi i dytë do të përgjigjet: "Unë do të kujdeset për atë!". Në fakt, edhe nëse vrapuesi është i shpejtë, loja do të fitohet vetëm nëse të gjithë anëtarët e ekipit të tij janë të shpejtë. Loja gara me stafeta është një metaforë e përgjegjësisë, detyra për t'iu referuar kohës/nevojave të tjerëve dhe respekti për ta.

Metodologjia e mësimdhënies

Varësisht nga grup mosha, është e mundur që të planifikohen metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Hapi i parë duhet të jetë që fëmijët të jenë të vetëdijshëm për faktin se koha kalon, edhe para se ta kuptojnë vlerën e saj. Edhe një herë, përmes lojërave, do të jetë e mundur të paraqitet kalimi i kohës në mënyra të ndryshme, dhe ta njohim këtë fakt është e vlefshme. Rrëzë që rrjedhë në orën e rërës, historia e pajisjeve që tregojnë kohën, dhe observimet e drejtpërdrejta të kalimit të kohës përmes lojës, apo gjatë çfarëdo aktiviteti tjetër, mund t'iu ndihmojë fëmijëve ta kuptojnë këtë koncept. Aftësia për të bërë zgjedhje të pavarur dhe të përgjegjshme brenda një kohe të duhur është një shkathtësi thelbësore në jetë: një përgjigje vonuar apo e nxituar mund të ketë pasoja negative dhe reperkusione për individin, madje edhe për komunitetin të cilit i përket.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com

NJËSIA 12

Grup mosha IV: 15 - 19 vjet

Parimi nr. 5: Autonomia dhe Përgjegjësia Individuale

Autonomia e personave për të marrë vendime, përderisa marrin përgjegjësinë për ato vendime dhe respektojnë autonominë e të tjerëve, duhet të respektohet. Për personat të cilët nuk janë të aftë të ushtrojnë autonominë, duhet të ndërmerren masa të veçanta për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

Titulli

“Për t’u ndjerë mirë, çdo gjë varet nga unë”

Objektivat e mësim-nxënies

- T’u shpjegohet nxënësve kuptimi i “çrregullimit bipolar” ose “sëmundja maniake-depresive”, e karakterizuar me ndryshime të mëdha në disponim, emocione, mendime dhe sjellje: nëse nuk trajtohet me kujdesin e duhur, mund t’i shkaktojë dëme serioze të sëmurit.
- Informimi i të rinjve lidhur me simptomat dhe dhimbjen fizike dhe mendore që kjo sëmundje përfshinë e që mund të rezultojë me pasoja të mëdha, nëse pacienti nuk vendos të ndjekë një trajtim të duhur.
- T’u shpjegohet nxënësve se ata që vuajnë nga kjo sëmundje mund të zgjedhin që të shërohen. Nëse ata nuk janë në gjendje të kenë respekt dhe ta marrin përgjegjësinë për gjendjen e tyre, është e nevojshme që njerëzit, të cilët janë afër tyre, të përpiqen t’u ndihmojnë atyre.

Rasti

“Unë dhe mendja ime”

Aleksandri, një djalë 19 vjeçar, jeton në një qytet të vogël. Ai ka miq dhe familje që e mbështesin në çdo gjë që ai bën. Megjithatë, ai shpesh kalon nëpër periudha ku ai është i lumtur me jetën e tij, dhe mirënjohës për çdo gjë, dhe periudha tjera, ku ai ndihet i dëshpëruar dhe pa asnjë motivim. Këto momente zgjasin shumë, e sidomos ato kur ai ndihet keq.

Gjatë këtyre kohëve, të gjitha përpjekjet që shokët e tij dhe familja i kishin bërë për ta ndihmuar kishin qenë të kota. Një ditë, Aleksandri, pas këshillës së nënës, vendosi të shkojë tek një psikoterapeut, i cili duke e dëgjuar historinë e tij, dhe diagnozën e mjekëve se ai vuante nga një formë e depresionit, ia përshkroi disa barna që djaloshi u pajtua t’i merrte. Pas vetëm një javë, Aleksandri vendosi ta ndërpres trajtimin, në kohen kur gjendja e tij nuk kishte ndryshuar, mirëpo ai besonte se ishte krejtësisht në rregull, dhe nuk kishte nevojë për ndonjë kujdes. Prindërit e tij kërkuan më kot që ta vazhdojë terapinë e tij: më vonë ata e kanë paguar çmimin e refuzimit të tij.

Disa javë më vonë, Aleksandri filloi të ndjehet në depresion përsëri, dhe nuk ishte në gjendje të reagoonte ndaj asnjë nxitësi të jashtëm. Prandaj, familja e tij, e brengosur për shëndetin e tij, kërkuan nga ai që ta thërras psikoterapeutin për të kërkuar ndihmën e tij. Në fakt, gjatë këtyre fazave të depresionit, Aleksandri mund të lëndohet seriozisht, madje edhe të paraqet rrezik për njerëzit tjerë.

Aleksandri më në fund u pajtua. Mjeku sugjeroi që ai të shtrihet në një spital psikiatrik, ku ai mund të marrë stabilizues të disponimit dhe terapi farmakologjike. Mirëpo, mjekut i duhej

pëlqimi i Aleksandërit: përndryshe prindërit e tij duhej të merrnin masa që ta detyrojnë ta merr trajtimin, sepse ai mund të kryente akte dhune ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Çrregullimi bipolar konsiston në ndryshimin e fazave të depresionit me “eufori” ose mani. Zakonisht, kjo sëmundje fillon gjatë adoleshencës. Gjatë fazës së depresionit, pacienti shfaq disa nga simptomat vijuese: disponim depresiv pothuaj gjatë tërë ditës pa ndonjë arsye të vërtetë, rënie të oreksit dhe vështirësi për të fjetur ose për të qëndruar i fokusuar, acarim dhe mendime të përsëritura të vetëvrasjes dhe vdekjes. Faza e manisë përfshinë vlerësimin e shtuar për vetveten, rënien e nevojës për gjumë dhe ushqim, vështirësi në kontrollimin e impulseve, tendencën për të konsumuar drogë apo alkool dhe sjelljet që mund të jenë të dëmshme për veten e tij/saj dhe të tjerët.

Për ta shëruar këtë sëmundje është me rëndësi që të monitorohet nga ekspertët dhe të merret terapia farmakologjike për stabilizimin e disponimit e që dallon prej personi në person. Për fat të keq, nganjëherë pacienti mund të ketë nevojë për t’u shtruar në spital në mënyrë që të ketë kontroll mbi pacientin. Psikoterapia, për më tepër, është e domosdoshme për pacientin që të kuptojë nga vijnë këto shqetësime psikologjike dhe fizike, duke i mundësuar atij që të mësojë më shumë për këtë sëmundje në mënyrë që ta trajtojë dhe parandalojë. Qasja përmes sjelljes është thelbësore, duke e mësuar pacientin t’i njoh mendimet dhe qëndrimet negative, dhe si t’i zëvendësojë ato me mendime pozitive:

Duke e shpjeguar tekstin, nxënësit duhet ta interpretojnë tregimin dhe të përpiqen të sqarojnë se çfarë është çrregullimi bipolar dhe cilat mund të jen[shkaqet e saj.

- Të shikohet një dokumentar që shpjegon se çfarë është kjo sëmundje.
- Nxënësit mund të tregojnë se çfarë kanë kuptuar, dëgjuar dhe parë, duke hapur një debat për t’i këmbyer idetë e tyre në lidhje me këtë shqetësim dhe terapinë që duhet aplikuar, duke theksuar nevojën për vetë-respekt dhe përgjegjësi ndaj pacientit dhe të tjerëve.
- Nxënësit mund të shkruajnë një ese të shkurtër lidhur me çrregullim bipolar, si mund të ndikojë në jetën e pacientit dhe të dhe familjarëve të tij/saj.

Pas leximit të tregimit, mësimdhënësi duhet të përpiqet që ta fokusojë vëmendjen e nxënësit në vështirësitë që djaloshi i ka në këtë tregim, cilat mund të jenë shkaqet e sëmundjes së tij, nevoja që pacienti të jetë i vetëdijshëm për këtë, dhe si do të mund t’i ndihmonin familjarët pacientit.

Më vonë, pas ta kenë shikuar dokumentarin lidhur me këtë temë, secili nxënës do ta paraqesë mendimin e vetë lidhur me këtë temë.

Pastaj nxënësit do t’i shkruajnë mendimet dhe idetë e tyre në lidhje me këtë çështje.

Në fund, mësimdhënësi shpjegon se çfarë është çrregullimi bipolar, shkaqet e mundshme, dhe trajtimin farmakologjike të kësaj sëmundje, duke theksuar se sa i rëndësishëm është vetëdijesimi i pacientit në procesin e shërimit. Mësimdhënësi e thekson rëndësinë e përgjegjësisë së pacientit për trupin dhe veprimet e veta, duke mos harruar nevojën që pacienti duhet të vëzhgohet për të shmangur çfarëdo veprimi të dhunshëm të tij/saj kundër vetvetes ose të tjerëve.

Mariarosaria Maione
mariarosaria.maione@libero.it

Parimi nr. 6

Pëlqimi

1. Çdo ndërhyrje mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike mund të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë dhe të informuar të personit në fjalë, duke u bazuar në informata të duhura. Pëlqimi mund, aty ku është e përshtatshme, të shprehet dhe mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, pa ndonjë dëm ose paragjykim.

2. Hulumtimi shkencor mund të realizohet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë, të shprehur dhe të informuar të personit përkatës. Informatat duhet të jenë të përshtatshme, të ofrohen në një formë të kuptueshme dhe duhet të përfshijnë modalitetet për tërheqjen e pëlqimit. Pëlqimi mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye pa ndonjë dëm apo paragjykim. Përgjashtimet nga ky parim mund të bëhen vetëm në përputhje me standardet etike dhe ligjore të miratuara nga shtetet, e që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat të përcaktuara në këtë Deklaratë, në veçanti në Nenin 27, dhe në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.



3. Në raste të caktuara të hulumtimit që kryhen në një grup të personave apo në një komunitet, mund të kërkohet marrëveshje shtesë nga përfaqësuesit ligjorë të grupit apo komunitetit përkatës. Në asnjë rast nuk mundet një marrëveshje kolektive e komunitetit apo pëlqimi i udhëheqësit të komunitetit apo ndonjë autoriteti tjetër të zëvendësojë pëlqimin e informuar të një individi.

NJËSIA 13

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 6: Pajtimi

1. Çdo ndërhyrje mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike mund të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë dhe të informuar të personit në fjalë, duke u bazuar në informata të duhura. Pëlqimi mund, aty ku është e përshtatshme, të shprehet dhe mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, pa ndonjë dëm ose paragjykim.

2. Hulumtimi shkencor mund të realizohet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë, të shprehur dhe të informuar të personit përkatës. Informatat duhet të jenë të përshtatshme, të ofrohen në një formë të kuptueshme dhe duhet të përfshijnë modalitetet për tërheqjen e pëlqimit. Pëlqimi mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye pa ndonjë dëm apo paragjykim. Përgjashtimet nga ky parim mund të bëhen vetëm në përputhje me standardet etike dhe ligjore të miratuara nga shtetet, e që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat të përcaktuara në këtë Deklaratë, në veçanti në Nenin 27, dhe në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

3. Në raste të caktuara të hulumtimit që kryhen në një grup të personave apo në një komunitet, mund të kërkohet marrëveshje shtesë nga përfaqësuesit ligjorë të grupit apo komunitetit përkatës. Në asnjë rast nuk mundet një marrëveshje kolektive e komunitetit apo pëlqimi i udhëheqësit të komunitetit apo ndonjë autoriteti tjetër të zëvendësojë pëlqimin e informuar të një individi.

Titulli

“Pjetri trim”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet ta dinë kuptimin e fjalës “pajtim” dhe rëndësinë e të shprehurit të pëlqimit të ndërsjellë dhe të përgjegjshëm.

Rasti

Ne jemi fëmijët më të rritur në çerdhen tonë të fëmijëve. Vitin e ardhshëm ne do të shkojmë në shkollë. Ne tashmë e dimë se si të shkruajmë emrin tonë dhe të lexojmë fjalë të reja. Disa fëmijë tashmë dinë edhe tregime. Pjetri është një nga shokët tonë të klasës. Unë mendoj se ai është një gjeni. Ai i di të gjitha fjalët e lutjeve përmendësh, dhe mund të numërojë deri në një mijë pa bërë asnjë gabim. Por Pjetri është ndryshe nga ne. Ai është i shkurtër dhe i imët. Dikush mund të mendojë se ai është tre vjeçar. Por kjo atë nuk e pengon. Ai është gjithmonë i lumtur dhe aktiv. Nëna dhe babai i tij shqetësohen shumë për të ardhmen e tij. Ata e dinë se nëse nuk ndërmarrin diçka në lidhje me lartësinë e tij tani, do të jetë shumë vonë më pastaj. Mjeku u tha se ai duhet të marrë injeksione të veçanta gjatë një viti, me qëllim që të nxisin rritjen e eshtrave të tij. Pjetri disi kishte dëgjuar për vendimin e mjekut dhe këtë ai e hodhi poshtë në mënyrë të vendosur. “Unë nuk dua asnjë injeksion”, tha ai. “Nuk jam i sëmurë dhe nuk më pengon të jem i shkurtër. Unë jam i lumtur kështu si jam”. Pjetri nuk fjeti fare atë natë. Ai kishte frikë, dhe ishte i gatshëm të bënte fare teste. “Çfarë të bëjmë?” prindërit pyetnin

veten, “djali duhet të shtojë shtatin. Nuk ka opsion tjetër”. Disa nga miqtë e tyre sugjeruar që ta detyrojnë atë t’u nënshtrohet testeve mjekësore, disa të tjerë sugjerorin që djalin ta vënë nën anestezion e më pas ta trajtojnë. Prindërit nuk u pajtuan me asnjë nga këto sugjerime. Dina, mësimdhënësja e djalit, sugjeroi që t’i pyesin shokët e Pjetrit në çerdhen e fëmijëve se çfarë duhet bërë me Pjetrin. Një ditë, kur Pjetri qëndroi në shtëpi, prindërit e tij erdhën në klasën e tij për të marrë pjesë në një diskutim të veçantë lidhur me Pjetrin. Pasi i treguan klasës lidhur me problemin e rëndë që e kishin, dolën edhe disa sugjerime. Një sugjerim erdhi nga Debi, vajza më e re në grup, që ishte se duhet thënë Pjetrit se ai nuk do të kalojë në një klasë më të lartë me shokët e tij, sepse ai nuk është aq i pjekur dhe trim si nxënës që do të duhej të ishte në shkollë. Dina dhe prindërit e Pjetrit u pajtuan që të provojnë sipas këtij sugjerimi. Kjo doli të ishte një mrekulli. Kur Pjetri dëgjoi se ekzistonte rreziku se do të ngel edhe një vjet në çerdhe me fëmijë të vegjël, dhe pa shokët e tij, ai u ndesh me një dilemë të vërtetë. Gjithë ditën ai nuk e tha asnjë fjalë. Natën, para se të binte në gjumë, ai shkoi tek prindërit e tij dhe u tha: “Nesër do të fillojë trajtimin! Do ta shihni! Unë do të jem i guximshëm!”.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë diskutimin duke paraqitur pyetje si në vijim:

- Kush ka marrë ndonjëherë injeksion?
- Si jeni ndjerë? Para se ta merrni injeksionin? Pas marrjes së injeksionit?
- A duhet ta detyrojmë Pjetrit përkundër refuzimit të tij që ta merr injeksionin?
- A është zgjidhja e Debit e duhur?
- A keni ju ndonjë zgjidhje tjetër?

Hanna Carmi

amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 14

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 6: Pajtimi

1. Çdo ndërhyrje mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike mund të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë dhe të informuar të personit në fjalë, duke u bazuar në informata të duhura. Pëlqimi mund, aty ku është e përshtatshme, të shprehet dhe mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, pa ndonjë dëm ose paragjykim.

2. Hulumtimi shkencor mund të realizohet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë, të shprehur dhe të informuar të personit përkatës. Informatat duhet të jenë të përshtatshme, të ofrohen në një formë të kuptueshme dhe duhet të përfshijnë modalitetet për tërheqjen e pëlqimit. Pëlqimi mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye pa ndonjë dëm apo paragjykim. Përgjashtimet nga ky parim mund të bëhen vetëm në përputhje me standardet etike dhe ligjore të miratuara nga shtetet, e që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat të përcaktuara në këtë Deklaratë, në veçanti në Nenin 27, dhe në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

3. Në raste të caktuara të hulumtimit që kryhen në një grup të personave apo në një komunitet, mund të kërkohet marrëveshje shtesë nga përfaqësuesit ligjorë të grupit apo komunitetit përkatës. Në asnjë rast nuk mundet një marrëveshje kolektive e komunitetit apo pëlqimi i udhëheqësit të komunitetit apo ndonjë autoriteti tjetër të zëvendësojë pëlqimin e informuar të një individi.

Titulli

“Unë vendosi vet”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet të kuptojnë konceptin e përkatësisë në përgjithësi dhe përkatësinë e trupit të tyre në mënyrë të veçantë, kufirin që vetë të vendosin dhe nevojën që t’i kuptojnë opinionet e ndryshme.

Rasti

Kohët e fundit, unë kam qenë pak nervoz, i zemëruar dhe i shqetësuar. Sa herë që e thithja gishtin tim nëna më thoshte: “Tani je djalë i rritur! Mos e thith gishtin!” Ajo butësisht ma largonte gishtin tim nga goja, ndonjëherë pa më thënë asnjë fjalë. Mendoj se ajo i kishte treguar edhe mësimdhënësit tim që të kujdesej që ta largoja gishtin nga goja. Mendoj se nuk është e drejtë që të më pengojnë nga thithja e gishtit tim. Ata shpesh më thonë: “Nuk është e hijshme”, “Ti djalë i rritur”, “Çfarë do të mendojnë njerëzit për ty”. Unë e di se çfarë është e mirë për mua. Edhe kur isha shumë i vogël, unë e thithja gishtin. Nëna dhe babai, atëherë, ishin shumë të lumtur. Ata i tregonin gjyshes sa i zgjuar isha. “Shiko”, thoshin ata: “Jonathan e ka gjetur gishtin e vet vetvetiu. Sa herë që i vjen gjumi, ai na tregon duke e thithur gishtin e tij.” Në atë kohë, ata ishin shumë krenarë me mua. Muajin e kaluar ata u përpoqën të më ndalojnë që ta thithja gishtin. Unë vërtetë u përpoqa që t’ua bëjë qejfin atyre, mirëpo unë nuk mund të ndalem dhe as që dua të ndalem. “Ti tashmë je një djalë i rritur,” ata më thanë: “Kjo është një shprehje e keqe. Ti do t’i prishësh dhëmbët, e edhe gishtin tënd”. Ata kurrë nuk ma kishin thënë

këtë më parë. “Gishti është i imi”, u thashë. “Unë mund të bëj me atë që kam bërë gjithë këto vite.” Motra ime më e rritur më ngacmon, “Gisht-thithës” më thërret. “Unë nuk brengosem fare, askush nuk mund të më ndalojë,” i thashë asaj. Njëherë, nëna ime tentoi që të ma lyejë gishtin me mustardë. Një herë tjetër, ajo ma mbështolli gishtin me gips. Unë nuk pranoj që të tjerët të bëjnë diçka me gishtin tim. Unë vendosi vet se çfarë të bëjë me trupin tim.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë diskutimin duke paraqitur pyetje si në vijim:

- A e ke thithur ndonjëherë gishtin tënd? Në çfarë moshe ke qenë?
- Kur e ke ndërprerë këtë veprim?
- Pse e ke ndërprerë? (apo: pse nuk e ke ndërprerë?)
- A kemi të drejtë të bëjmë çfarë të duam me trupin tonë?

A mund t’i refuzojë fëmija gjërat si në vijim, në kundërshtim me vullnetin e prindërve të tij/saj:

- Të ha?
- T’i merr barnat?
- Të shkojë në shkollë?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 15

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 6: Pajtimi

1. Çdo ndërhyrje mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike mund të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë dhe të informuar të personit në fjalë, duke u bazuar në informata të duhura. Pëlqimi mund, aty ku është e përshtatshme, të shprehet dhe mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, pa ndonjë dëm ose paragjykim.

2. Hulumtimi shkencor mund të realizohet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë, të shprehur dhe të informuar të personit përkatës. Informatat duhet të jenë të përshtatshme, të ofrohen në një formë të kuptueshme dhe duhet të përfshijnë modalitetet për tërheqjen e pëlqimit. Pëlqimi mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye pa ndonjë dëm apo paragjykim. Përgjashtimet nga ky parim mund të bëhen vetëm në përputhje me standardet etike dhe ligjore të miratuara nga shtetet, e që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat të përcaktuara në këtë Deklaratë, në veçanti në Nenin 27, dhe në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

3. Në raste të caktuara të hulumtimit që kryhen në një grup të personave apo në një komunitet, mund të kërkohet marrëveshje shtesë nga përfaqësuesit ligjorë të grupit apo komunitetit përkatës. Në asnjë rast nuk mundet një marrëveshje kolektive e komunitetit apo pëlqimi i udhëheqësit të komunitetit apo ndonjë autoriteti tjetër të zëvendësojë pëlqimin e informuar të një individi.

Titulli

“Pëlqimi i informuar, e drejta e zgjedhjes”

Objektivat e mësim-nxënies

Mësimdhënësi fokusohet në konceptin e vetë-vlerësimit, duke hyrë në thelb të konceptit të pëlqimit të informuar, si dhe në përsiatjen e të drejtës për të zgjidhur në një situatë të caktuar.

Rasti

Tomi ishte një djalë adoleshent i cili vuan nga aknet e adoleshencës, dhe fytyra e tij ishte përplot puçrra një kohë. Ky ishte një problem që nuk i kishte prekur edhe aq shumicën e moshatarëve të tij; në të vërtetë, zgjidhja për këtë problem mund të gjendet në mënyrë të natyrshme. Për fat të keq, adoleshentët e shohin këtë si një fazë të vështirë për shkak se ata shpesh bëhen objekt i shakave të bashkëmoshatarëve të tyre. Tomi vendosi të mbajë një maskë për të mos e treguar fytyrën e tij, duke tërhequr kureshtjen e të gjithëve, si dhe shqetësimin e familjes dhe mësimdhënësve të tij. Në lagjen e tij dhe në shkollën e tij filluan të shfaqen spekulime shqetësuese, që çonin në një sëmundje serioze, një aksident, apo një tatuazh të madh të fisit Maori. Tomi, i cili është shumë i turpshëm, vendosi të reagojnë në këtë mënyrë ndaj kësaj faze normale të rritjes së tij. Ai ua bëri të ditur prindërve arsyen e sjelljes së tij, dhe të cilët pastaj ua përcollën këtë informatë mësimdhënësve. Në këtë moment, mësimdhënësi e shfrytëzoi rastin që të zhvillojë një reflektim në mesin e nxënësve dhe vendosi që t’ua shpërndajë një pyetësor. Ky pyetësor përmbante pyetje personale dhe nuk përfshinte tema që ishin pjesë e programit arsimor të shkollës. Problemi që u parashtrua ishte nëse mësimdhënësi duhej të kërkonte pëlqimin e nxënësve dhe nëse duhej ta merrte pëlqimin e prindërve të tyre

në zhvillimin dhe përdorimin e këtij mjeti. Mësimdhënësi ishte i interesuar ta kuptonte se si adoleshentët e zhvillojnë kuptimin e pëlqimit të informuar.

Loja

Nxënësit propozojnë ndërrimin e roleve. Mësimdhënësi u ndihmon që ta strukturojnë këtë ide për përvojë arsimore. Ndajeni klasën në dy grupe: disa nxënës e luajnë rolin e fëmijëve, ndërsa të tjerët rolin e prindërve të tyre. Fëmija që merr pjesë në lojë luan rolin e atij që vepron në mënyrë negative: me përgjigjen e tij/saj “në vend të..”. Me ndihmën e mësimdhënësit, nxënësit i parashtrojnë pyetjet që diskutohen në formë të dialogut, duke i gjetur përgjigjet për pyetësorët duke e luajtur një skenë tipike familjare. Tani, ata duhet ta identifikojnë problemin, duke i ndarë dyshimet dhe emocionet e tyre. Loja e merr një karakter katarse. Ajo u mundëson fëmijëve të vetëdijesohen në mënyrë të qartë lidhur me atë se si ndjehen kur janë “subjekt” për shkak të pozitës së akterit që e kanë në këtë lojë, dhe kjo ua hap mendjen fëmijëve që të ndjejnë se janë absolutisht në gjendje ta ushtrojnë të drejtën e pëlqimit, në mënyrë të vetëdijshme.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Një zgjidhje e përbashkët dhe harmonike mund të jetë hapi i parë drejt zhvillimit të një shkallë të vlerave. Në lidhje me të dy situatat që janë paraqitur nga nxënësit, shtrohet pyetja se si adoleshentët kanë perceptuar situatën dhe, si rezultat, kanë reaguar gjatë zhvillimit të kësaj situatë ku reflektimi kryesor lidhur me Nenin 6 të Deklaratës, bazohet në konceptin e pëlqimit të informuar. Nxënësit, në të vërtetë, janë në gjendje ta kuptojnë konceptin e lirisë së zgjedhjes dhe të përgjegjësisë pasi të jenë informuar lidhur me një situatë, që në këtë rast, ndërlidhet me moshën e tyre dhe aftësitë e tyre njohëse.

Ajo që është e habitshme është fakti se, në fillim, subjekti i lojës me role që është trajtuar përmes ndërrimit të roleve referuese (nxënësit/prindërit), e konsideron pëlqimin e nxënësve si një praktikë të re e cila u mundëson atyre që të hyjnë në thelb të konceptit të pëlqimit të informuar dhe të mendojë lidhur me të drejtën e zgjedhjes në një situatë të caktuar.

Në këtë rast, mësimdhënësi duhet ta drejtojë dhe ta mbështes, në mënyrë neutrale, qëndrimi i tyre ndaj vendimit për t'i bashkuar rrugët eksperimentale në mënyrë të vetëdijshme. Pyetjet që kanë të bëjnë me dilemat etike shtrohen në atë mënyrë që, në rastin konkret, u mundëson nxënësve të bëhen akterë të iniciativës. Në të vërtetë, kërkohet pëlqimi i tyre i lirë dhe i informuar për ta aktivizuar projektin dhe veprimet për të mirën e tyre.

Mësimdhënësi përqendrohet në konceptin e vetë-vlerësimit për ta promovuar integrimin e mendimeve të ndryshme që ofrohen nga nxënësit të cilët luajnë role të ndryshme.

Francesca Piccolo

francescapiccolo90@gmail.com



NJËSIA 16

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 6: Pajtimi

1. Çdo ndërhyrje mjekësore parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike mund të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë dhe të informuar të personit në fjalë, duke u bazuar në informata të duhura. Pëlqimi mund, aty ku është e përshtatshme, të shprehet dhe mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, pa ndonjë dëm ose paragjykim.

2. Hulumtimi shkencor mund të realizohet vetëm me pëlqimin paraprak, të lirë, të shprehur dhe të informuar të personit përkatës. Informatat duhet të jenë të përshtatshme, të ofrohen në një formë të kuptueshme dhe duhet të përfshijnë modalitetet për tërheqjen e pëlqimit. Pëlqimi mund të tërhiqet nga personi përkatës në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye pa ndonjë dëm apo paragjykim. Përgjashtimet nga ky parim mund të bëhen vetëm në përputhje me standardet etike dhe ligjore të miratuara nga shtetet, e që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat të përcaktuara në këtë Deklaratë, në veçanti në Nenin 27, dhe në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

3. Në raste të caktuara të hulumtimit që kryhen në një grup të personave apo në një komunitet, mund të kërkohet marrëveshje shtesë nga përfaqësuesit ligjorë të grupit apo komunitetit përkatës. Në asnjë rast nuk mundet një marrëveshje kolektive e komunitetit apo pëlqimi i udhëheqësit të komunitetit apo ndonjë autoriteti tjetër të zëvendësojë pëlqimin e informuar të një individi.

Titulli

“Panairi i librave të përdorura”

Objektivat e mësim-nxënies

Të kuptohet çfarë dhe si nxënësit e kuptojnë konceptin e lirisë dhe përgjegjësisë së zgjedhjes, pasi të informohen lidhur me një situatë, në bazë të moshës së tyre dhe kushtet e tyre të jetesës. Roli i mësimdhënësit është të mbështesë, në mënyrë neutrale, qëndrimin e tyre ndaj vendimit që ta shprehin në mënyrë të vetëdijshme se çfarë duan me anë të pëlqimit.

Rasti

Nxënësit e klasës së dytë (pjesa A) kërkojnë leje nga mësimdhënësit e tyre që ta ngritin dhe menaxhojnë një treg të gjërave të përdorura vetvetiu. Ata propozuan që ta përgatisin një listë të librave të vjetra shkollore që nuk janë më të nevojshme dhe gjëra tjera që ata dëshirojnë t’i ndërrojnë. Mësimdhënësi ka vendosur që t’i mbështesë. Pyetja e parë që nxënësit ia bënë ishte nëse ata duhej ta merrnin pëlqimin e prindërve të tyre për t’i dhuruar librat e tyre. Mësimdhënësi përpigjet të drejtojë një diskutim konstruktiv duke i integruar të gjitha opinionet dhe pritjet e nxënësve që e kanë ngritur panairin e librave të përdorura. Dilema kryesore që ata kanë ishte: Kush duhet ta plotësojë formularin e pëlqimit për dhënien apo shkëmbimin e librave të tyre të vjetra? A duhet të jenë vetë nxënësit apo prindërit e tyre, të cilët fillimisht i kanë blerë ato libra që fëmijët e tyre dëshirojnë t’i shkëmbejnë? Disa nxënës ofruan që t’i shkëmbejnë librat për të tjerët, ndërsa nxënësit tjerë kërkonin që t’i shesin librat e tyre të përdorura, d.m.th që blerësi t’u jep atyre një shumë të vogël të parave në mënyrë vullnetare. Paratë që mbliidhen do të shkojnë në fondin e klasës dhe do të përdoren për të blerë materiale

tjera mësimore, ose për udhëtime të organizuara të klasës. Pra, në këtë rast, ata kërkojnë që të ndihmohen në këtë vendim-marrje: Kush duhet ta jep pëlqimin përkatës? Prindërit e tyre si pronarët fillestarë të librave që janë blerë në të kaluarën? Ose a mund ta bëjnë këtë ata vetë si përdoruesit e librave që do të shkëmbehen? Nxënësit investojnë shumë përpjekje për t'i zgjidhur këto çështje dhe për të kuptuar modelin e konsensusit që do të arrihet. Vetëm pas kësaj, do të jetë e mundur, me ndihmën e mësimdhënësit të tyre, të organizohet një panair dy ditorë i librave të përdorura ku do të përfshihet e tërë shkolla dhe të tjerë për t'i shkëmbyer ose shitur librat e tyre të vjetra.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Në lidhje me këtë mundësi të trajnimit, nxënësit duan të dinë se kush, dhe në çfarë kushtesh, ka të drejtë të jep pëlqimin për t'i dhuruar apo shitur librat e vjetra që dikur përdorëshin nga nxënësit. Atyre u intereson të dinë nëse e drejta për të dhënë pëlqimin varet nga ajo se kush është pronar i një artikulli të caktuar, në këtë rast janë prindërit të cilët fillimisht i kanë blerë librat. Apo dhënia e pëlqimit është e lidhur me funksionin, e si rezultat i kësaj, nxënësit si të vetmit përdorues të librave, pra, janë edhe pronarët e tyre? Pra, nxënësit u pyetën nëse ata mund t'i ushtrojnë të drejtat e plota mbi këto libra dhe a e kanë lirinë të bëjnë kërkesë për pëlqimin e informuar siç përcaktohet me Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve. Ata, po ashtu, donin të dinin se si mund ta ushtrojnë këtë të drejtë në bazë të parimeve të autonomisë dhe të drejtën për të bërë zgjedhjet e tyre.

Metodologjia i përket përvojës në terren: aktivitete në të cilat nxënësit lëvizin si në jetën e përditshme, flasin, ndërmarrin veprime, e jo vetëm të vëzhgojnë, por të luajnë një rol aktiv, duke fituar njohuri për botën që i rrethon dhe të tjerët. Qëllimet janë: t'i shprehin emocionet e tyre duke debatuar me të tjerët, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje të përbashkët, lidhja me bashkëmoshatarët e tyre, zhvillimi i kapaciteteve që të bëjnë zgjedhje të përgjegjshme në lidhje me marrëdhëniet në familje, të kenë qëndrime të përgjegjshme, dhe të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë me të tjerët.

Francesca Piccolo

francescapiccolo27@gmail.com



Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]


Parimi nr. 7

Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t'u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.



NJËSIA 17

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 7: Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t'u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.

Titulli

“Çfarë ndodhi me flokët e Sofisë?”

Objektivat e mësim-nxënies

- Ta kemi të qartë kuptimin e pëlqimit
- T'i kuptojmë ata që nuk janë në gjendje ta japin pëlqimin (të rinjtë, kafshët dhe qeniet tjera të gjalla)
- Ta kuptojmë përgjegjësinë që një individ duhet ta ketë kur merr vendime për të tjerët.

Rasti

Sofia është një kukull, ajo është kukulla më e madhe në kopshtin tonë të fëmijëve. Ajo ka flokë të gjata dhe të zeza, dhe ne mund t'ia krehim flokët, të formojmë bishtaleca apo t'ia bëjmë flokët të dredhura. Ajo i ka qerpikët e gjatë, dhe ajo është në gjendje t'i hap dhe t'i mbyllë sytë dhe gjithmonë është e buzëqeshur. Sofia ka shumë rrobave. Ne ia ndërrojmë asaj teshat rregullisht dhe i mbajmë ato në një sirtar të veçantë. Një ditë, ishte shumë nxehtë, më kujtohet shumë qartë, unë desha të luaj me Sofinë. Kur iu afrova, nuk e njoha atë. Dikush ia kishte prerë flokët Sofisë, ia kishte shkurtuar. Ishte aq e shëmtuar, mora Sofinë dhe e përqafova. “Kush e bëri këtë?”, bërtita. Të gjithë fëmijët u mbledhën rreth meje për të parë se çfarë kishte ndodhur. Kur e panë Sofinë, fëmijët u tronditën. Flokët e bukura të Sofisë ishin zhdukur pothuaj tërësisht. Mësimdhënësja jonë e dëgjoji zhurmën, erdhi me vrap për ta parë fatkeqësinë që kishte ndodhur. “Kush e bëri këtë?” pyeti ajo. “Unë e kam bërë”, tha Gabi, fëmija më i madh në

klasën tonë. “Sot bën shumë nxehtë” tha ai, “Unë mendoj se Sofi po vuante nga vapa. Flokët e bënin edhe më të ngrohtë. Unë mendoj se ajo do të preferonte t’i kishte flokët e shkurtra”. Ne e shikuam atë, ai është një djalosh i zgjuar, ai e di që Sofia nuk mund të flas apo ta jep pëlqimin e saj për ndonjë gjë. “A të tha ajo t’ia shkurtosh flokët?” pyeti Amosi. “A e pyete nëse ajo donte t’i shkurtonte flokët?” pyeti mësimdhënësja. “Unë e di se çfarë është më e mirë për të” u përgjigj Gabi: “Sot është shumë nxehtë. A nuk po e kuptoni? Shikoni se çfarë rrobash ajo ka veshur. Fustan prej leshi dhe pallto të rëndë! Askujt nuk i shkoi mendja t’ia ndërrojë rrobat. Unë e di çfarë është më së miri për të”, e përsëriti ai. “Kjo na takon të gjithëve të vendosim. Sofia na takon të gjithëve, dhe të gjithë ne e ndajmë përgjegjësinë për të,” tha mësimdhënësja. “Nëse nesër bën ftohtë, çfarë do të bësh ti?”. Gabi u zu ngushtë. Ai mendonte se kishte të drejtë të vendoste për Sofinë të cila nuk mund të fliste, nuk mund të qante, dhe nuk mund të merrte vendime për vetveten. Koha kalonte. Ngadalë ne harruam se çfarë kishte ndodhur, ne luanim me Sofinë si zakonisht dhe u mësua me flokët e saj të shkurtër. Si gjithnjë, ajo ishte e lumtur, dhe nuk ndalej së qeshuri. Ajo nuk brengosej fare.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë diskutimin duke paraqitur pyetje si në vijim:

- A mundet kukulla të flas me ne? Nëse jo, pse?
- Kush duhet të vendosë se çfarë duhet bërë me kukullën?
- A mundet një foshnjë të flas me ne? Nëse jo, pse?
- Kush duhet të vendosë se çfarë duhet bërë me foshnjën?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 18

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 7: Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t'u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.

Titulli

“Lejleku në çati”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet ta zhvillojnë ndjeshmërinë ndaj qenieve të rrezikuara, të mësojnë ta respektojnë të drejtën për liri të çdo qenie të gjallë, dhe t'i kuptojnë kufijtë e lirisë sonë.

Rasti

Unë quhem Kelly. Unë kam shumë shokë në klasën time dhe në lagje. Unë kam edhe shokë tjerë, si për shembull, qenin tim, dy macet e mia dhe dy lejlekët që vijnë një herë në vit që të qëndrojnë në folenë e tyre në çatinë e shtëpisë sonë. Lejlekët tashmë më njohin dhe fluturojnë shumë ulët për të më parë. Unë i ushqej dhe i përkëdheli. Ata vijnë në vjeshtë rrugës për në vende më të ngrohta, ku mund të gjejnë ushqim. Lejleku mashkull është i bardhë dhe pendët në kokë i ka ngjyrë gri. Lejleku femër është krejtësisht e bardhë. Unë mund t'i dallojë nga larg. Duket se edhe ata na njohin ne dhe shtëpinë tonë edhe pas një viti të tërë. Ata janë aq të zgjuar! Ne kujdesemi për folenë e tyre kur largohen, sepse e dimë se ata do të kthehen vjeshtën e ardhshme. Ata vetëm i shtojnë disa degë të vogla në folenë e tyre që t'i ngrohtë zogjtë e tyre porsalindur. Këtë vit lejleku femër i qeli katër vezë. Disa javë më vonë, ne dëgjuam cicërimat që vinin nga foleja. Në fole ishin katër zogj me lesh dhe ngjyrë të verdhë. Një nga dy

lejlekët gjithmonë e ruante folenë, ndërsa tjetri fluturonte gjithandej për të sjellë ushqim. Një ditë e pashë lejkun mashkull duke qëndruar pranë folesë, një nga krahët e tij nuk dukej se ishte në rregull. Mua mu duk se e kishte thyer krahun. E thirra babanë: “Shiko, diçka nuk është në rregull me krahun e lejkut mashkull”. Babai im ishte shumë i shqetësuar. Ai tha: “Lejleku mashkull nuk mund të fluturojë. Lejleku femër nuk mund të sjellë ushqim të mjaftueshëm për zogjtë e saj. Zogjtë nuk do të rriten mjaftueshëm për të fluturuar për në vendet e ngrohta. Ata do të vdesin”. Babai im u ngjit në çati në përpjekje për ta zënë lejkun mashkull dhe për ta dërguar tek veterinari. Lejleku i gjerë kishte frikë, pasi që askush deri atëherë nuk e kishte detyruar të bëjë diçka. Ai u hodh në çati duke lëvizur rreth folesë dhe e drejtoi sqepin e tij sikur donte të na thoshte: “! Jo, jo, mos më lëndoni! Mos më prek”. Me një lëvizje të shpejtë, babai im e zuri lejkun që përpëllte nga këmbët dhe e dërgoi tek veterinari.


Veterinari ia lidhi krahun e thyer me një fashë. Ai na tha se brenda pak ditëve lejleku do të jetë në gjendje të fluturojë. Në ndërkohë, ne sollëm ushqim të veçantë për zogjtë e uritur. Lejleku femër mund të pushonte tani. Nuk jam e sigurt nëse lejleku mashkull e ka kuptuar veprimin e babait tim dhe nëse ia ka falur, mirëpo, dy muaj më vonë, para se familja e lejkëve të niseshin në udhëtim e tyre të gjatë, lejleku mashkull dhe lejleku femër dhe katër zogjtë e tyre tashmë të rritur trokitën me sqepat e tyre në xhamin e dritares sikur donin të na thoshin: “Lamtumirë, ju faleminderit, shihemi vitin e ardhshëm”.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë diskutimin duke paraqitur pyetje si në vijim:

- - Pse lejkët nuk qëndrojnë gjatë tërë vitit në të njëjtin vend?
- Pse lejkët kthehen çdo vit në të njëjtin vend?
- A jemi ne pronarë të lejkëve?
- A mund të flasim me lejkët? A mund të luajmë me ta?
- Çfarë do të kishte ndodhur me lejkun sikur babai të mos e kishte ndihmuar?
- A u pajtua lejleku që të ndihmohej nga babai im?
- A veproi babai në mënyrë të duhur? Pse?
- Po të ishte lejleku, a do të pajtoheshe të ndihmoheshe nga babai?

Hanna Carmi
annoncarmi@gmail.com



NJËSIA 19

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 7: Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t’u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.

Titulli

“Nuk po të shoh, por po të ndjejë”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të kërkohet një mënyrë për ta zhvilluar vetëdijesimin e përbashkët të nxënësve ndaj çështjeve që janë vështirë të paraqytyrohen madje edhe nga të rriturit.
- Të realizohet një gjykim në formë të lojës së identifikimit dhe reagimit shqisor nëpërmjet një përgjigje kreative dhe në formë grafike.
- Të nxjerrët një opinion vetëdijesimi që rrjedhë nga informatat e sakta lidhur me rastin që diskutohet.
- Mishërimi i vlerave të Deklaratës Universale, ku duhet të përsiatet lidhur me: gjërat e shenjta/cilësinë e jetës; bamirësinë/autonominë; mbrojtjen/vetëvendosjen; solidaritetin/individualizmin; hulumtimet shkencore/shëndetësore/individin.

Rasti

Në klasë, mësimmshënësi dhe fëmijët i diskutojnë ngjarjet aktuale dhe lajmet: shumë nga këto ngjarje e tërheqin vëmendjen e fëmijëve në mënyra të ndryshme. Mundësitë për diskutim, një

mënyrë për të kuptuar jetën, ngjarjet aktuale, në këtë mënyrë shuhet etja për informata dhe vetëdijesim lidhur me temat e veçanta gjatë vitit për të fituar opinionet e tyre lidhur me dilemat e bio-etikës. “Eluana, e drejta për të zgjedhur të jetojë apo të vdes ushtrohet nga prindërit”, është një rast që tërhoqi vëmendjen e botës dhe nxënësit kishin dëgjuar për të. Për fat të keq, në të gjithë botën ka raste të tilla: njerëz në gjendje të pavetëdijshme, aftësia e të cilëve për të bërë zgjedhje mund të vihet në pikëpyetje. Eluana, pas një aksidenti me makinë, ka ra në gjendje kome të thellë dhe të pakthyeshme për vite me radhë, dhe asnjë mrekulli mund të ndryshojë gjendjen e saj. Kanë kaluar pothuajse 20 vjet nga tragjedia: prindërit e saj tashmë janë plakur dhe kishin bërë teste të ndryshme para se të kuptonin se nuk mund ta ndryshojnë faktin se vetëm aparatet e mbajnë të gjallë fëmijën e tyre të vetëm, prandaj kishin vendosur për t’i dhënë fund trajtimit të saj. Pasojë e sigurt dhe e drejtpërdrejtë e vendimit të tyre është vdekja e vajzës së tyre. E gjithë bota e kuptoi këtë çështje të dhimbshme familjare dhe të gjithë përpiqeshin të vireshin në lëkurën e prindërve të pacientes. Shumë vite u shpenzuan nëpër gjykata për të përcaktuar se kush duhet ta ushtrojë të drejtën për ta ruajtur jetën e Eluanës, meqenëse ajo ishte në gjendje të pavetëdijshme (edhe pse është e pamundur për shkencën dhe mjekët që të jenë në mënyrë absolute të sigurt për një mungesë totale të perceptimit të nënvetëdijshëm). Në Itali, Kushtetuta nuk e njeh të drejtën e eutanazisë dhe prindi i vetëm i gjallë që ushtron të drejtën e prindit është dashur ta zhvillojë betejën e tij për të siguruar të drejtën e vajzës së tij Eluanës për një jetë me dinjitet dhe vdekje. Prindi i qëndroi besnik bindjeve të tij dhe vullnetit të vajzës së tij dhe u pajtua që t’i jepet fundi jetës së saj duke e ditur se vajza e tij nuk do të jetë më në mëshirën e një respirator, pa burime financiare dhe e vetme në një krevat të spitalit.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Pyetja e parë:

Si do të silleshit ju nëse, pas 20 vjetësh, ju nuk do të mund të kujdeseshit për të: çfarë do të duhej të vendosej lidhur me jetën e saj, kur nuk mund të dihet sa do të zgjas gjendja e tillë.

Pyetja e dytë:

Po të ekzistonte mundësia e një trajtimi eksperimental që paraqet një rrezik të lartë për shëndetin e pacientit, madje edhe nëse ka probabilitet statistikor për sukses, çfarë do të vendosnit lidhur me dhënien ose jo të pëlqimit për ta administruar atë trajtim të rrezikshëm eksperimental?

Mësimdhënësi vëren që nxënësit nuk mund të japin mendime të qarta: shumë përgjigje janë të paqarta, disa të tjerë përpiqen të bëjnë mimikë në mënyrë ironike duke thënë se gjendja “ishte e pavetëdijshme”. Mësimdhënësi propozon lojën e identifikimit shqisor.

Mësimdhënësi, para se të nisë diskutimin, i bënë disa pyetje që kanë për qëllim t’i udhëzojnë fëmijët lidhur me konceptet që do të trajtohen, siç janë: mungesa e të mirave për integritetin personal dhe jetën e individit; pamundësia për të ushtruar të drejtën e gjyqimit të qartë; vlerësimi i për t’i dhënë përparësi interesit më të mirë personal të individit. Pastaj, mësimdhënësi i informon nxënësit lidhur me kufizimet ligjore të prindit dhe/ose kujdestarit: obligimi i mbajtjes (që lidhet me funksionin e kujdesit); marrja në konsideratë e kapaciteteve, prirjet, aspiratat e fëmijës ose personit i cili nuk ka kapacitet të shprehë pëlqimin; ushtrimi i të drejtës nënkupton interesin ekskluziv të personit. Në fund, mësimdhënësi ofron informata lidhur me rolin e mjekut: ai duhet të japë informata të duhura dhe të qarta, duhet të respektojë obligimin për të mbrojtur dhe kujdes, dhe duhet të sigurojë marrjen e pëlqimit. Përdorimi i përmbajtjes e trajtimit mjekësor, që rrjedh nga Nenet e Deklaratës Universale, dhe shtrihet nga respekti për

qenien njerëzore. I njëjti kufizim mund të aplikohet për të gjitha trajtimet shëndetësore të padëshiruara. Mësimdhënësi provon të luajë një rol ku ai mund të jetë në të njëjtën gjendje si Eluana, me vetëdije të humbur që mjekët e kanë përcaktuar në mënyrë të qartë, ndërsa nxënësit, si trashëgimtarë të vetëm të testamentit të tij, prandaj edhe kujdestarët e tij, ftohen që ta ushtruar të drejtën e mbrojtjes së tij.

Qëllimi më e vështirë në mësimdhënien e bio-etikës është që t'u shpjegohet çdo gjë djemve dhe vajzave të reja të moshës 11 deri në 14 vjet, të cilët vëmendjen e përqendrojnë në gjërat që i joshin në rrjetet sociale dhe media, shpesh pa i kushtuar vëmendje përgjigjeve të tyre personale. Funkcioni i mësimdhënësit në kontekstin e Nenit 7 të bëhet veçanërisht e rëndësishme për të zgjedhur metodologjinë e duhur dhe aftësinë për të nxjerrë mendime të vetëdijshme që dalin nga informatat e shumta dhe të sakta, dhe t'i merr parasysh pikëpamjet e shumta.

Për lexim

Filmi “Mos shih keq, mos dëgjo keq” Gene Wilder 1986

Francesca Piccolo
francescapiccolo90@gmail.com



NJËSIA 20

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 7: Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t’u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.

Titulli

Autizmi - “Një mënyrë e re e komunikimit”

Objektivat e mësim-nxënies

- T’u shpjegohet nxënësve se “autizmi” karakterizohet nga një mënyrë të veçantë e disa fëmijëve për të reaguar ndaj situatave të jashtme dhe për të komunikuar. Shpesh, këta fëmijë me autizëm fshihen në realitet e tyre, ku të huajt nuk kanë qasje dhe nuk mund të komunikojnë me ta.

- T’i informojnë nxënësit me simptomat e sjelljes së këtij çrregullimi në mënyrë që të provohet t’u ndihmohet fëmijëve me autizëm që të komunikojnë me të tjerët dhe anasjelltas, në mënyrë të lehtë dhe efikase.

Rasti

“Angjelo”

Ana është një mësimdhënëse italiane që punon në një shkollë fillore. Sot ishte dita e saj e parë në punë në një shkollë të re. Në klasën e saj, ishin dymbëdhjetë fëmijë, të gjithë të ngazëllyer që kishin një mësimdhënëse të re. Mirëpo, ishte vetëm një fëmijë, i quajtur Angjelo, i cili, në vend që të qeshte dhe luante me të tjerët, rrinte vetëm, nuk fliste me askënd dhe nuk e shikonte mësimdhënësen në sy. Për fat të keq, të gjithë fëmijët e kishin izoluar Angjelon, duke e konsideruar si të “çuditshëm”, sepse ai nuk dëshironte të luante me ta fare.

Ana, kur e kuptoi se qëndrimi i këtij fëmije nuk ishte shoqëruar dhe nuk tregonte interesim, vendosi t'i afrohet. Kështu, ajo e pyeti për emrin, duke u përpjekur të nis një dialog me të. Fëmija, megjithatë, nuk u përgjigj dhe vazhdoi t'ia ngul sytë disa fletëve të letrës me ngjyra. Ana e pa atë duke shkarravitur në letër duke përdorur ngjyrat në mënyrë të fortë. Pastaj, Ana, me një zë të butë dhe të qetë, e pyeti fëmijën të shpjegonte se çfarë po vizatonte, mirëpo Angjelo përsëri nuk iu përgjigj. Në ditët në vijim, sjellja e djaloshit vazhdoi të jetë e çuditshme; në fakt, ai nuk shoqërohej fare me fëmijët tjerë dhe vazhdimisht i bënte të njëjtat gjeeste, si për shembull, vizatonte rrathë apo lëvizte duart. Për më tepër, ai shpesh shpërthente me zemërim ndaj shokëve të tij, kur ata nuk ia plotësonin dëshirat, si për shembull, kur ai kërkonte stilolaps nga ata. Fëmijët tjerë jo gjithmonë e kuptonin sjelljen e tij dhe, për këtë arsye, përpiqeshin të rrinin sa më larg tij. Një ditë, derisa fëmijët ishin duke vizatuar, Angjelo filloi t'i hedh lapsat e tij me ngjyra. Mësimdhënësja, në vend se ta qortonte, u përpoq ta qetësonte, mirëpo djaloshi nuk qante kokën për askënd. Vetëm kur Ana i tha se nëse nuk qetësohej, ajo do ta thirrte nënën e tij, e bëri Angjelon të qetësohej. Fëmijët tjerë, që gjendeshin aty afër, u frikësuan, dhe për këtë arsye, Ana vendosi ta takonte nënën e Angjelos për të folur lidhur me sjelljen e tij.

Metodologjia e mësimdhënies

Autizmi është një çrregullim i identifikuar së pari nga psikiatri Leo Kanner në vitin 1943. Në studimet e tij, Kanner e përshkroi sjelljen e disa fëmijëve që vepronin në të njëjtën mënyrë, për shembull, nuk shfaqnin fare interesim për botën që i rrethon, nuk shoqëroheshin me fëmijët tjerë, as nuk përgjigjeshin në pyetjet më të thjeshta, duke qenë në iluzion dhe duke shfaqur shpërthime të pakontrollueshme. Simptomat e këtij çrregullimi zakonisht shfaqen në fazën e hershme të jetës së fëmijës dhe kryesisht manifestohen me vështirësi në të folur dhe komunikim, si dhe shqetësim emocional me të dy prindërit dhe me shokët.

Shkaqet e këtij çrregullimi ende nuk janë të qarta, mirëpo disa studime sugjerojnë se autizmi mund të shkaktohet nga dëmtimi i sistemit nervor, gjatë zhvillimit të fëmijës.

Për fat të keq, është jashtëzakonisht vështirë të menaxhohet një fëmijë me këtë problem, edhe pse në shkollë, mësimdhënësi gjithmonë përpiqet që t'i përfshijë ata në aktivitete mësimore dhe t'i bëjë ata të shoqërohen me fëmijët tjerë, me ndihmën dhe mbështetjen e mësimdhënësit, duke punuar me ta në nivel të komunikimit verbal dhe jo-verbal. Pra, dilema jonë është që t'i identifikojmë zgjidhjet e mundshme për t'i integruar fëmijët me autizëm në klasë dhe si të komunikojmë me ta në mënyrë efektive; për shembull, para së gjithash, provoni të komunikoni me fëmijët me autizëm nëpërmjet gjeesteve për ta krijuar kontaktin e parë, dhe pastaj, udhëzoni ata dhe tregojuni se çfarë duhet të bëjnë, në vend që t'u thoni gojari. Në fakt, fillimisht është e rëndësishme që të vëni kontaktin me sy. Pyetjet që jua bëni këtyre fëmijëve duhet të jenë shumë të thjeshta, të qarta, dhe, përveç kësaj, duhet t'ua demonstroni. Kërkesat ndaj tyre duhet të bëhen pak nga pak, dhe në bazë të progresit të bërë, këta nxënës duhet t'i shpërbleni. Më në fund, ne duhet të përpiqemi që këta fëmijë të fokusohen në atë se çfarë bëjnë fëmijët tjerë, dhe t'i integrojmë ata në klasë. Për mësimdhënësit është e rëndësishme që të jetë i qetë dhe të transmetojë qetësi dhe durim, sepse vetëm duke i pasur këto cilësi, ata mund të ndjekin rrugën me një fëmijë me autizëm dhe të arrijnë rezultate.

Lexoj fëmijëve historinë e Angjelos. Pas kësaj, pyeti fëmijët që ta interpretojnë këtë tregim, duke e përqendruar vëmendjen e tyre në sjelljen e Angjelos dhe pse ai ishte i dhunshëm në disa situata dhe me njerëz të rinj. Pasi të shikohet një dokumentar apo pas leximit të artikujve që kanë të bëjnë me këtë temë, kërko nga fëmijëve ta sqarojnë se çfarë mendojnë për autizmin dhe se si do të ishte sikur të kishin në familje një fëmijë me autizëm me të cilin është vështirë të bashkëveprohet. Më vonë, kërkon nga nxënësit të përpiqen që të gjejnë zgjidhje të mundshme për integrimin e fëmijëve me autizëm në shkollë. Pastaj, shpjegoni se çfarë është autizmi, duke u fokusuar në sjelljen e fëmijëve me autizëm, problemet e tyre për të reaguar, në krijimin e

marrëdhënieve me të tjerët dhe komunikim me njerëzit që nuk i njohin. Në fund, kërko nga fëmijët t'i shkruajnë mendimet e tyre për këtë temë, duke i dhënë rëndësi të veçantë zgjidhjeve të tyre për arsimim gjithëpërfshirës dhe teknikat e komunikimit që ata do t'i aplikojnë kur flasin me fëmijët me autizëm.

Mariarosaria Maione
mariarosaria.maione@libero.it

NJËSIA 21

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 7: Personat që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin

Në përputhje me ligjet vendore, mbrojtja e veçantë duhet t’u ofrohet personave që nuk kanë kapacitet të japin pëlqimin:

(a) autorizimi për hulumtim dhe praktikë mjekësore duhet të merret në përputhje me interesin më të mirë të personit përkatës dhe në pajtim me ligjet vendore. Megjithatë, personi përkatës duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në procesin e vendim-marrjes për dhënien e pëlqimit, si dhe në tërheqjen e pëlqimit;

(b) Hulumtimi duhet të zbatohet vetëm nëse është në funksion të përfitimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, që bëhet në bazë të autorizimit dhe kushteve mbrojtëse të përshkruara me ligj, dhe nëse hulumtimi nuk ka alternativë tjetër me efikasitet të krahasueshëm dhe me pjesëmarrësit që janë në gjendje të japin pëlqimin. Hulumtimi i cili nuk ka ndonjë përfitim të mundshëm shëndetësor të drejtpërdrejtë duhet të zbatohet vetëm si përjashtim, me kujdes të veçantë, duke e ekspozuar personin vetëm ndaj një rreziku dhe barre minimale, dhe nëse ai hulumtim pritet të kontribuojë për të mirën e shëndetit të personave tjerë në të njëjtën kategori, varësisht nga kushtet e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut. Refuzimi i personave të tillë për të marrë pjesë në hulumtim duhet të respektohet.

Titulli

“Dhe nëse vendosi t’ia falë veshkën vëllait tim”

Objektivat e mësim-nxënies

- Zhvillimi i shkathtësive analitike lidhur me vendimet që fëmijët mund t’i shprehin kur e japin pëlqimin e tyre në rastet kur bëhet fjalë për shëndetin e tyre;
- Promovimi i një diskutim lidhur me parimin e autonomisë dhe të vetëvendosjes së pacientëve që janë të mitur;
- Përvetësimi i shkathtësive për të pyetur dhe krahasuar çështjet e “hapura” etike që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut nëpërmjet debateve dhe raporteve.

Rasti

Nicholas dhe David gjithmonë kanë ndarë gjithçka: interesimet, lojërat, aventurat. Si shokë të pandashëm, ata janë të lidhur nga një fat i përbashkët, një fije të padukshme që lidh jetën e tyre. Në moshën tetë vjeçare, Davidi, vëllai më i vogël, u infektua nga inflamacioni i streptokokut që shkaktoi nefritin e si pasojë u dëmtua sistemi imun i veshkave, që më pas shkaktoi dëmtimin e veshkave. Të gjitha trajtimet e mundshme deri më tani kanë qenë të kota. Nicholasi ishte

thellësisht i shqetësuar lidhur me sëmundjen e Davidit dhe mbeti pa fjalë kur nëna e tij i tha se zgjidhja e vetme e propozuar nga prof. Parker ishte transplantimi i veshkës. Lidhur me dhurimit të organeve nga të afërmit, rreziku i refuzimit ishte minimal. Prindërit e tij ofruan të dhurojnë një nga veshkat e tyre për ta shpëtuar jetën e Davidit, mirëpo, madhësia e organeve të tyre nuk i përshtatet trupit të një fëmije tetë vjeçar. Zgjidhja e vetme mbetej që të gjendet një donator në pajtueshmëri të plotë me pacientin. Si rezultat, nuk mbetej asgjë tjetër për të bërë, pos për t'u regjistruar në listën e pritjes. Përveç nëse...

Një mendim lindi në mendjen e Nicholasit, duke ushtuar si një daulle: ta dhurojë veshkën për t'ia shpëtuar jetën e Davidit. Ai vendos të bisedojë me nënën e vetë. Veshka e një të riu do të jetë e madhësisë së duhur dhe organi i tij mund t'i përshtatet plotësisht. Njeriu mund të jetojë vetëm me një veshkë: këtë e kishte lexuar në një revistë shkencore. Pas i konsultoi disa uebfaqe, ai i largoi të gjitha paqartësitë dhe frikën nga koka e tij. Wikipedia raportonte për raste të shumta ku të mbijetuarit ishin në gjendje të shkëlqyeshme shëndetësore. Ai vendos të bisedoi me prindërit e tij. Ideja ishte absurde, jo praktike dhe ajo e tmerroi Paulën, nënën e tij, e cila as nuk donte të dëgjonte për një gjë të tillë. Babai i tij, Thomasi, e ballafaqoi me argumente bindëse për t'ia thyer mendjen. Të rrezikosh shëndetin e tij në moshën 13 vjeçare për t'ia shpëtuar jetën të vëllait është një vendim i guximshëm, por i paarsyeshëm. Nicholasi ishte këmbëngulës. Ai dëshiron ta përmbyll misionin e vetë edhe përkundër vullnetit të prindërve të tij. Gjatë një ekzaminim mjekësor që Davidi iu nënshtua për të vlerësuar mundësinë e transplantimit të organit, Nicholas i tregoi Prof. Parker për qëllimin e tij që t'ia dhurojë veshkën vëllait. Prof. Parker i premtoi se do të mendonte për këtë çështje. Prindërit e Nicholasit nuk pajtoheshin fare.

Ligji ishte i qartë: Në rastin e të miturve, pëlqimin për trajtim mjekësor, eksperimentim dhe intervenim shëndetësor mund të jepet vetëm nga prindërit ose përfaqësuesi ligjor në mungesë të tyre. Ishte në dorë të Paules dhe Thomasit të vendosnin. Kërkesa Nicholasit nuk mund të realizohej. Mirëpo, Nicholasi nuk hoqi dorë. Askush nuk respektoi dëshirën e tij për ta dhuruar veshkën, askush nuk e dëgjoi mendimin e tij. Parimi i autonomisë dhe vetëvendosjes funksionon vetëm për të rriturit. Megjithatë, kjo ishte një zgjedhje që kishte të bënte me shëndetin. Në shkollë, mësimdhënësi kishte folur për “rastet e jashtëzakonshme” për sa i përket dhënies së pëlqimit nga të rinjtë e moshës nën 18 vjeç dhe mbi 12 vjeç e që kanë pjekurinë e duhur psikofizike për intervenime shëndetësore. Libri mbi bio-etikën thotë se parimi i mbrojtjes së jetës duhet të vlerësohet përballë parimit të “lirisë së përgjegjshme”. Mirëpo, cila ishte gjëja më e mirë për të bërë? Pse moshatarët e Nicholasit nuk kanë të drejtë të zgjedhin lidhur me shëndetin e tyre? Nicholasi nuk mund të gjente përgjigje.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

A kanë të drejtë të miturit të përfshihen në vendimet lidhur me trajtimin që ka të bëjë me shëndetin e tyre?

Kur konsiderohen si plotësisht të aftë, të miturit nën moshën 18 vjeç dhe mbi 12 vjeç, për shkak të maturimit të tyre psikofizik, mund t'u lejohet të shprehin mendimin e tyre lidhur me trajtimet shëndetësore jo të detyrueshme siç janë vaksinimi, dhurimi i materialit biologjik, gjykimet, ndërhyrjet apo trajtimet invazive në trupat e tyre?

A aplikohet parimi i autonomisë dhe vetëvendosjes vetëm për të rriturit?

- Mësimdhënësi e paraqet rastin duke e lexuar tregimin që flet për dy vëllezër që janë të mitur.
- Ai e fokuson vëmendjen e nxënësve në dilemat bio-etike: a është e drejtë të përfshihen të

miturit në vendimet që kanë të bëjnë me shëndetin e vetëm njërit prej tyre?

- Ai promovon dhe udhëheq diskutimin lidhur me këtë çështje, duke nxitur propozime dhe zgjidhje lidhur me dilemën e shtruar.

- Nxënësit ftohen nga mësimdhënësi t'i shqyrtojnë rastet e ngjashme ku janë të përfshirë të miturit në vendimet lidhur me shëndetin e tyre, dhe nga ata kërkohet që japin mendimin e tyre lidhur me atë nëse duhet të bëhet një "përgjashtim" në ligj lidhur me aftësinë për të vepruar në fushën e trajtimit mjekësor kur protagonistët e mitur janë plotësisht të vetëdijshëm për vendimet e tyre.

Maria Caporale
maria.caporale@uniroma1.it



Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 8

Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.



NJËSIA 22

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Bota e gjelbër”

“Ne nuk do të pushojmë së hulumtuari, dhe fundi i hulumtimeve tona do të jetë që të arrijmë aty ku kemi filluar dhe ta njohim atë vend për herë të parë”. T.S. Eliot

Objektivat e mësim-nxënies

- Nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme, ne do të përpiqemi që t’i hapim fëmijët ndaj një bote të re, ku ata mund të njoftohen, të respektojnë dhe të familjarizohen me shumë aspekte të “cënueshmërisë”.
- Duke udhëtuar thellë në brendësi të botës së gjelbër, ata do të mësojnë një qasje të re dhe të butë në mënyrë që të jenë të përgatitur t’i njohin dhe të përfshihen në përvoja të reja dhe thellësisht emocionale.

Rasti

Siç ndodhë shpesh, Natyra na frymëzon duke përcjellë një ndjenjë të cënueshmërisë dhe integritetit harmonik. Pemët, lulet, dhe e tërë mbretëria bimore janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e mjedisit tonë, edhe nëse i përkasin një “botë të heshtur”. Edhe pse nuk komunikojnë “me zë të lartë”, këto krijesa të mrekullueshme na mundësojnë që ta jetojmë jetën tonë në Tokë, duke na mundësuar të marrim frymë, të ushqehemi, dhe të jemi të rrethuar nga një bukuri madhështore, të gjitha këto pa kërkuar asgjë nga ne. Ne mund edhe t’i krahasojmë këto krijesa të mrekullueshme me njerëzit e cënueshëm të cilët janë jashtëzakonisht të ndjeshëm në shumë nivele, dhe të cilët nuk janë në gjendje të komunikojnë me ne në mënyrë të kuptueshme. Ato e pasurojnë përvojën tonë emocionale dhe njohuritë tona njerëzore.

Ka shumë mënyra për t’ua prezantuar “botën e gjelbër” fëmijëve. Për shembull, ne mund t’i përdorim mjetet si librat, videot, karikaturat, vinjetat, vizatimet dhe fotografitë, mirëpo, mënyra më e mirë për t’i njoftuar të rinjtë mund të jetë nëpërmjet “zhytjes së plotë”, duke ecur në park, në një kopsht botanik, ose vetëm në oborrin e shkollës. Kontakti i drejtpërdrejtë me natyrën është rast ideal për vënë kontaktin me këtë ndjenjë të re. Për t’i bërë fëmijët kureshtarë dhe për ta ngjallur interesimin e tyre, ne mund t’i përshkruajmë banorët e caktuar të “botës së gjelbër”. Një shembull mbresëlënës do të ishte përshkrimi i pudica mimosa që do të thotë mimoza e turpshme, e quajtur edhe bima e ndjeshme, bima e përgjumur ose bima mos-më-prek.

Gjethet e kësaj bime zvarritëse mbështillen nga brenda dhe varen si pasojë e prekjes apo tronditjes, për ta mbrojtur vetveten nga dëmtimi, dhe të rihapë pas pak minutash. Kjo lule vërtetë paraqet cënueshmërinë e veçantë të krijesave që komunikojnë ndryshe nga ne, e që shpesh janë viktimë të sjelljes sonë imponuese, për shkak të injorancës dhe pandjeshmërisë sonë. Një shembull tjetër interesant është një bimë mishngrënëse: fëmijët janë veçanërisht kureshtar për këtë lloj krijese që duket se është e palëvizshme, por e vënë në funksion një mekanizëm kurthe kur insektet e caktuara e prekin atë.

Për më tepër, ne mund t'i përshkruajmë veçoritë e ndryshme, dhe shpesh të pabesueshme të kaktusit që mund të jetojë në , të një lisi apo pemë ulliri që mund të jetojnë me qindra vite, e kështu me radhë. Ne duhet të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e gjallesave të cënueshme në botën tonë. Ne nuk jemi të gjithë të njëjtë, por duhet të ketë një vend për çdo krijesë. Dhe secila nga ato meriton respekt.


Nga fara në bimë

Mënyra më e mirë për të kuptuar se sa të ndjeshme janë bimët është që t'i kultivojmë ato nga farat e tyre. Nëse nuk kemi kopsht në shkollë, ne mundemi, në fund të fundit, ta përdorim një metodë shumë të thjeshtë duke kultivuar disa fara fasule në pambuk të lagur. Ne kemi nevojë vetëm për pak ujë, rreze të diellit dhe kujdesin tonë dhe dashurinë. Ditë për ditë, ne do të mësojmë se si ta ushqejmë farën që të bëhet bimë, të kuptojmë sa e ndjeshme dhe sa e varur është kjo krijesë e re. Ky nuk është një ushtrim në shkathtësitë e kopshtarisë, por një shembull praktik i një krijese të gjallë dhe një mundësi për të kuptuar se ka qenie të ndryshme të gjalla që meritojnë respekt dhe mbrojtje veçanërisht për shkak se ato nuk komunikojnë si ne. Ne duhet të bëhen të ndjeshëm ndaj të gjitha krijesave të gjalla që i takojnë mjedisit tonë dhe mjediseve tjera.

Metodologjia e mësimdhënies

“Vëzhgimi” i perimeve dhe mbretërisë së kafshëve është një detyrë themelore në programet arsimore në shkolla. Lojërat, përrallat, eksperimentet dhe ekskursionet për ta njohur natyrën, për të mësuarit t'i respektojmë, vlerësojmë dhe mbrojmë atë nuk janë gjëra të reja. Ajo çfarë ne ndryshojmë është qasja, si dhe qëllimi. Cënueshmëria e karakterizon botën e bimëve, luleve, pemëve, dhe farërave. Ne mund ta shohim me sytë tanë një univers të gjallë dhe jashtëzakonisht të ndjeshëm, siç janë disa qenie njerëzore që nuk mund të komunikojnë si të tjerët, por janë të gjallë dhe të pranishëm edhe pse jashtëzakonisht të brishtë dhe delikat. Të mësohemi të përballemi me njëri-tjetrin dhe të bashkëveprojmë me dikë tjetër, i cili shpreh emocionet e veta dhe nevojat përmes kanaleve të ndryshme, do të thotë t'i hapim perspektivat tona, duke pasur parasysh që çdo qenie meriton respektin dhe lirinë e vet për t'u shprehur, pa marrë parasysh “diversitetin” e saj.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com



NJËSIA 23

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Partoshi nuk ka shokë”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet të njihen me nocionin e cënueshmërisë, aspektet e ndryshme të saj, pranimin e saj dhe nevojën për ta respektuar atë. Fëmijët duhet ta kuptojnë se të gjitha qeniet njerëzore e ndajnë cënueshmërinë, se ata duhet të brengosen për të tjerët të jenë të vetëdijshëm për faktin se ata mbështeten në të tjerët. Fëmijët duhet ta kuptojnë se kjo gjendje njerëzore kërkon solidaritet.

Rasti

Në kopshtin tim fëmijëve është një djalosh me emrin Partosh. Unë nuk njoh asnjë fëmijë tjetër që ka emrin Partosh. Fëmijët e quanin Partoshi Hippo që do të thotë: Partoshi i trashë. Jo vetëm që emrin e ka të ndryshëm dhe të çuditshëm, por edhe vetë Partoshi është ndryshe. Ai ka një karrige të veçantë, të madhe dhe të rëndë, sepse karriget e zakonshme dhe të vogla nuk e zinin, dhe ai tashmë i kishte thyer disa karrige duke u ulur në to. Kur të gjithë ishin duke vrapuar apo duke u ngjitur në pemë apo duke luajtur me top, ai rrinte anash ulur dhe i vetmuar. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte brenda në klasë, duke pikturuar. Partoshit i pëlqente piktura më shumë se çdo gjë tjetër. Pikturat e tij ishin të mrekullueshme. Ai pikturonte lule, kafshë dhe fëmijë duke luajtur. Doni dhe Shoni, dy fëmijë në klasën tonë e ngacmonin atë duke e quajtur Hippo ose Derrkuc, dhe e detyronin të bënte gjëra që ai nuk mund t'i bënte: të vraponte, të ngjitej në shkallë, apo të hidhej në trampolinë. Partoshi nuk mund t'i bënte asnjë nga këto gjëra, ai vetëm shikonte në dyshe dhe sytë i mbusheshin me lotë. Një ditë Partoshi nuk erdhi në klasë, dhe as të nesërmen, dhe as ditëve tjera.

Lidia, mësimdhënësjja jonë, i thirri prindërit e tij për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur me Partoshin. Nëna e tij tha se ai kishte qëndruar në shtrat, i pikëlluar, dhe mezi fliste. Mjeku e kishte kontrolluar dhe nuk kishte hasur në asnjë sëmundje. Ai mendonte se Partoshi nuk donte të shkonte në klasë të tij, sepse ndjehej shumë keq atje. Disa fëmijë e fyenin sa herë që e takonin. Lidia u tregoi fëmijëve arsyen pse Partoshi nuk vinte në shkollë. Gabrieli propozoi që ta vizitojnë Partoshin dhe ta përgatisin një album me fotografi për të me pikturat e fëmijëve dhe t'i varin të gjitha pikturat e Partoshit në mure e që mbaheshin në klasë. Të nesërmen, mësimdhënësjja dhe fëmijët u mbledhën në shtëpinë e Partoshit. Ata hynë në shtëpi duke e mbajtur një pllakat ku ishte shkruar “Partosh, ne të duam, kthehu në klasën tonë”, dhe i dhanë albumin bukur. Partoshi nuk mund t'u besonte syve të tij. Asnjë nga këta fëmijë nuk kishte

ardhur më parë në shtëpinë e tij. Ai shpejt u hodh nga shtrati, veshi disa rroba dhe iu bashkua fëmijëve tjerë. “Nënë”, tha ai shumë i emocionuar, “ata më kërkojnë, ata më duan”. Ai u kthye me fëmijët përsëri në klasë. Kur i pa pikturat e tij të varura në mur, sytë e tij u mbushën me lot.


“Pse po qanë?” e pyeti Lidia, “sepse jam shumë i lumtur” u përgjigj ai. Nganjëherë ne qajmë sepse jemi të lumtur.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë diskutimin duke paraqitur pyetje si në vijim:

- A njihni ndonjë fëmijë tjetër me emër të çuditshëm?
- Kush ua vë emrat foshnjave të sapolindura?
- A është e mundshme që ne ta ndërrojmë emrin tonë?
- Pse refuzonte Partoshi të shkonte në çerdhe të fëmijëve?
- Si do të sillen fëmijët ndaj Partosit tani e tutje? Pse?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 24

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Në vendin Woodland”

Objektivat e mësim-nxënies

- Krijoni mundësi për mësim-nxënie që synojnë vetëdijesimin mbi ngjarjet në jetën e përditshme.
 - Mësohuni të bëni pyetje lidhur me kuptimin e botës dhe ekzistencës së njeriut.
 - Reflektoni lidhur me kuptimin dhe vlerat morale të veprimeve tona.
 - Mësohuni t’i dëgjoni pyetjet e fëmijëve.
 - Nxënësit duhet ta fitojnë një qëndrim të dëgjuarit konstruktiv, dhe të jenë në gjendje ta disponojnë njëri-tjetrin, dhe t’i kuptojnë dhe shpjegojnë pozicionet e ndryshme.
- Fëmija luan me të tjerët në një mënyrë konstruktive dhe kreative, duke qenë në gjendje të argumentojë, diskutojë dhe të mbështes gjykimet e tij me të rriturit dhe fëmijët.

Rasti

Na ishte njëherë një vend i quajtur Woodlandia. Të gjitha lodrat ishin të punuara nga druri, me përjashtim të njëres që ishte një njeri i vogël i qelqit. Për fat të keq, lodrat e drurit nuk donin të luanin me të sepse ai ishte shumë i brishtë, shumë më e brishtë se druri: ai thyhej lehtë, dhe ishte lënduar disa herë!

Një ditë njeriu i qelqtë vendosi të largohet nga vendi i Woodlandisë, dhe gjatë udhëtimit të tij për kush e di se ku, ai takoi shumë lodra tjera: Petrin, ushtarin nga kallaji, Fiorelën, valltaren e baletit nga porcelani, Bobin, qenin ledhatues. Papritur, lodrat e reja menjëherë e mirëpritën njeriun e qelqtë. Ai nuk kishte nevojë ta fshehte brishtësinë e tij, dobësitë e tij, dhe diversitetin e tij; përkundrazi, shokët e tij të rinj e pranuan atë menjëherë, dhe njeriu i qelqtë u mësua ta pranojë brishtësinë e vetë.

Njeriu i vogël nga qelqi kohën më të madhe e kalonte me shokët e tij të rinj. Ata luanin së bashku, bënë shëtitje të gjata, dhe tregonin përralla. Një ditë, megjithatë, njeri i vogël nga qelqi u trishtua paksa: atë e kishte marrë malli për vendin e Woodlandisë dhe kërkoi nga “shokët e tij të vërtetë” që ta shoqëronin.

Bashkërisht, ata arritën në vend dhe lodrat e drurit të habitura i shikonin shokët e rinj të njeriut të qelqtë, të gjithë dallonin nga njëri tjetri, por prapëseprapë të lumtur që ishin së bashku. Që nga ai moment, lodrat e drurit, të lumtura që u ribashkuan me shokun e tyre të vjetër, e ftuan të rrinte me ta dhe mësuan se si të jenë me të

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

...Pse jetonte njeriu i qelqtë në vendin e Woodlandisë, pasi që nuk ishte i punuar nga druri?

...Mendoj se njeriu i qelqtë duhet të qëndrojë me vëllezërit e tij të qelqtë, përndryshe objektet prej qelqi mund t'u shkaktojnë dëme lodrave tjera.

...Po ju, çfarë do të kishit bërë po të ishit në vendin ushtarit nga kallaji/të balerinës nga porcelani/të qenit?

...Unë do të kisha luajtur me të dhe do të kujdesesh shumë që të mos e thyej atë.

...A mendoni se lodrat nga druri vepruan drejtë kur e pranuan njeriun e qelqtë në komunitetin e tyre?

...Po ju, çfarë do të kishit bërë?

Mjedisi:

Klasa apo kabinet leximi, koha e caktuar, nxënësit të ulur në qilimin fluturues të imagjinuar, klasa apo kabineti i pikturës ku fëmijët përdorin ngjyrat që t'i ndajnë hapësirat dhe gjërat personale.

Mësimdhënësi fillon me një brainstorming. Duke përfituar nga informatat që janë marrë nga fëmijët e huaj për sa i përket kulturave në vendet e tyre të origjinës, mësimdhënësi ua bënë një varg pyetjesh nxënësve për të folur dhe shpjeguar dallimet ndërmjet njerëzve dhe kulturave të ndryshme.

Pastaj janë aktivitete që kanë për qëllim "dizajnimin e një intervenimi për të zhvilluar aftësinë e fëmijës (pavarësisht nga fakti se a është ai/ajo e afet apo me aftësi të kufizuara) për t'i përdorur ngjyrat si simbol të identifikimit të hapësirave dhe të gjësëndeve personale, duke zgjedhur grup moshën. "Fëmijët i shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre në mënyrë imagjinative dhe kreative: arti e nxit këtë prirje, duke mësuar kënaqësinë e bukurisë dhe të ndjenjën estetike. Hulumtimi i materialeve që janë në dispozicion u mundëson atyre që t'i fitojnë përvojat e tyre të para artistike, të cilat stimulojnë kreativitetin e tyre dhe ndikojnë në proceset tjera mësimore.

Giuseppina Iommelli

giuseppina.iommelli@alice.it



NJËSIA 25

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Fëmija i ndarë në dysh”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të ndjehen të lirë për t’i mbrojtur mendimet e tyre.
- Të krijohen situata motivuese për të ngjallë konflikte, mosmarrëveshje që do të çojnë në pyetje dhe reflektim lidhur me situatat e ndryshme dhe besimet.
- Të mësoheni me “vetëdijesimin kritik”: aftësinë për t’i shpjeguar vetvetes dhe të tjerëve arsyet e bindjeve dhe zgjidhjeve të tyre.
- Të dinë se si t’i gjejnë argumentet e fuqishme në mbrojtje të pozicioneve të tyre (prirjen për dialog dhe konfrontim).

Rasti

Andrew, një fëmijë 10 vjeçar, jeton me nënën e saj të vetme. Më vonë partneri i ri i nënës së tij vendoset në shtëpinë e tyre.

Andrew ndihet në siklet sepse ai nuk e pranon një burrë tjetër në shtëpinë e tij. Andrew është shumë e pikëlluar dhe fillon të largohet nga shokët e tij.

Një ditë, mësimdhënësi e ngriti në klasë çështjen e prindërve të ndarë. Më në fund, Andrew, i nxitur nga fjalët e mësimdhënësit të tij, i shfaq emocionet e tij dhe flet për përvojën e tij duke thënë se ndoshta ai vetë ishte përgjegjës për ndarjen e prindërve të tij.

Gjatë pushimit, njëri prej shokëve të tij, një djalosh i madh dhe i gjatë i quajtur Mark, e ngacmon atë, tallet me te duke e akuzuar se vetëm ai ishte fajtor për gjendjen në familjen e tij. tregon atij se situatën e familjes së tij krejtësisht fajin e tij.

Andrew nuk dinte si të përgjigjej, ai frikësohet, fshihet, zmbropset nga provokimet, duke kërkuar qetësi dhe mbrojtje në shoqërinë e shokëve tjerë, por më kot. Pas mësimi, Andrew fshehurazi e përcjellë Markun dhe zbulon se familja e këtij fëmije të madh dhe të dhunshëm është në të njëjtën situatë si familja e tij. Marku vazhdon për ditë me radhë ta ngacmojë Andrew-n i cili më në fund gjen guximin e duhur për t’u përballur me të. Pas një diskutimi të gjatë, të dy bëhen miq, dhe ishin në gjendje t’i ndihmonin njëri-tjetrit meqenëse kishin një situatë të ngjashme familjare. Mark zbuloi anën e tij të ndjeshme, dhe nuk fshihej më pas maskës së zemërimit dhe dhunës.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

- Pse e ngacmon Marku Andrewin?
- Pse nuk reagoi Andrew menjëherë?
- Si ndjehen fëmijët kur prindërit u ndahen?
- Si do të veproja unë në vend të Andrewt?
- Unë do të ndjehesha i vetmuar dhe i pikëlluar sepse do të ndjehesha ndryshe nga të tjerët...
- Si do të veproja unë në vend të Markut?
- Si do të ndjeheshit sikur të jetonit me dy familje?
- Si mendon se do të përfundojë ky tregim?
- A do të vazhdojë Marku t'i ngacmojë fëmijët?

Gjatë orës së mësim, puna duhet të jetë bashkëpunuese (të mësuarit bashkëpunues, punë në grupe, tutorimi) për t'i përfshirë mësimdhënësit, nxënësit dhe edukatorët, dhe për të fuqizuar komunikimin dhe vetë-respektin. Qëllimi i mësim-nxënies është që të zgjidhen problemet, duke i përgatitur nxënësit për kompleksitetin e botës reale. Diskutimi, ballafaqimi dhe debati i subjekteve të ndryshme e nxisin shkëmbimin e ideve dhe respektin për të tjerët. Objektivat e përbashkëta për metodologjitë e mësim-përme janë të domosdoshme për t'i kuptuar mekanizmat që sjellin stereotipet, paragjykimet dhe racizmin, zhvillimin e aftësive të nxënësve për ta vënë veten në vend të dikujt tjetër, dhe për t'i shikuar situatat nga këndvështrime të ndryshme duke i vënë në pyetje kategoritë e tyre mendore, dhe rritjen e aftësive të tyre ndërkulturore, në mënyrë që t'i përmirësojnë marrëdhëniet e tyre me diversitetin.

Programi për simulimin e dëmtimeve në të parë, atyre motorike dhe psikologjike (lojë e statujave të bukura, qesja me të papritura, loja e aromave, etj.) u mundëson fëmijëve ta kuptojnë se sa vështirë është të perceptohet mjedisi nga një person me aftësi të kufizuara. Eksperimentimi me modalitetet perceptuese dhe emocionale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mund t'i ndihmojë fëmijët për të krijuar një marrëdhënie më empatike me moshatarët e tyre, duke i ngushtuar kufijtë dhe frikën që e krijon kjo situatë, pra duke promovuar integrimin dhe socializimin. Në fund të lojërave grupore statike dhe dinamike të propozuara, do vijë momenti kur fëmijët do t'i shprehin me fjalë përvojat e tyre duke i përpunuar përmbajtjet që trajtohen.

Giuseppina Iommelli
giuseppina.iommelli@alice.it



NJËSIA 26

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Në kërkim të dritës...”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të ndjehen të lirë t’i mbrojnë pozicionet e veta.
- Të trajtohen situata të mundshme me qëllim që të ngjallin konflikt, dhe mosmarrëveshje që do të çonin në pyetje dhe reflektim lidhur me situata të ndryshme dhe besime.
- Të mësohen me “vetëdijesimin kritik”: aftësinë për t’i shpjeguar vetvetes dhe të tjerëve arsyet e bindjeve dhe zgjidhjeve të tyre.
- Të dinë se si t’i gjejnë argumentet e fuqishme në mbrojtje të pozicioneve të tyre (prirjen për dialog dhe konfrontim).

Rasti

Një yll i quajtur Splendour ishte ylli më i bukur e në kupën e qiellit. Drita e tij shkëlqente dhe i bënte yjet tjera që luanin në qiellin e pafund të lumtur. Ata madje krijuan edhe Ariun e Madh, kometë madhështore një kohë... Ai ishte gëzimi i nënës dhe babait, të cilët nga dashuria për të, e ndezën atë me një dritë të gjatë dhe intensive që e bënte atë më të bukur për çdo ditë. Një ditë, për fat të keq, babai i tij u sëmur dhe drita e tij filloi të zbehej për çdo ditë e më shumë deri sa u shua....

Splendour u dëshpërua dhe atij i mungonte drita e sigurt dhe e dashur dhe shpesh rrëfehej tek nëna për melankolinë e tij. Ai nuk ndjente më dëshirë të luajë lojëra me yjet tjera ...

Mirëpo, një ditë, kur Splendour ndjehej si i përgjumur, një dritë e çuditshme e pushtoi duke një nxehtësi çuditërisht të fortë; dhe kjo nxehtësi ngadalë e zgjoi atë nga dremitja...

Ishte një ndjenjë e mrekullueshme të cilën po e përjetonte Splendour. Ai e kishte ndjenjën se babai i tij ishte kthyer për ta mbuluar me dritë dhe dashuri. Në fakt, nuk ishte babai i tij, por një yll tjetër i mrekullueshëm i cili, duke parë Splendourin të trishtuar dhe melankolik për shkak të zhdukjes së babait të tij, ofroi ndihmën e vetë.

Kështu që, ky yll vendosi ta adoptojë Splendourin, duke ia dhënë dashurinë e tij në mënyrë që ai të mund të rritej më i fortë dhe më i ndritshëm. Pasi që “babai i ri” e rrethoi atë me dritë,

një ditë ai e përqafoi atë, dhe njëherë tjetër e mori me veti për të luajtur me mijëra yje.... deri sa një ditë ai e pa Splendourin të rilindur me të gjithë bukurinë e tij. Ditë për ditë, gëzimi i Splendourit rritej dhe ai bëhej më i bukur dhe linte buzëqeshje që bënë dritë si diamantet në fytyrat e të gjithë yjeve me të cilët shoqërohej.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema


- Pse është Splendour i pikëlluar?
- Pse nuk e ka më babain?
- Të gjithë fëmijët kanë baba dhe nënë.
- Mirëpo, tani, ai është i lumtur sepse e ka gjete një baba të ri...
- Unë nuk do të doja të kem një baba të ri
- Si do të silleshe ti po të ishte në vendin e Splendour?

Metoda e mësimdhënies që është përdorur duhet ta përmirësojë bashkëpunimin (të mësuarit bashkëpunues, punë në grupe, tutorimi). Mësimdhënësit, nxënësit dhe edukatorët, të gjithë janë të përfshirë për të fuqizuar komunikimin dhe vetë-respektin. Mësim-nxënia kërkon zgjidhjen e problemeve, duke i përgatitur nxënësit që të ndeshen me kompleksitetin e botës reale. Diskutimi, ballafaqimi dhe debati i temave të ndryshme i mëson nxënësit të shkëmbejnë ide dhe ta respektojnë njëri tjetrin. Objektivat e përbashkëta për këto metoda të mësimdhënies janë që të kuptohen mekanizmat që përcaktojnë stereotipet, paragjykimet dhe racizmin, zhvillimin e empatisë dhe të aftësisë për t'i shikuar situatat nga këndvështrime të ndryshme duke u mundësuar nxënësve ta vejnë në pyetje gjendjen e tyre mendore për t'i zhvilluar shkathtësitë e tyre ndërkulturore dhe për ta përmirësuar perceptimin e tyre të diversitetit.

Programi i simulimit (loja e statujave të bukura, qesja me të papritura, loja e aromave, etj.) lidhur me dëmtimet në të parë, atyre motorike dhe psikologjike u mundëson fëmijëve ta kuptojnë se si partneri kur është në vështirësi të dukshme e percepton mjedisin që na rrethon. Kjo mund t'i ndihmojë fëmijët të krijojnë një marrëdhënie më empatike me moshatarët e tyre, duke i ngushtuar kufijtë dhe frikën që e krijon kjo situatë, pra duke promovuar komunikimin dhe socializimin. Lojërat grupore statike dhe dinamike do të luhen, dhe në fund, do të vijë momenti kur fëmijët do të flasin për përvojat e tyre, dhe do të përpiqen t'i përpunojnë të gjitha informatat që trajtohen.

Giuseppina Iommelli

giuseppina.iommelli@alice.it



NJËSIA 27

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Një vendim i dhembshëm”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të dinë përmbajtjen e Nenit 8 të Deklaratës Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut.
- Të dinë kuptimin e cënueshmërisë dhe integritetit individual.
- Të bëhen të vetëdijshëm që, për individët apo grupet që janë veçanërisht të rrezikuara, është e nevojshme që të miratohen masa të përshtatshme në mënyrë që të mbrohen të drejtat e tyre, interesat dhe integriteti i tyre.

Rasti

Për ditëlindjen e tij të katërmbëdhjetë, Karlo kërkon leje nga prindërit e tij që të organizojë një aheng me shokët e shkollës e tij në fermën e tyre që ndodhet rreth 100 kilometra larg qytetit.

Nga 20 shokët e tij të klasës, 17 menjëherë e pranuan ftesën e tij, 2 (Andrea dhe Giuseppe) thanë se ishin të zënë me një aheng tjetër, ndërsa 1 shok i klasës nuk u përgjigj fare. (Ai ishte Federiko, një djalosh me retardim serioz mendor). Babai i Karlos e siguroi një mini-bus me 21 vende me qira, duke përfshirë edhe shoferin për t'i dërguar fëmijët në fermë.

Dy ditë para kësaj ngjarje, Andrea dhe Giuseppe e njoftuan Karlon se ata do të vinin, meqenëse ahengu ku ata duhej të shkonin ishte anuluar. Në fillim, kjo nuk dukej se do të paraqiste ndonjë problem, pasi që ishin dy vende të lira në autobus.

Por, kur babai i Karlos pyeti pse Federico nuk po vinte, i biri i tij nuk mundi t'i jep një përgjigje dhe thotë se shoku i tij i klasës thjesht nuk ishte përgjigjur. Megjithatë, Karlo, menjëherë e kuptoi se nuk e kishte marrë në konsideratë të duhur dëmtimin e Federicos, cënueshmërinë e tij dhe brishtësinë që e kishte penguar atë ta shpreh në mënyrë të qartë, brenda kohës së paraparë, dëshirën e tij për të marrë pjesë në këtë ngjarje. Në fakt, prindërit e djaloshtit kishin konfirmuar se djali i tyre do të donte të shkonte në aheng dhe ata do të ishin më se të lumtur sikur ai të shkonte.

Ata vetëm kerkuan që ndihmësi i tij të shkojë me të. Tani dy vende në autobus mungojnë dhe Karlo vendosi, për fat të keq, t'i përjashtojë Andrean dhe Giuseppen dhe ta favorizojë pjesëmarrjen e Federicos. Ky vendim ishte i papranueshëm për të gjithë shokët e klasës, edhe pse të gjithë ata kishin motive të ndryshme:

- Disa thoshin se Karlo kishte gabuar që i kishte përjashtuar Andrean dhe Giuseppen pasi që

njëherë u kishte thënë se ulëset e tyre ishin të lira. Nuk është e drejtë që t'i mbash me shpresë, dhe në fund të fundit, edhe pse me vonesë, ata e kishin konfirmuar praninë e tyre para edericos.

- Të tjerë thoshin se Karlo kishte gabuar, sepse Federico kishte nevojë për një asistent, dhe për ta pranuar atë në aheng është dashur të përjashtohen dy veta, për të mos përmendur se prania e një të rrituri në atë aheng nuk vlerësohej shumë. Karlo, nga ana tjetër, e refuzonte mos aprovimin e shokëve të tij duke e arsyetuar vendimin e tij se Federico, duke pasur parasysh gjendjen e tij të veçantë, e kishte shumë të vështirë të jepte një përgjigje të qartë brenda afatit të kërkuar, ndërsa Andrea dhe Giuseppe kishte vendosur me dëshirë, në fillim, të mos vinin në aheng sepse ishin të zënë.

Kush mendoni se ka të drejtë?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi e paraqet rastin në klasë dhe e pyet nëse ata e ndajnë mendimin e Karlos ose pikëpamjen e shokëve të tij të klasës, duke i shkruar përgjigjet në tabelë. Mësimdhënësi pastaj i fton djemtë që t'i kenë parasysh deklaratat e mëposhtme, para se t'i japin përgjigjet e tyre:

- 1) Kush i pari vjen, i pari shërbehet. Kjo është gjithmonë e drejtë.
- 2) Është e drejtë të sakrifikohen të drejtat e një personi, nëse kjo mundëson mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.
- 3) Në jetën e të gjithë duhet ta kenë një pikënisje të njëjtë, edhe nëse kushtet e tyre individuale janë të ndryshme.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep këshilla por thjeshtë i shënon përgjigjet dhe e krijon një hartë të mendimit të klasës lidhur me problemin e paraqitur.

Pastaj mësimdhënësi e sqaron kuptimin e “cënueshmërisë së njeriut” dhe “integritetit personal”, koncepte këto që paraqiten në Nenin 8 të Deklaratës Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut, ku thuhet:

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Mësimdhënësi thekson se rasti i paraqitur nuk merret në mënyrë specifike me cënueshmërinë e një personi dhe nevojën për mbrojtje për sa i përket progresit të njohurive shkencore, megjithatë Federico, duke pasur parasysh gjendja e tij personale, është padyshim më i cënueshëm se shokët e tij, dhe e ka të vështirë t'i zgjidhë problemet e tij të përditshme dhe, për këtë arsye, ka nevojë për ndihmë dhe mbrojtje.

Në dritën e njohurive të reja, mësimdhënësi e pyet klasën të mendojnë për zgjidhjet që i kishin dhënë më herët, dhe t'i ndryshojnë ato, nëse e shohin të nevojshme. Në këtë fazë, mësimdhënësi udhëheq me diskutimin.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 28

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 8: Respekti për cënueshmërinë e njeriut dhe integritetin personal

Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cënueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cënueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.

Titulli

“Qepe për të qenë e pastër”

Objektivat e mësim-nxënies

- Rëndësia e gjendjes fizike dhe psikologjike të një qenie njerëzore.
- Respektimi i traditave në përputhje me respektimin e personit.
- Rëndësia e konfrontimit me njëri tjetrin për të marrë vendime përfundimtare.
- Rëndësia e vetëdijesimit për rreziqet dhe përfitimet në bërjen e zgjidhjeve.

Rasti

Hasha është një vajzë 10 vjeçare e cila jeton në një fshat ku shumica e moshatareve të saj i nënshtrohen FGM (gjymtimit gjenital të femrës). Shoqet e saj shpesh e pyesin ta shfaqë pastërtinë e saj dhe Hasha nuk e di çfarë të thotë. Ajo fillon të kuptojë se simbol i pastërtisë, për një grua, është qepja që duhet të kryhet në organet gjenitale të femrës nga gratë tjera të fshatit. Hasha beson se kjo është një ngjarje e dhimbshme, por vajzat tjera ia shpjegojnë se pas kësaj, do të organizohet një gosti e madhe, ku të afërmit dhe fqinjët do të sjellin shumë dhurata. Mirëpo, mbi të gjitha, që nga ky moment, ajo do të jetë në gjendje ta gjejë burrin dhe të pranohet në grupin shoqëror. E ngazëllyer nga ideja e gostisë së madhe, Hasha pyet nënën lidhur me infibulacionin e saj, por nëna nuk pranon, duke i ditur pasojat e dhimbshme që do t'i shkaktonte kjo ndërhyrje në trupin dhe shpirtin e vajzës së saj. Hasha e pyet babanë e saj, i cili, i gatshëm të respektojë traditën e fshatit të vetë, me dëshirë pranon. Ky vendim hap një debat mes prindërve të Hashas, të cilin e fiton babai. Nëna thotë se ndërhyrja do të shkaktonte pasojat e dhimbshme, të rënda dhe të rrezikshme për shëndetin e Hashas, por babai i saj e konsideron ndërhyrjen si të nevojshme për shkaqe shoqërore.

Në kohën e operacionit, Hasha zbuloi se dhimbja është më e fortë se çdo dëshirë për të festuar. Pas 7 ditësh në shtrat, me këmbët e saj lidhur për ta tharë plagën, Hasha u ngrit nga shtrati dhe shkoi tek shoqet e saj. Pastaj ajo ua tregon “pastërtinë” e saj, dhe kupton se ajo nuk është më e lirë për të vrapuar dhe luajtur nga rreziku i grisjes së plagës. Pas disa viteve, Hashen e martojnë, dhe, gjatë natës së dasmës, burri i saj ia hap plagën duke përdorur një thikë. Hasha vuan përsëri një dhimbje shumë më të madhe se sa kur duhej të urinonte apo gjatë ditëve të ciklit të saj menstrual. Lindja e fëmijës u bë një torturë e vërtetë për të, si dhe qepja e serishme. Në atë moment ajo e pyeti veten nëse për t'u bërë e pastër me çdo kusht ia ka vlejtur, ose, ndoshta do të kishte qenë më mirë sikur t'i kishte dëgjuar këshillat e nënës, e cila veç kishte

kaluar nëpër një operacion të tillë dhe e dinte se çfarë ishte mirë për vajzën e saj.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

- Si mund të pajtohen praktikat tradicionale tipike e një kulture me respektin që treguar për sigurinë e individit?
- Si mund ta mbron Hashen, si individ potencialisht e rrezikuar, duke respektuar në të njëjtën kohë edhe normat shoqërore e grupit?
- Si mund të zgjidhet debati ndërmjet prindërve të saj?

Në fillim, mësimdhënësi do të jep shpjegime lidhur me gjymtimin gjenital të femrave (FGM) në botë në mënyrë që nxënësit ta kuptojnë këtë praktikë.

Pastaj, mësimdhënësi do t'ua shpërndajë nxënësve disa dëshmi të grave që e kanë përjetuar këtë ndërhyrje. Dëshmitë do të jenë të ndryshme, që tregojnë se shqyrtimi i kësaj praktike mund të jetë e lidhur me kontekstin social. Mësimdhënësi do ta stimulojë diskutimin, duke i bërë disa pyetje.

Fëmijët mund t'i komunikojnë përgjigjet tyre duke filluar me frazën: pajtohem, nuk pajtohem, apo nuk jam i sigurt ... Kjo i mundëson mësimdhënësit që t'i kuptojë qëndrimet e nxënësve më lehtë në lidhje me dilemën e shtruar.

Në fund të diskutimit, nxënësit, të ndarë në grupe sipas përgjigjeve që janë dhënë më parë, duhet ta kërkojnë një zgjidhje të përbashkët.

Në këtë pikë, mësimdhënësi e ofron shpjegimin e plotë të Nenit 8, që thotë: “Gjatë zbatimit dhe avancimit të njohurive shkencore, praktika mjekësore dhe teknologjitë që e shoqërojnë, duhet të merret parasysh cenueshmëria e njeriut. Individë dhe grupet me cenueshmëri të veçantë duhet të mbrohen dhe integriteti personal të individëve të tillë duhet të respektohet.”

Antonella Zapparrata
antonella230383z@yahoo.it



NJËSIA 29 I

Grup mosha IV: 15 - 19 vjeç

Parimi etik nr. 8: Respekti për cenueshmërinë njerëzore dhe integritetin personal

Në zbatimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktikën mjekësore dhe teknologjitë që lidhën me të, duhet të merret parasysh cenueshmëria njerëzore. Individët dhe grupet lehtë të lëndueshëm duhet të mbrohen dhe të respektohet integriteti personal i tyre.

Titulli

“Gjithëpërfshirja, si aspekt themelor i të jetuarit së bashku I”

Objektivat mësimore

Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

1. Zhvilloj dhembshurinë
2. Mësoj si të pranon perspektivat dhe pikëpamjet e ndryshme (vet decentralizimi)
3. Të zhvilloj respektin për të tjerët dhe dallimin
4. Të jetë në dijeni për vështirësitë dhe pengesat që i hasin njerëzit me aftësi të kufizuara
5. Të ketë njohuri për vështirësitë të cilat mund të vinë nga aspektet e brendshme (pengesa mendore)
6. Kuptoj si mjedisi ndikon në kualitetin e jetës të njerëzve me dhe pa aftësi të kufizuara
7. Mësoj si ta vlerësoj larminë si pasuri
8. Të mësoj si të kuptoj aftësinë e kufizuar
9. Të mësoj si të merr një qëndrim gjithëpërfshirës në kuptimin më të gjerë si parim themelor i jetës së përbashkët.

Rasti

Pjesa e parë

Françeska është një nxënëse 17 vjeçare e shkollës së mesme e cila ka nga një prapambetje të rëndë mendore dhe aftësi të kufizuara shqisore dhe motorike. Mosha e saj kognitive është e njëjtë me atë të një vajze 4 vjeçare. Ajo është në gjendje të shprehë veten në mënyrë të kuptueshme, por nuk është në gjendje të kuptoj disa koncepte. Françeska është edhe tetraplegjike dhe ka vështirësi në koordinimin e krahëve dhe këmbëve të saj. Për këtë arsye, ajo është e detyruar të përdorë karrocë. Ajo gjithashtu ka pengesa të mëdha në të parë. Ajo ka shikim të kryqëzuar dhe fusha e saj vizuale është e ndryshueshme. Shpesh ajo nuk është në gjendje t'i njohë njerëzit, pasi ajo nuk është plotësisht e vetëdijshme për mjedisin rreth saj. Në shtëpi, Françeska është e gëzuar dhe e qeshur dhe i pëlqejnë shakatë. Ndërsa në shkollë, ajo fatkeqësisht nuk është në gjendje të bashkëveprojë me shokët dhe shoqet e shkollës së saj, nuk kërkon të shoqërohet me ta dhe gjithmonë i ngulë sytë në dysheme. Është shumë e vështirë për Françeskën të bashkëveprojë me shokët dhe shoqet e saj të shkollës për shkak të interesimeve të ndryshme dhe mënyrave të ndryshme të komunikimit. Përpjekjet e saj të rralla dhe të çuditshme nuk japin rezultate. Kështu që, Françeska në shkollë është plotësisht e izoluar;

ajo nuk i di as emrat e shokëve dhe shoqeve të saj të shkollës. Ajo shpenzon pothuajse të gjithë kohën e saj vetëm në një dhomë me një staf të specializuar që është atje për ta ndihmuar atë. Shoqet dhe shokët e saj të shkollës nuk dinë se si të lidhen dhe të ndërveprojnë me të. Shumë shpesh, ata nuk e kuptojnë atë që ajo thotë, sepse ajo flet me zë të ulët pa i shikuar ata. Ata preferojnë të qëndrojnë larg prej saj, në mënyrë që të shmangin situatat e turpshme.

Metodologjia e mësimdhënies

Hyrje

Neni i njëmbëdhjetë i deklaratës universale për bioetikë dhe të drejtat e njeriut thekson se: “Asnjë individ ose grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në shkellje të dinjitetit njerëzor, të drejtave njerëzore dhe lirive themelore.”

Ne kemi zhvilluar një rrugë didaktike të fokusuar në temën e aftësisë së kufizuar për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë një vetëdije më të madhe të parimit të cekur më sipër. Në shoqërinë tonë, njerëzit me aftësi të kufizuara përjetojnë shumë shpesh izolim dhe diskriminim. Nga ana tjetër, parimi i gjithëpërfshirjes është në zhvillim e sipër. Sipas këtij parimi, çdo person, pavarësisht nga kapacitetet e tij ose të saj, gjinisë, etnisë, kulturës dhe gjendjes sociale, duhet të bëhet pjesë integrale e strukturës shoqërore.

“Nëse do të ketë një shoqëri të njerëzve në botë, ajo mund të jetë (dhe duhet të jetë) vetëm një bashkësi e lidhur me interesa të përbashkëta dhe të ndërsjella; një komunitet përgjegjës për të siguruar të drejtën e barabartë për tu konsideruar qenie njerëzore dhe aftësinë e barabartë për të vepruar në përputhje me atë të drejtë “. Komuniteti i Z. Bauman. Kërkimi i sigurisë në një botë të pasigurt, 2001. Rastet studimore të përzgjedhura janë të bazuara në projekte reale për gjithëpërfshirjen e dy nxënësve me aftësi të kufizuara dhe ato merren me vështirësitë reale me të cilat ballafaqohen në proceset integruese dhe rezultate të arritura konkrete. Fokusi do të jetë në shkathtësitë dhe kompetencat e fituara nga nxënësit.

Andaj, duke filluar nga analiza e dy personave që kanë aftësi të kufizuara dhe përmes një sërë aktiviteteve pjesëmarrëse, nxënësit do të kenë mundësi që të jenë në kontakt me të tjerët. Ata do të kuptojnë sa e vështirë është që të jetosh në kushte të pafavorshme dhe do të bëhen më të vetëdijshëm për vlerën pozitive të gjithëpërfshirjes.

Diskutimi në grup në pjesën e parë të rastit studimor

Mësimdhënësi ju paraqet rastin e parë klasës. Pastaj i ndan nxënësit në grupe nga 4-5 dhe ju jep një fletë ku paraqitet rasti dhe pyetjet. Ai emëron në secilin grup nga një koordinator i cili do ta udhëheqë diskutimin dhe një sekretar i cili do të marrë shënime për reflektimet dhe propozimet. Gjatë kësaj faze të këshillimit mësimdhënësi do të stimulojë diskutimin në secilin grup pa dhënë ndonjë udhëzim specifik.

Të mundohemi të mendojmë sa e vështirë është për një vajzë të vogël që përballet me vështirësitë sikurse Françeska kur ndërvepron me bashkëmoshatarët e vet.

- Nëse do të ishit shokë dhe shoqe të saj, çka do të bënit për t'i ndihmuar asaj?
- Çfarë lloj projektesh do mund të organizoheshin nga mësimdhënësit e saj për të ndihmuar përfshirjen e saj në klasë?
- Sa e rëndësishme mund të jetë për mirëqenien e përgjithshme të Françeskës arritja e miqësive me bashkëmoshatarët e vet?

Secili grup do të luaj një dramë për të shkëmbyer reflektimet e dala me të tjerët. Në fund të secilës paraqitje artistike nxënësit do të shprehin mendimet dhe idetë e tyre për sugjerimet e ndryshme.

Pjesa e dytë

Përmes periudhës së trajnimit ku përfshiheshin aktivitete specifike që kanë pasur si qëllim promovimin e gjithëpërfshirjes, sikurse intervistat me shokët dhe shoqet e klasës për të marrë interesimet e tyre personale, nxënësja u aftësua të del nga izolimi i vet, t'i njeh shokët dhe shoqet e veta të klasës dhe me kalimin e viteve t'ju bashkohet atyre dhe të kërkoj shoqërinë e tyre. Për shokët dhe shoqet e saja vrojtimi i transformimit të vajzës ka qenë një përvojë e rëndësishme.

Përveç kësaj, për të promovuar integrimin e saj, shokët dhe shoqet e klasës së saj ofruan të planifikojnë, organizojnë dhe zbatojnë një vizitë edukative, duke marrë parasysh nevojat specifike të nxënësve me aftësi të kufizuara. Në këtë projekt, nxënësit janë vetëdijësuar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me transportin me karroca dhe për vështirësitë e përditshme me të cilat ajo përballet. Këto përvoja i kanë mësuar shokët të cilët janë bërë më të vetëdijshëm për mënyrën se si mjedisi dhe qëndrimet e njerëzve ndikojnë në cilësinë e jetës së dikujt.

Diskutimi në grup në pjesën e dytë të rastit studimor

Mësimdhënësi e paraqet rastin në klasë. Më pas ai i ndan nxënësit në grupe me rreth 4-5 njerëz dhe jep një fletë ku paraqet rastin dhe pyetjet. Ai cakton në çdo grup nga një koordinator i cili do të udhëheq diskutimin dhe emëron një sekretar i cili do të marrë shënime për reflektimet dhe propozimet. Gjatë kësaj faze konsultative, mësimdhënësi do të stimulojë diskutimin në çdo grup, pa dhënë ndonjë këshillë specifike.

- Si i ka ndihmuar rasti i jetës së Françeskës shokët dhe shoqet e klasës së saj në zhvillimin e tyre njerëzor?

- Çfarë parimesh janë kuptuar nga shokët dhe shoqet e saj të klasës në përjetimin e vështirësive të saj dhe sfidat me të cilat ajo përballet për çdo ditë?

Pas prezantimit të dytë të ofruar nga çdo grup, mësimdhënësi do të fillojë një diskutim me klasën duke i dhënë më shumë qartësi konceptit për rëndësinë e gjithëpërfshirjes. Në fund, mësimdhënësi do të kërkojë nga secili nxënës të reflektojë thellë për këtë koncept dhe të shkruaj një tekst të shkurtër i cili do të shkëmbehet me pjesën tjetër të klasës.

Rezultati

Nga nxënësit kërkohet që të rishikojnë çka është diskutuar në grupe në këtë njësi, të shkruajnë tregime të shkurta, shkrime komike, video dhe vepra artistike (art rrugor, fotografi, poster..) për temën e gjithëpërfshirjes/përrjashtimit duke punuar në grupe nga 4-5 nxënës.

Nicola Figone
nicola.figone@gmail.com



NJËSIA 29 II

Grup mosha IV: 15 - 19 vjeç

Parimi etik nr. 8: Respekti për cenueshmërinë njerëzore dhe integritetin personal

Në zbatimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktikën mjekësore dhe teknologjitë që lidhën me të, duhet të merret parasysh cenueshmëria njerëzore. Individët dhe grupet lehtë të lëndueshëm duhet të mbrohen dhe të respektohet integriteti personal i tyre.

Titulli

“Gjithëpërfshirja, parim themelor i të jetuarit së bashku II”

Objektivat mësimore

Nxënësit duhet të jenë në gjendje të:

1. Zhvilloj dhembshurinë
2. Mësoj si të pranohet perspektivat dhe pikëpamjet e ndryshme (vet decentralizimi)
3. Zhvilloj respektin për të tjerët dhe dallimin
4. Fitoj njohuri për vështirësitë dhe pengesat që i hasin njerëzit me aftësi të kufizuara
5. Të ketë njohuri për vështirësitë të cilat mund të vijnë nga aspektet e brendshme (pengesa mendore)
6. Kuptoj si mjedisi ndikon në kualitetin e jetës së njerëzve në përgjithësi dhe njerëzve me aftësi të kufizuara
7. Mësoj si ta vlerësoj larminë si pasuri
8. Të mësoj si të kuptoj aftësinë e kufizuar
9. Të mësoj si të marr një qëndrim gjithëpërfshirës në kuptimin më të gjerë si parim themelor të jetës së përbashkët.

Rasti

Pjesa e parë

Aleksi është një djalë 15 vjeçar autik i cili ndjek shkollën e mesme. Autizmi shkakton vështirësi në komunikim dhe ndërveprim me të tjerët dhe në kuptimin e sjelljeve të njerëzve tjerë. Prandaj, kjo çon në izolim dhe veprime të përsëritura. Për më tepër, mosha kognitive e Aleksit është e njëjtë me atë të një djali 5-6 vjeçar. Ai është në gjendje të kuptojë tema të thjeshta dhe të komunikojë në lidhje me përvojën e tij. Ai mezi kupton konceptet abstrakte. Aleksi është një djalë i ndjeshëm i cili është në gjendje të perceptojë emocionet dhe qëndrimet e të tjerëve, edhe pse nuk është në gjendje t'i interpretoj ato. Djaloshi shpesh përsërit të njëjtat gjëra, duke përdorur fjalë sharjesh, shpesh edhe me të rriturit. Zhurmat kaotike ndikojnë shumë keq tek ai duke i shkaktuar shqetësime të rënda dhe konfuzion. Situatat e reja për të janë gjithashtu një burim ankthi dhe çorientimi. Aleksi është në gjendje të shprehet në mënyrë korrekte, por nuk është në gjendje të mbajë marrëdhënie konstruktive me bashkëmoshatarët e vet. Ai shpesh përpiqet të komunikojë me shokët dhe shoqet e klasës së tij, por për shkak të vështirësive, përpjekjet e tij nuk japin shpesh rezultate pozitive, duke i shkaktuar trishtim dhe dekurajim. Qëndrimet e tij agresive dhe të papritura krijojnë pengesë në raport me të tjerët, të cilët frikohen nga reagimet e tij dhe pastaj preferojnë t'i shmangen shoqërimit me të. Si rrjedhojë, edhe stafi mbështetës në fillim hezitonin ta përfshinin në klasë.

Metodologjia e mësimdhënies

Diskutimi në grup në pjesën e parë të rastit studimor

Mësimdhënësi ju paraqet rastin klasës. Pastaj i ndan nxënësit në grupe nga 4-5 njerëz dhe ju jep një fletë ku paraqitet rasti dhe pyetjet. Ai emëron në secilin grup nga një koordinator i cili do ta udhëheqë diskutimin dhe një sekretar i cili do të marrë shënime për reflektimet dhe propozimet. Gjatë kësaj faze të këshillimit, mësimdhënësi do të stimulojë diskutimin në secilin grup, pa dhënë ndonjë udhëzim specifik.

Të mundohemi të reflektojmë sa e vështirë është për një djalë autik të përballet me situata, që në fakt janë normale por që për të janë gjithnjë një test dhe burim ankthi .

- Nëse do të ishit shokë dhe shoqe të tij, çfarë qëndrimesh do të kishit për të zvogëluar stresin e tij?
- Çfarë lloj strategjish dhe mjeteesh do mund të përdoreshin nga mësimdhënësit e tij për ta ndihmuar atë ta kontrollojë vetveten kur përballet me situata të reja?

Të mundohemi të reflektojmë sa është e vështirë për Aleksin të ndërtoj marrëdhënie konstruktive me bashkëmoshatarët e vet.

- Nëse do ishit shokë dhe shoqe të tij çka do bënit për t'i ndihmuar atij?

- Çfarë projektesh do mund të organizoheshin nga mësimdhënësit e tij për të ndihmuar përfshirjen e tij në klasë?

- Sa e rëndësishme mund të jetë për mirëqenien e tij të përgjithshme ndërtimi i miqësive me bashkëmoshatarët e tij?

Secili grup do të organizojë një dramë për të shkëmbyer me të tjerët reflektimet të cilat shfaqen. Në fund të çdo prezantimi artistik nxënësit do të shprehin mendimet dhe idetë e tyre rreth sugjerimeve të ndryshme.

Pjesa e dytë

Me qëllim të zvogëlimit të ankthit të Aleksit, punëtorët mbështetës krijuan një mjedis të sigurt vetëm për të, ku ai mund të ndjehet i relaksuar dhe i qetë dhe ku mund të kryejë disa projekte specifike duke e trajnuar atë të përballet me aktivitetet në klasë. Përveç kësaj, për të zvogëluar konfuzionin e tij janë përgatitur posterë dhe kalendarë të cilët shfaqin aktivitetet ditore dhe javore. Me qëllim të inkurajimit të integritetit të tij me shokët dhe shoqet e klasës, është planifikuar një përfshirje graduale e Aleksit në aktivitetet e klasës, duke filluar me aktivitete artistike dhe sportive, në të cilat Aleksin mund të shprehët më lehtë. Në këtë mënyrë, shokët dhe shoqet e tij të klasës e kanë pasur mundësinë ta njohin atë mirë e më mirë.

Përmes procesit të përfshirjes dhe trajnimit të djalit, shokët mësuhan të lidhen me të dhe të veprojnë në përfshirje me nevojat e tij të veçanta. Tani ata shpesh kërkojnë shoqërinë e tij dhe e ndihmojnë atë në aktivitete të ndryshme arsimore. Për më tepër, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët kanë qenë vendimtare për zhvillimin e aftësive të djalit, i cili edhe më tej kërkon shoqërinë e të tjerëve dhe izolon veten më pak.

Diskutimi grupor në pjesën e dytë të rastit studimor

Mësimdhënësi ju paraqet rastin klasës. Pastaj i ndan nxënësit në grupe nga 4-5 njerëz dhe

ju jep një fletë ku paraqitet rasti dhe pyetjet. Ai emëron në secilin grup nga një koordinator i cili do ta udhëheqë diskutimin dhe një sekretar i cili do të marr shënime për reflektimet dhe propozimet. Gjatë kësaj faze të keshillimit mësimdhënësi do të stimuloj diskutimin në secilin grup pa dhënë ndonjë udhëzim specifik.

- (Çfarë kapacitetesh dhe ndjeshmërie janë fituar nga shokët dhe shoqet e Aleksit duke ju falënderuar marrëdhënieve të tyre me të?

(Si mundet larmia të bëhet burim i pasurimit njerëzor?

Pas prezantimit të dytë të ofruar nga çdo grup, mësimdhënësi do të fillojë një diskutim me klasën duke i dhënë më shumë qartësi konceptit dhe rëndësisë së gjithëpërfshirjes. Në fund, mësimdhënësi do të kërkojë nga secili nxënës të reflektojë thellë për këtë koncept dhe të shkruaj një tekst të shkurtër i cili do të shkëmbehet me pjesën tjetër të klasës.

Rezultati

Nga nxënësit kërkohet që të rishikojnë çka është diskutuar në grupe në këtë njësi, të shkruajnë tregime të shkurta, shkrime humoriste, video dhe vepra artistike (art rrugor, fotografi, poster..) për temën e gjithëpërfshirjes/përrjashtimit duke punuar në grupe me nga rreth pesë nxënës.

Nicola Figone

nicola.figone@gmail.com



NJËSIA 29 III

Grup mosha IV: 15 -19 vjeç

Parimi etik nr.8: Respekti për cenueshmërinë njerëzore dhe integritetin

Në zbatimin dhe avancimin e njohurive shkencore, praktikën mjekësore dhe teknologjitë që lidhën me të, duhet të merret parasysh cenueshmëria njerëzore. Individët dhe grupet lehtë të lëndueshëm duhet të mbrohen dhe të respektohet integriteti personal i tyre.

Titulli

“Gjithëpërfshirja, parim themelor i të jetuarit së bashku III”

Objektivat mësimore

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të:

1. Zhvilloj dhembshurinë
2. Mësoj si të pranoj perspektivat dhe pikëpamjet e ndryshme (vet decentralizimi)
3. Zhvilloj respektin për të tjerët dhe dallimi
4. Fitoj njohuri për vështirësitë dhe pengesat që i hasin njerëzit me aftësi të kufizuara
5. Të ketë njohuri për vështirësitë të cilat mund të vinë nga aspektet e brendshme (pengesa mendore)
6. Kuptoj se si mjedisi ndikon në kualitetin e jetës të njerëzve në përgjithësi dhe njerëzve me aftësi të kufizuara
7. Mësoj si ta vlerësoj larminë si pasuri të pandashme
8. Të mësoj si të kuptoj aftësinë e kufizuar
9. Të mësoj si të marr një qëndrim gjithëpërfshirës në kuptimin më të gjerë si parim themelor të jetës së përbashkët.

Aktivitetet

Filmat

Kursi përfshin organizimin e dy projeksioneve të filmave si “I kuq si qiell” nga Cristiano Bortone, “Unë jam Sam” nga Jessie Nelson, “Rainmaker” nga Barry Levinson, “Dita e tetë” nga Jaco Van Dormael dhe “Të menduarit me fotografi” nga Mick Jackson. Për çdo klub të filmit përgatitet një fletë me përmbledhje të filmit për të stimuluar reflektim dhe diskutim mbi çështjet më të rëndësishme. Kjo do të realizohet nëpërmjet diskutimit në grup dhe diskutimit me gjithë klasën. Filma të tjerë do të rekomandohen për nxënësit si filmografi. Propozimet janë shembuj. Në fakt, ka një game të gjerë të filmit dhe të teatrit në temën e integritetit.

Baskin

Projekti parashikon një shteg të Baskin, një aktivitet sportiv i frymëzuar nga basketbolli por me karakteristika të veçanta dhe inovative. 10 rregullat kryesore, nënvizojnë karakteristikat e tij dinamike dhe të paparashikueshme. Ky sport i ri është i projektuar për të lejuar të rinjtë pa dhe me aftësi të kufizuara, të dyja gjinive, të luajnë në të njëjtin ekip. Baskin lejon pjesëmarrjen aktive të lojtarëve, pavarësisht të ndonjë lloji të aftësisë së kufizuar (fizike ose mendore) për të gjuajtur në kosh. Rregullorja i jep vlerë kontributit të secilit anëtarë të ekipit: në fakt, suksesi i përbashkët varet nga secili. Kjo përshtatje, e cila fuqizon çdo lojtar, lejon për të kapërcyer me sukses tendencën spontane për të pasur një qëndrim “ndihmues” ndaj personave me aftësi

të kufizuar, nxitjen e një klime të gjithëpërfshirjes së vërtetë, përmirësimin e talentit dhe vlerësimin e gjithë begatisë që sjell diversiteti. Baskini ka një efekt të thellë tek nxënësit që mësojnë të integrohen si pjesë e një grupi me aftësi të ndryshme. Nxënësit zhvillojnë aftësi të reja të komunikimit, duke përdorur kreativitetin e tyre dhe ata angazhohen në marrëdhënie të përzemërta autentike. Tek fëmijët me aftësi të kufizuar, Baskin nxit zhvillimin e aftësive psikike dhe motorike, aftësive të buta, besim në veten e tyre dhe aftësinë e tyre për të kombinuar angazhimin dhe kënaqësinë.

Rregullat e Baskinit: <http://www.youtube.com/watch?v=u4vjynEg7jc>

Darka në errësirë

Rruga arsimore përfshin një darkë në errësirë në të cilën nxënësit do të përjetojnë përvojën e të ngrënit në një dhomë pa dritë, pa përdorimin e telefonave celularë ose ajpodëve që të shmanget çdo tundim “elektronik”. Kamerierët dhe udhëheqësit e udhëtimit janë të gjithë burra dhe gra me dëmtime në të parë, të cilët kujdesen për çdo nevojë, bile edhe i shoqërojnë ata në tualet. Nxënësit do të shohin dhe testojnë aftësinë e tyre për t’u përshtatur në një situatë ku ata nuk kanë asnjë kontroll. Aktiviteti lejon shndërrimin e roleve të zakonshme sipas të cilave gjithnjë personi i cili sheh është personi që ndihmon. Djemtë do të jenë në gjendje të bashkë ndjejnë dhe të kuptojnë për së afërmi vështirësitë e shkaktuara nga kjo aftësi e kufizuar dhe të reflektojnë mbi rëndësinë e të parit dhe komunikimit jo-verbal në marrëdhëniet shoqërore. Në ditë më pas do të organizohet një diskutim për të sjellë emocionet dhe mendimet që paraqiten. Në vendet ku këto lloje të përvojave nuk mund të organizohen, mund të organizohet një aktivitet në shkollë, ku mësimdhënësit mund të propozojnë lloje të ndryshme të ushqimeve për të shijuar, ngrënë dhe njohur ato me sy mbyllur.

Aktivitetet në palestër

Kursi ofron një njësi arsimore në palestër ku nxënësit përpiqen të bashkë ndjejnë me një person me aftësi të kufizuar nëpërmjet një serie të aktiviteteve konkrete dhe të reflektojnë mbi pengesat dhe vështirësitë me të cilat një person ballafaqohet në jetën e përditshme. Përmes ushtrimeve të ndryshme nxënësit do të përjetojnë lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara shqisore dhe motorike. Për të stimuluar situatën e të verbërve, janë dhënë aktivitete në të cilën nxënësit me sytë e lidhur mbështeten në dëgjim dhe prekje për të kryer veprime të ndryshme. Në mënyrë që të stimulohet tetraplegjia mund të organizohet një qark me disa pengesa për t’u kaluar me karrocë.

Përvoja e marrjes shembull të fëmijës me karrocë është shumë e dobishme: nxënësit mund të kuptojnë përpjekjet që duhet bërë një person me aftësi të kufizuara dhe që duhet të merr parasysh që të inkurajohet duke zhvilluar ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen.

Metodologjia e mësimdhënies

Secili aktivitet do të pasohet duke shkëmbyer pyetje stimuluese për të shprehur ndjenjat në aspektin fizik dhe emocional.

Diskutim grupor rreth videos, filmave dhe teatrit

Shembuj të pyetjeve për analizën e filmit. “Unë jam Semi”.

Cila është skena që ju ka prekur më së shumti?

Cili karakter ju ka pëlqyer më së shumti? Pse?

Reflektoni në rreshtat nga filmi si më poshtë:

Lucy (vajza e Semit): “. Babë, ju nuk jeni si të tjerët” Ai përgjigjet: “Më vjen keq”, dhe ajo thotë:

“Nuk duhet t’ju vjen keq, sepse baballarët tjerë nuk sjellin fëmijët e tyre në park sikurse ju”. Mundohuni të reflektoni për domethënien e diversitetit. Në cilën mënyrë diversiteti mund të bëhet burim pasurie?

Lucy mëson si të lexoj më mirë se babai i saj, por ajo thotë: “Unë nuk dua të lexoj nëse ju nuk mund të lexoni” Dhe ai thotë: “Nëse ju lexoni atë fjalë unë jam i lumtur” Çfarë emocionesh përcjellë Semi për vajzën e tij? Pavarësisht nga kufizimet e tij intelektuale, a ja arrin ai të mbështesë zhvillimin e saj?

Avokatja (Michelle Pfeiffer) duke mbrojtur Semin thotë: “Aftësitë intelektuale të një individi nuk rrezikojnë kapacitetet e tij për të dashur.” Njerëzit me kapacitete të ndryshme intelektuale kanë të njëjtat nevoja si të tjerët?

Semi i thotë gjykatësit: “Unë dua të jem vetvetja si baba. Unë kam pasur kohë të mjaftueshme për të reflektuar se çfarë do të thotë një baba i mirë dhe kuptova se këmbëngulja, durimi, aftësia për të dëgjuar, pretendimi se je duke dëgjuar edhe kur nuk mund të dëgjoni më ... Unë nuk jam një baba i përsosur, por ne kemi ndërtuar një jetë së bashku dhe e duam njëri-tjetrin. “Sipas mendimit tuaj, a është Semi një baba i mirë? A do t’ia lenit vajzën e tij nën përkujdesje? Avokati (Michelle Pfeiffer) rrëfen për Semin: “Unë ndihem fajtores pasi kam fituar shumë më tepër se ju në marrëdhënien tonë.” Reflektoni rreth asaj se si ne mund të mësojmë nga çdo person. Mundohuni të mendoni për njerëz të afërt me ju dhe në çfarë cilësish ke mësuar prej tyre.

Cilat vlera pozitive janë përmbledhur në karakterin e Semit?

A duhet njerëzit me aftësi të kufizuara të bëjnë një jetë “normale”. Çfarë aktivitete mund të ndërmarr shoqëria që të krijoj mundësinë e jetës normale? Çka mundemi të bëjmë individualisht?

Pyetjet për aktivitetet nr. 2-3-4

Çfarë emocionesh keni ndjerë kur keni qenë me sy të lidhur?

Çfarë vështirësish keni hasur duke u mbështetur në shqisat tjera?

Çfarë strategjish keni përdorur për të vepruar në përgjigje ndaj mungesës së të parit?

Çfarë emocionesh keni pasur duke vënë veten në duart e një personi tjetër i cili po ju udhëhiqte?

Tani që keni provuar mungesën e të parit, çfarë do të thotë të jetoni jetën tuaj në këtë mënyrë?

Çfarë emocionesh keni ndjerë ulur në një karrocë?

Çfarë ndikimesh ka pasur tek ju ndryshimi i pikëpamjeve? Çfarë ndjetë kur ju është dashur të përballeni me pengesa?

Pas gjithë këtyre përvojave, si mendoni se është për një person me aftësi të kufizuara që jeton në një botë të konceptuar për njerëzit “normal”?

Përvoja praktike në vetën e parë është shumë efektive për të nxitur reflektimin dhe për të nxitur zhvillimin e ndjeshmërisë. Kur nuk është e mundur të gjendet një palestër, këto aktivitete mund të organizohen jashtë në natyrë duke përdorur mjete dhe objekte natyrore për të krijuar mundësinë.

Rezultati

Nxënësve ju kërkohet të rikthehen dhe të punojnë në grupe në atë që është diskutuar në njësi, duke prodhuar tregime, libra komik, video dhe punime artistike (art rrugor, fotografi, postera.) Në temën e gjithëpërfshirjes / përjashtimit, duke punuar në grupe me nga pesë nxënës.

Nicola Figone

nicola.figone@gmail.com

Deklarata universale për bioetikën dhe të drejtat e njeriut
[UNESCO, 2005)

Parimi nr. 10

Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Barazia themelore e gjithë njerëzve në dinjitet dhe të drejta duhet të respektohet ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të barabartë



NJËSIA 30

Grup mosha I: 3 - 5 vjeç

Parimi etik nr.10: Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve në dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme

Titulli

“Shkallët e drejtësisë”

Objektivat mësimore

- Qëllimi i kësaj njësie është të tek çdo person rrënjësohet ndjenja e barazisë, drejtësisë dhe paanshmërisë - Të gjithë fëmijët duhet të mësohen për të menduar se në çdo situatë, ka pro dhe kundër dhe ata duhet të ndërtojnë një mendim apo shpjegim në lidhje me situatën specifike.

- E drejta e çdo qenie njerëzore për tu trajtuar në mënyrë të barabartë, në përputhje me këtë parim, është koncept bazë dhe themelor që duhet të rrënjësohet thellë tek çdo person në çdo shoqëri. Megjithatë, marrja e këtij koncepti si diçka e kryer është gabim: në fakt, është e nevojshme të merret një arsim adekuat për drejtësi dhe barazi dhe të mos anashkalohej nën asnjë rrethanë, koncepti se të gjithë kanë të drejta dhe përgjegjësi.

Rasti

Hyrje

Këtu ne propozojmë një përrallë të thjeshtë ku karakteret kryesore të saj janë kafshë që jetojnë në pyll. Historia mund të vazhdojë duke paraqitur kafshët e tjera që jetojnë në pyll të tilla si bufi, kolibra, kërmilli, gjarpri, ariu, ujku, dhelpra, dhe kështu me radhë. Gjëja më e rëndësishme për të mbajtur mend është që të mos ikim nga tema. Mos harroni të ndërroni një kafshë që duket “e mirë” (e përshkruar duke përdorur mbiemra cilësor pozitiv), me një tjetër kafshë “të keqe” ose “të rrezikshme” (e përshkruar duke përdorur mbiemra cilësor negativ). Në këtë mënyrë, ne jemi në gjendje të inkurajojmë fëmijët që të mendojnë se “asgjë nuk është ashtu si duket”, dhe të mos gjykojnë nga dukja.

Natyrisht, kjo paraqet vetëm një nga mundësitë e panumërta për të tërhequr vëmendjen e fëmijëve në “dilema” të thjeshta për t’i analizuar ato dhe për të gjetur zgjidhje.

ASGJË NUK ËSHTË ASHTU SI DUKET

Njëherë e një kohë, një lepur i vogël la shtëpinë për të shkuar në pyll për të takuar miq të rinj. Lepuri i vogël nuk njihte askënd tjetër përveç familjes së tij, kështu që ai vërtetë kërkonte të gjente shokë të rinj për të lozur. Ai ishte shumë kureshtar për të parë kush jetonte në pyll dhe nuk frikësohej aspak. Prindërit e tij ishin të brengosur për të ardhmen e tij dhe sidomos për naivitetin e tij dhe mungesën e përvojës jetësore. Para se ai të nisej në udhëtimin e tij, ata i thanë: “I dashur, mos harro se asgjë nuk është ashtu siç duket!”. Lepuri i vogël nuk e kuptonte kuptimin e paralajmërimit të prindërve të tij; gjithsesi, ai premtoi se nuk do ta harroj këtë fjali. Sapo hyri në pyll, lepur i vogël u takua me një ketër të mrekullueshëm me bisht të gjatë dhe të shpejtë që endej lart dhe poshtë një pemë të madhe lisi, duke mbledhur gogla për darkë. Lepuri i vogël u përpoq të bisedonte me të, por ai vetëm ju përgjigj: “Tani nuk kam kohë për ty, ju lutem prisni këtu deri sa të kthehem” dhe u zhduk. Lepuri i gjorë qëndroi aty disa orë, por

ketri me bisht të gjatë nuk u kthye. Lepuri i vogël ishte i zhgënjyer, sepse ketri me bishtin e tij të gjatë dhe elegant dukej të ishte i singertë. Në atë moment, atij iu kujtua ajo që prindërit e tij i kishin thënë: “Asgjë nuk është ashtu siç duket!” Lepuri i vogël nuk e lejoi veten të dekurajohet dhe u nis. Vazhdoi të ecte, derisa ai u pengua nga një top i rrumbullakët me gjemba. Ai u shpua dhe kërcëj rrotull i frikësuar. Por ai shpejt e pa se dy sy pak të ndritshëm përgjonin nga topi me gjemba. Një zë i vogël e i këndshëm bërtiti: “Më vjen shumë keq; Nuk e kisha ndërmend t’ju lëndoja! A mund të më falësh?” “Nuk ishte top me gjemba, ai ishte një iriq i vogël që e ftoj lepurin e vogël për të ngrënë, dhe ata u bënë miq.

Lepuri i vogël ishte i habitur që pas një lemerie të tillë të madhe ai mund të ndjehej aq i lumtur dhe rehatshëm me një “top gjembash” të rrezikshëm. Kur ai shprehu ndjenjat e tij, iriqi qesharak i tha “Mbaj mend miku im: Asgjë nuk është ashtu siç duket” Pas një kohë, lepurin i vogël vendosi të largohet dhe të vazhdoj udhëtimin e tij. Ec e ec dhe ai shkoi, deri sa dëgjoi këngën e bukur të një bilbili. Ai ngriti kokën dhe pa një zog të mahnitshëm; ai donte të bëhej mik me të. Megjithatë, kur lepurin i vogël i tha: “Përsëritet, çfarë zëri të bukur që keni! A doni të bëheni miku im?”. Bilbili ishte i zemëruar, dhe ju përgjigj lepurit të vogël me një ton mospërfillës: “Kurrë! Unë nuk kam nevojë për shoqërinë tuaj! “Dhe ai fluturoi larg, duke lënë lepurin e gjorë pak me hundën e tij të varur. Si mundet një zë aq i mrekullueshëm të thotë fjalë të tilla të shëmtuara! Oh, kjo është e vërtetë: “Asgjë nuk është ashtu siç duket ...”. Lepuri i vogël u pikëllua dhe mbeti i menduar.

Papritmas, një ari i madh ngjyrë kafe doli nga një shkurre manaferre. Lepuri i vogël ishte aq i frikësuar sa ngriu nga frika. Ai nuk mund të lëvizte dhe nuk ishte në gjendje të thotë as edhe një fjalë. Ai mendonte se kjo kafshë gjigante leshatake do ta përpinte atë në një kafshatë, por Tedi (ky ishte emri i ariut të madh ngjyrë kafe) buzëqeshi dhe e ftoi lepurin e vogël në shtëpinë e tij, ku mund të pushonte dhe të hante një darkë shumë të shijshme. Jashtë po errësohej dhe të qenit i vetmuar në pyll mund të jetë e rrezikshme. Lepuri i vogël ishte i habitur edhe një herë; ai nuk mund të kishte imagjinuar të bëhej mik i mirë me një gjigant të tillë të egër. Përsëri, atij ju kujtua se “asgjë nuk është ashtu siç duket”. Një ditë më pas ai u largua nga ariu dhe nga pylli, dhe u kthye në shtëpi. Ai ishte shumë i lumtur që i pa prindërit e tij dhe shumë i ngazëllyer që t’ju tregoj atyre për aventurat e tij. Ata ishin shumë krenarë për lepurin e vogël, së pari për shkak se ai u kthye shëndoshë e mirë, dhe më pas për shkak se ai kishte arritur qëllimin e tij për të bërë miq të rinj.

Por gjëja më e rëndësishme që lepurin i vogël kishte mësuar ishte se dukja mund të jetë mashtruese:

mos gjyko një libër nga kopertina për shkak se është shumë lehtë për të gjykuar dikë sipas mënyrës si ai duket.

- Ketri i mrekullueshëm bishtagjatë mund të mos jetë i besueshëm;
- Iriqi qesharak si top me gjemba mund të mos jetë i rrezikshëm;
- Një bilbil i mahnitshëm me një zë të mrekullueshëm mund të mos jetë i sjellshëm;
- Një ari i madh ngjyrë kafe mund të mos jetë i rrezikshëm;

Para leximit të përrallës, do t’ju paraqesim fëmijëve grupet e kafshëve me të cilat personazhi kryesor (lepurin i vogël) i tregimit do të takohet në përrallë. Ne mund t’ju përshkruajmë ata banorë të pyllit duke përdorur fotografi / vizatime.

- Ketri i mahnitshëm bishtagjatë dhe i shpejtë / iriqi qesharak si top me gjemba

- Bilbili i mahnitshëm me zë të bukur / ariu i madh ngjyrë kafe

Dhe kështu me radhë nëse mësimdhënësi do të zbuloj ardhjen e më shumë grupeve të kafshëve (duke respektuar kriteret e lartpërmendura).

Pastaj, i pyesim fëmijët se cilat kafshë duket të jenë më të mirat në mes të dyjave në çdo çift.

Fëmijët do të përgjigjen duke përdorur guralecë: për shembull, një guralec të kuq në qoftë se atyre ju pëlqen ketri, atë të gjelbrën për iriqin dhe kështu me radhë.

Ne do t'i shkruajmë zgjedhjet individuale dhe të përgjithshme të fëmijëve.

Pas leximit të tregimit do t'ju paraqesim përsëri grupet e kafshëve dhe do t'ju kërkojmë fëmijëve edhe një herë, cila duket të jetë kafsha më e mirë në çdo çift.

Ata do të bëjnë zgjedhjen e tyre duke përdorur përsëri guralecët dhe ne do të krahasojmë rezultatet e reja individuale dhe ato të përgjithshme. Në fund, ne do t'i pyesim fëmijët nëse kanë ndryshuar dhe pse kanë ndryshuar mendjen, duke i zgjidhur të gjithë së bashku "dilemat" e përrallës.

Metodologjia e mësimdhënies

Shkallët e drejtësisë përfaqësojnë simbolin e paanshmërisë. Nëse nuk keni në dispozicion shkallë të vogla të matjes si kjo, mundeni thjesht të bëni një të tillë duke përdorur dy tasa të njëjtës madhësi dhe dy guralecë të rrumbullakët për secilin fëmijë. Do të zgjedhin dy ngjyra kryesore, për shembull e kuqe dhe e gjelbër: në këtë mënyrë çdo fëmijë do të ngjyros guralecët duke përdorur ngjyra tempera. Përndryshe, mund të përdorni dy mermerë të ngjyrave të ndryshme. "Loja" është e thjeshtë: mësuesi / edukatori, në varësi të moshës dhe karakteristikat e grupit, do të zgjedhë një ose më shumë fabula / tregime të niveleve të ndryshme të vështirësisë dhe do të sjellë vëmendjen e fëmijëve tek ato. Në fund të tregimit, do t'ju bëjmë fëmijëve një pyetje, në të cilën secili prej tyre do të përgjigjet duke përdorur një nga guralecët me ngjyra. Secila nga dy ngjyrat do të jetë e lidhur me një përgjigje të ndryshme.

Fëmijët duhet të zgjedhin vet guralecët e tyre, duke u përpjekur që të mos ndikohen nga mësuesi ose shokët e vet. Në fund, ne do të llogarisim sa guralecë të çdo ngjyrë kemi mbledhur për të kuptuar ku do të tregoj peshorja. Pasi të jenë deklaruar "rezultatet e kombinuara", mësimdhënësi do të përpiqet të analizoj disa pika të rëndësishme të përrallës së bashku me fëmijët për t'ju dhënë atyre një mundësi për të shqyrtuar historinë dhe të përpiqen të kuptojnë pse ajo përfundoi ashtu në atë mënyrë. Në fund, ne do kërkojmë nga fëmijët të konfirmojnë ose të ndryshojnë zgjedhjet e tyre të mëparshme duke vendosur një nga dy guralecët në një nga dy tasat.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com



NJËSIA 31

Grup mosha II: 6 - 10 vjeç

Parimi etik nr.10: Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve në dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme

Titulli

“Udhëtimi me tepih fluturues”

Objektivat mësimore

- Çdo qenie njerëzore ka të drejtë të shoh të respektohet dinjiteti i tij / saj dhe të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë si çdo qenie tjetër njerëzore. Teorikisht, ky koncept merret si diçka e kryer, por në praktikë është shumë i vështirë për t’u realizuar, bile edhe në ato shoqëri që konsiderohen të jenë “më të përparuara”. Vetë njeriu krijon një pengesë të pakapërcyeshme, duke i segreguar ata që janë ndryshe nga ai në bazë etnike, kulturore dhe sociale, duke rezultuar në paragjykime të rrënjosura thellë. Administrimi i drejtësisë dhe trajtimi në mënyrë të barabartë duket të jetë e pamundur.

- Respektimi i diversitetit kulturor dhe pluralizmi përfaqëson një burim të jashtëzakonshëm të trashëgimisë njerëzore. Injorimi dhe frikësimi nga ajo që është “ndryshe nga ne” krijon pengesa të mëdha dhe paragjykime të pakapërcyeshme. Ne mund të krijojmë kushte për shoqëritë e reja, ku secili person mund të gjej vendin e vet dhe lirinë për të shprehur veten, për shembull përmes edukimit të hershëm adekuat.

- Një botë shumë etnike që është e hapur për të mirëpritur larmi të madhe të shprehjes njerëzore është një zgjidhje praktike për të jetuar një jetë në paqe dhe solidaritet.

- Zbulimi i vendeve, kulturave dhe traditave të ndryshme do të ndihmojë fëmijët të kuptojnë se sa e madhe dhe e larmishme është bota, që stimulon jo vetëm kureshtjen e tyre, por edhe i edukon ata të respektojnë thellësisht ata që janë “të ndryshëm nga ne”, rrënjos vetëdijen për drejtësinë dhe barazinë për çdo qenie njerëzore.

Loja

Shembulli nr.1

“Sot do të bëjmë një udhëtim me qilimin tonë fluturues ... të shkojmë në Kinë. Kina është një vend shumë i madh dhe vërtetë është shumë larg nga ne. “Ky është një shembull se si mund të paraqesim një udhëtim në një vend së huaj. Së pari, mësuesi do t’i pyes fëmijët nëse ata kanë dëgjuar ndonjëherë për këtë vend dhe çka dinë në lidhje me të. Do të shkruhen të gjitha sugjerimet e fëmijëve. Nga disa fëmijë do të kërkohet që, të marrin nga një objekt nga qesja e udhëtimit. Kjo qese do të jetë e mbushur me të gjitha mjetet e dobishme për përshkrimin e karakteristikave më tipike të vendit të studiuar më parë. Në qoftë se nuk kemi objekte reale, mund ti vizatojmë ato në disa fletë të letrës. Kur flasim për Kinën mundemi për shembull, të vizatojmë një faltore, një artikull tipik të veshjeve, Ideograme kineze, një gatim tipik kinez (të tillë si orizi) dhe të ngjashme. Ne mund të tregojmë një nga tregimet apo legjendat e tyre, apo të dëgjojmë një këngë kineze që mund ta mësojmë për ta kënduar. Nëse një prej fëmijëve në

grup ndodh të jetë kinez, ai ose ajo mund të ndihmojë pjesën tjetër të grupit për të zbuluar vendin e tyre të origjinës duke përshkruar traditat, duke i mësuar disa fjalë në gjuhën e tyre amtare (si, për shembull, si të thonë tungjatjeta ose faleminderit), apo edhe ndoshta të hahet një ushqim tradicional së bashku. Ndoshta, njohja me kulturat dhe traditat e reja mund të na ndihmojë t'i marrim ato jo si diçka të largëta apo të ndryshme nga ne, të rrënjësim thellë në shpirtrat tanë ndjenjën e barazisë midis gjitha qenieve njerëzore, duke filluar nga jeta e tij / saj e përditshme.

Shembulli nr.2

Qilimi jonë fluturues mundet për shembull, të udhëtoj përreth dhe të eksploroj rajone të ndryshme të njëjtit vend. Ka shpesh rivalitet dhe paragjykime midis veriut dhe jugut, apo në mes të lindjes dhe perëndimit. Në të njëjtin rajon të një vendi të caktuar është e mundur të vërehet evolucioni i kulturave të ndryshme të ndikuara nga faktorët historik dhe gjeografik. Në fillim të lojës është gjithmonë e dobishme t'i pyesim fëmijët se çfarë dinë në lidhje me atë rajon dhe pas kësaj t'ju sigurojmë disa nga karakteristikat e atij vendi. Për shembull, dialektet shpesh janë gjuhët e vërteta që në vete pasqyrojnë një trashëgimi të pasur me poezi, këngë dhe tregime nga të cilat ne mund të kuptojmë më mirë vendin që jemi duke vizituar. Edhe në këtë rast ne mund të përshkruajmë traditat karakteristike dhe festimet apo ngjarjet e veçanta, si karnavalet që i japin popullaritet vendit që jemi duke eksploruar. Edhe enët tipike dhe ëmbëlsirat mund të shkëmbehen dhe disa nga recetat më të thjeshta mund të përgatiten në grup. Gjëja më e rëndësishme është që dallimet t'i vlerësojmë si fuqi dhe si thesare kulturore përderisa ne përpiqemi të kapërcejmë çdo diskriminim të mundshëm të fshehur që për fat të keq shpesh fokusohet në disa stereotipe negative të rrënjësura thellë. Nëse ka ndonjë fëmijë në grup që vjen nga vendi për të cilin ne po flasim “udhëtimi jonë” kjo mund të nxit integrimin e tyre në një mënyrë pozitive.

Shembulli nr.3

Në këtë rast ynë qilimi fluturues do të hulumtojë komunitetet e vogla etnike dhe llojet e tjera të grupeve, sipas moshave dhe karakteristikave të ndryshme të fëmijëve. Kur shikojmë një komunitet rom, një manastir, një kibuc (bashkësi e vogël) dhe pakica tjera, të cilat janë vende që mund të jenë shoqëri shumë larg nga ajo e jona, ato duhet të hulumtohen me kujdes duke respektuar jetesën e tyre dhe natyrisht duke respektuar plotësisht të drejtën e tyre për tu shprehur. Barazia, drejtësia dhe paanshmëria, të gjitha i përkasin njerëzimit: ne mund të ndërtojmë një botë më të mirë me një mendje të hapur, gjithmonë e gatshme të ballafaqohet me shoqëri të reja, duke respektuar në të njëjtën kohë veten dhe të tjerët.

Metodologjia e mësimdhënies

Edhe këtu mësimdhënësi/edukatori mund të përdor metodologji të ndryshme, varësisht nga moshat dhe karakteristikat e ndryshme të grupit, duke pasur parasysh që secili “udhëtim” me qilim fluturues kërkon një punë përgatitore paraprake. Diversiteti dhe pluralizmi kulturor mund të ofrojnë mundësi të shumta: qilimi jonë fluturues do të jetë në gjendje të fluturoj jo vetëm rreth vendeve të ndryshme të botës, por edhe rreth të njëjtit vend dhe rreth regjioneve dhe komuniteteve të ndryshme të vogla për të studiuar dhe mësuar kush është “ndryshe nga ne”, stile tjera të jetesës dhe mënyra tjera të ekzistencës. Një burim tjetër shumë i rëndësishëm mund të jetë prania e një apo më shumë fëmijëve të huaj në grup. Në fakt, ata munden të shërbejnë bashkë me mësimdhënësin si udhëzues në “udhëtimin” tonë në vendin e tyre të origjinës. Në këtë mënyrë do të promovojmë integrimin e tyre në klasë si dhe respektin për kulturat dhe shoqëritë e ndryshme të cilat janë parakushte themelore për një shoqëri të barabartë dhe të drejtë.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com

NJËSIA 32

Grup mosha III: 11 – 14 vjeç

Artikulli etik nr.10: Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve në dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme

Titulli

“Barazia, drejtësia dhe paanshmëria”

Objektivat mësimore

- Njohja e kuptimeve të barazisë, drejtësisë dhe paanshmërisë dhe nenit 10 të deklaratës universale mbi bioetikën dhe të drejtat njerëzore.
- Vetëdijesimi për faktin që duhet respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme
- Njohuritë për të dalluar çka është respekti i vërtetë për barazinë universale midis qenieve njerëzore nga mospajtimet e dukshme në situatat e mundshme në jetën shoqërore

Rasti

PJESA E PARË

Në një shkollë, në një zonë rurale, e ndjekur nga të rinjtë (11- 14 vjeç) mësimdhënësja e shkencës gjatë një ore mësimore për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit që na rrethon u shpjegon nxënësve të saj degradimin që mbizotëron në qytetin në të cilin ata jetojnë. Ajo i fton ata të marrin masa të përpiqen për të përmirësuar këtë situatë dhe për këtë arsye ajo propozon të formojnë një shoqatë bamirësie për të mbrojtur mjedisin, që ta mbajnë atë të pastër.

Një grup nxënësish janë të entuziazmuar për idenë dhe kërkojnë leje nga udhëheqësi i institucionit për të organizuar një mbledhje me të gjithë nxënësit e shkollës për të diskutuar idenë. Shumica e tyre pajtohen, por paraqiten dallime në mendime kur vjen momenti i marrjes së vendimit për kushtet që duhet t’i plotësojnë individët për tu bërë anëtarë të asaj shoqate.

Në mënyrë që të vendoset rregull në punë, grupi formues i cili mendon të koordinoj mbledhjen, vendos të bëjë një përmbledhje të saktë të gjitha propozimeve që kanë dalë nga individët për t’i paraqitur ato më pas për miratim nga kuvendi. Diskutimi tregon se:

- 1) Disa argumentojnë se të gjithë, pa përjashtim, duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme të vendoset ndonjë kriter për pranim. Është e mjaftueshme të qenit nxënës i regjistruar në shkollë
- 2) Menjëherë më pas, dikush thekson kontradiktën e propozimit të parë. Nëse thuhet se të gjithë mund të marrin pjesë, atëherë vërtet shoqata duhet të jetë e hapur për të gjithë.
- 3) Të tjerët argumentojnë se duhet të zgjidhen anëtarët, pasi jo të gjithë kanë karakteristikat fizike kulturore për të përmbushur qëllimin e shoqatës.
- 4) Të tjerët pajtohen me zgjidhjen numër 2, por theksojnë se kjo zgjedhje duhet të paraqes kriteret të cilat janë vërtet relevante dhe adekuate për të arritur objektivat e shoqatës.

Në këtë pike, kuvendi ftohet të votoj për propozimin

Mësimdhënësi ndërpret tregimin dhe propozon aktivitetin e pikës A të paraqitur në metodologjinë e mësimdhënies.

PJESA DYTË

Pas votimit, kuvendi, si shumicë vendos që të gjithë, pa dallim kanë të drejtë të marrin pjesë në shoqatë dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme të vendoset ndonjë kriter për pranim. Në këtë pikë mësimdhënësja e shkencës, e cila deri atëherë nuk kishte thënë asgjë, ndërhyr duke shkruar në tabelë këtë fjalë, e cila përcakton sjelljen e mirë dhe fton kuvendin të reflektoj për këtë.

“Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme”

Menjëherë më pas shumica e pjesëmarrësve mendonin se zgjedhja e bërë është e drejtë. Në fakt, të gjithëve ju garantohet e drejta për të marrë pjesë. Mësimdhënësja në këtë moment ngrit pyetjen si në vijim. Një fëmijë dyvjeçar, a mund të jetë në gjendje të marrë pjesë aktive në aktivitetet e shoqatës? Të gjithë thonë jo. Mësimdhënësja vazhdon me një pyetje tjetër. Nëse këtij fëmije nuk i lejohet të marr pjesë, a do të respektohej vërtetë e drejta e tij themelore për tu trajtuar në mënyrë të barabartë nga qeniet tjera njerëzore?

Nuk dimë si është përgjigjur kuvendi dhe çfarë vendimesh janë marrë. Mundohuni të gjeni zgjidhjen që mendoni se është e drejtë.

Mësimdhënësja propozon aktivitetin e pikës B të paraqitur në metodologjinë e mësimdhënies.

Metodologjia e mësimdhënies

Pika A

Mësimdhënësja ja paraqet klasës pjesën e parë të rastit. Ajo i fton nxënësit të imagjinojnë se janë anëtarë të kuvendit dhe të reflektojnë për katër zgjidhjet e ofruara dhe të votojnë për njëren prej tyre ose të propozojnë zgjidhje të reja. Bile edhe këto mund të vendosen në mesin e zgjidhjeve të mundshme.

Pastaj, dy zgjidhjet më të votuara do të hidhen në votim dhe ajo që merr më së shumti vota është qëndrimi i klasës. Në diskutim mësimdhënësja nuk guxon të jep indikacione për zgjidhjet, por duhet t'i pyes individët për arsyet pse i kanë ato zgjidhje.

Pika B

Mësimdhënësja ja paraqet pjesën e dytë të rastit klasës. Këtu bëhet krahasimi i zgjedhjes së bërë nga klasa me zgjedhjen që ka bërë kuvendi i prezantuar në rast. Këto mund të jenë të ngjashme apo të ndryshme.

Më vonë ajo kërkon nga grupi të japin përgjigje në pyetjet e ngritura në rastin e përshkruar dhe në fund shqyrtojnë domethënien e fjalisë :

“Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme”

Në aspektin e barazisë, drejtësisë dhe paanshmërisë.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it

NJËSIA 33

Grup mosha III: 11 - 14 vjeç

Parimi etik nr.10: Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme

Titulli

“Sjellja e njëjtë: ndëshkimi i njëjtë?”

Objektivat mësimore

- Njohja e kuptimeve të barazisë, drejtësisë dhe paanshmërisë dhe nenit 10 të deklaratës universale mbi bioetikën dhe të drejtat njerëzore.
- Vetëdijesimi për faktin se duhet respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme.
- Njohuritë për të dalluar çka është respekti i vërtetë për barazinë universale midis qenieve njerëzore nga mospajtimet e dukshme në situata të caktuara të mundshme në jetën shoqërore

Rasti

Ndërtesa shkollore të cilën vijojnë fëmijët ndodhet në një kodër dhe ka një oborr të madh përpara, e mbështetur nga një mur i lartë me një kopsht me perime të kultivuara mirë. Disa nxënës duke pritur para orëve mësimore gjuajnë letra, shishe dhe objekte tjera në të veç sa për tu argëtuar.

Pronari i ngopur me mbledhjen e mbeturinave shkon tek drejtori dhe i kërkon atij të bëjë diçka për të ndaluar problemin. Ky i fundit vendosi të shtoj në rregulloren e institutit ndalimin e hedhjes së mbeturinave në kopsht dhe për vendosjen e shenjave në oborr si kujtesë e atij ndalimi. Pavarësisht nga kjo, një mësues e sheh një djalë me emrin Bob i cili hedh një shishe plastike në kopsht dhe e çon te drejtori i cili ndëshkon djalin duke e pezulluar atë nga shkolla për një ditë. Djali proteston se nuk është e drejtë që ai të jetë i vetmi që do të dënohet dhe ankohet se pak ditë më parë e kishte parë shokun e tij të klasës Lukën të bënte të njëjtën gjë. Një mik i Bobit, për ta mbështetur atë, thotë se vëllai i tij Charls, në të njëjtën ditë, kishte hedhur një tullumbace të shpuar dhe 2 shishe qelqi në kopsht. Ai megjithatë pranon, se në fakt nuk e kishte parë këtë ngjarje, por e kishte lexuar atë në ditarin personal të vëllait, ku djali mburrej për veprimin e kryer. Në këtë pikë, kreu i Institutit duke mos ditur se çfarë të bënte, vendos të mbledh të gjithë mësuesit e shkollës që të gjej një zgjidhje të përshtatshme. Dolën propozime të ndryshme nga debati dhe drejtori i shkollës i përmblodhi ato si më poshtë:

- 1) Luka nuk duhet të dënohet pasi ai e bëri veprën para se të vendoset ndalesa në rregullore, përderisa Bobi dhe Çarlisi e kanë ditur se janë duke e thyer një rregull të formuluar qartë.
- 2) Vetëm Bobi duhet të dënohet sepse Çarlisi është akuzuar vetëm si rezultat i thyerjes së privatësisë (lexim i paautorizuar i ditarit nga vëllai i vet) dhe ai ka qenë vet viktimë

- e shkeljes së një prej të drejtave të tij. (E drejta për privatësi).
- 3) Pasi të tre djemtë e kanë kryer të njëjtën vepër duhet të aplikohet i njëjti dënim. Të tre nuk arritën të përmbushin një normë shoqërore për të cilën nuk kanë mundur të jenë në dijeni.
 - 4) Nuk është e drejtë të dënohet ndonjëri prej tyre pasi mos pajtimi me një normë shoqërore nuk është akt i dënueshëm.

Sikur edhe mund të shihet qartë, zgjidhjet e ndryshme të propozuara janë shumë të ndryshme dhe shumë kontraktore. Drejtori i institutit ka më tepër dyshime se më parë. Çfarë lloj këshille mund t'i japim atij ashtu që të mundet të marr vendimin më të drejtë dhe me etik?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi ja paraqet rastin klasës. Për të lehtësuar diskutimet në mes të nxënësve, ai/ajo i bën dy grupe dhe i fton ata të reflektojnë se cilat zgjidhja mund të jenë më të përshtatshme nga pikëpamja etike.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep ndonjë sugjerim konkret, por thjesht lehtëson diskutimin. Pas zgjidhjes (ndoshta me shumicë) zgjidhja e cila konsiderohet më e mira duke pasur parasysh rastin, secili grup ja paraqet atë në një grupi tjetër duke përdorur lojën me role. Në veçanti, disa nxënës mund të marrin rolet e protagonistëve të ndryshëm në tregim duke mbështetur qëndrimet e tyre deri sa marrin për të përfaqësuar zgjidhjen me të cilën pajtohen. Pas prezantimit, secili fëmijë në grup, deklaron nëse ai / ajo pajtohet ose jo me zgjidhjen e propozuar nga grupi tjetër, që ka motivuar zgjidhjen e tij / saj.

Në këtë moment mësimdhënësi e shpjegon kuptimin e “barazisë”, “drejtësisë” dhe “paanshmërisë” dhe ju paraqet nenin 10 të deklaratës universale të bioetikës dhe të drejtave njerëzore e cila thekson:

“Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të paanshme.”

Ai fokuson vëmendjen e fëmijëve në pyetjen që paraqitet në titullin e rastit “E njëjta sjellje: ? I njëjti ndëshkim”, dhe thekson se mund të ketë barazi, drejtësi dhe paanshmëri edhe në qoftë se situatat e njëjta trajtohen në mënyra të ndryshme.

Në dritën e këtyre fakteve të reja, mësimdhënësi fton klasën të rishikojnë zgjedhjet e bëra më parë dhe të modifikojnë ato nëse është e nevojshme. Në këtë fazë, mësimdhënësi udhëheq diskutimin.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 34

Grup mosha IV: 15 - 19 vjeç

Parimi etik nr.10: Barazia, drejtësia dhe paanshmëria

Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të barabartë

Titulli

“Unë, si qenie njerëzore”

Objektivat mësimore

- Zhvillimi i ndjenjës së respektit për vetën dhe të tjerët
- Zhvillimi i qëndrimeve dhe sjelljeve që qojnë në respektimin e të drejtave të fqinjëve të tyre
- Krijimi i respektit për të drejtat e njerëzve dhe liritë themelore
- Mbështetja barazisë së vërtetë gjinore dhe mundësitë e njëjta për të dyja gjinitë
- Njohja e konceptit të “barazisë” dhe kjo e siguruar me nenin nr.10 të deklaratës universale të bioetikës dhe të drejtave të njeriut

Rasti

M.B. gruaja e këngëtarit të famshëm të muzikës rok, vendosi të thyej heshtjen duke postuar një deklaratë në një rrjet social. Ajo kërkon përmes një njoftimi në media ta lënë atë (të qetë), ta respektojë këtë moment dhe në veçanti të ndalojnë së foluri për të.

Ajo shkroi: «Nëse keni dashur të na lëndoni dhe të na përjashtoni, ja keni arritur qëllimit».

Disa kanale të rëndësishme të internetit postuan një video ku burri i saj po e godiste në korridorin e hotelit.

Me një goditje të vetme asaj i ra të fikët. Kamerat e hotelit regjistruan këtë ngjarje. Kjo ngjarje kishte ndodhur në dimër të vitit 2012. Në verën pasuese, disa burime të informuara mirë raportuan për këtë sulm. Ajo në fillim e raportoj këtë ngjarje në polici, por me vonë vendosi të heq dorë nga padia.

Gjatë një konference për media, M.B. sqaroi se «ndjehet e penduar për rolin që kishte luajtur gjatë asaj ndodhie».

Avokati i këngëtarit edhe menaxheri, të dytë, u munduan ta fajësojnë atë dhe padrejtësisht ta bëjnë përgjegjëse. Grushti është gjithnjë grusht. Megjithatë, ajo akoma qëndronte me të.

M.B. u përmend nga mediat si “e vetmja viktimë reale”. Kjo në disa orë u bë temë atraktive në rrjetet sociale: ajo qoi në mijëra komente, deklarime të grave të cilat ishin për qëndrim në shtëpi në vend të braktisjes. Të gjitha ato folën për atë se sa e vështirë është largimi na shtëpia dhe për mekanizmat prapa qëndrimit në një marrëdhënie të dhunshme.

«Kam menduar se e dua atë». Ose: «Nuk dija ku të shkoja». Apo bile: «Ishte faji im; ai nuk donte të më rrihte».

Qëllimi është të jemi në gjendje të dimë kur ndodhë abuzimi. Shumë prej tyre sugjeruan që M.B. të shkojë në terapi. «Ju nuk jeni vetëm,» i shkruan ata asaj në ueb faqen e saj. Të tjerët

e sulmuan. Ajo vetëm kërkoj ta lënë të qetë dhe shpjegoj: «Kjo është çështje imja personale».

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi ja praqet rastin klasës, duke i ftuar ata që të ndahen në grupe pune dhe të shprehin mendimet e tyre duke pyetur pyetjet si më poshtë:

- A ka një lidhje midis ndjenjës së posedimit, pronës dhe dhunës ndaj grave?
- Çfarë roli luajnë mediat akoma në zhvillimin e modeleve të veçanta, apo modeleve shoqërore të femrave?
- Pse gruaja e rrahur dhe e poshtëruar vendos të rri në familje?
- A japin fuqia dhe kontrolli kënaqësi?
- A është dhuna ndaj gruas karakteristike vetëm për kulturat moderne?
- Cilat janë sjelljet e drejta që duhet t'i kemi në familje ose në aspekt më të përgjithshëm me njerëz?

Në këtë pikë mësimdhënësjë nuk jep sugjerime konkrete por kufizohet në lehtësimin e diskutimit. Pas kësaj, ajo thekson mendimin e shumicës së klasës. Vetëm atëherë mësimdhënësjë e shpjegon domethënien e “barazisë, drejtësisë dhe panashmërisë” dhe pastaj e paraqet nenin e 10 të deklaratës universale të bioetikës dhe të drejtave të njeriut e cila thekson: “Duhet të respektohet barazia themelore e gjithë njerëzve për dinjitet dhe të drejta ashtu që të trajtohen drejtë dhe në mënyrë të barabartë”

Pas këtyre informatave të reja mësimdhënësjë kërkon nga klasa të mendojnë për pikëpamjet e më parme dhe ndoshta edhe t'i ndryshojnë ato. Në këtë moment mësimdhënësjë e udhëheq diskutimin dhe shfrytëzon këtë mundësi për të shqyrtuar konceptet e paraqitura.

Materialet e mësimdhënies

Duhet të hulumtohen në ueb faqe dhe të zgjidhen nga mësimdhënësi/ja.

Materialet e mësimdhënies

Duhet të hulumtohen në ueb faqe dhe të zgjidhen nga mësimdhënësi.


Ornella Salvetti
ornisal@libero.it



Deklarata Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 11
Mos diskriminimi dhe mos stigmatizimi

Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.



NJËSIA 35

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Neni për etikën nr.11: Mos-diskriminimi dhe mos-stigmatizimi

Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Titulli

“Macja ime e vogël e kuqërremtë”

Objektivat e mësim nxënies

Fëmijët duhet ta kuptojnë dukurinë e diskriminimit. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë dhe të merren me situatat e diskriminimit.

Rasti

Tori është macja jonë. Në të vërtetë ajo iu përket të gjithë fëmijëve në lagjen tonë. Të gjithë e pëlqejnë atë. Ajo i ka qimet e gjata të lëmuara, të buta dhe të shndritshme. Ajo e di ku t’i gjejë ushqimet e hedhura, ku të lëpijë qumësht nga enët e vogla, dhe kush i lë mbeturinat të hapura. Një ditë Tori u zhduk. Ne e thërrisim atë, e kërkuam gjithkund dhe nuk e gjetëm. Kaloi një ditë, pastaj edhe një tjetër, Tori kishte ikur. Ne ishim shumë të pikëlluar. Pas një jave, herët në mëngjes e dëgjuam një zë të njohur: “mjau...mjau...” “Është Tori” bërtita. Kërceva nga shtrati. E hapa derën e hyrjes, dhe çfarë pashë: Tori jonë e bukur po qëndronte e shtrirë mbi një tepih të vogël të hyrjes, e rrethuar nga katër kotele. “Tori u kthye” tregova me zë të lartë. “Ejani dhe shiheni!”

Ishin tri kotele ngjyrë hiri pranë barkut të saj, leshatake dhe të buta, dhe një e kuqërremtë sikurse unë, e vogël dhe e hollë. E solla një batanije të leshtë për të ngrohur Torin dhe një shihte të vogël me qumësht të ngrohtë. Tori u shtri në tepihun e leshtë dhe i thirri kotelet e saj për të pirë qumësht. Tri kotelet e hirta të buta iu afruan asaj. Gjithashtu edhe e kuqërremta e vogla iu afrua, por tri tjerat e largonin me këmbë. “Mjau, mjau, jam e uritur” bërtiste e vogla. Tori e tërhoqi kotelen e vogël tek barku, duke shpresuar se i ka mbetur mjaftë qumësht. Kur u rritën kotelet, ne dëshironim që atyre t’iu gjejmë shtëpi të mira. Të gjithë shokët tonë dëshironin të adaptojnë kotelet e buta të leshata.

Të gjitha u morën një nga një. Askush nuk dëshironte ta adaptojë macen e kuqërremtë. “Është e shëmtuar”, ata thoshin, “pothuajse është pa qime. Është shumë i thatë, shumë i dobët.” Kotelja e vogël dhe e imët nuk e kuptoi pse askush nuk e shikonte. Mua mu dhimbs. “Çfarë do të bëjmë?” e pyeta nënën. Ajo e shikoi kotelen e vogël dhe pastaj kokën time të kuqërremtë dhe tha: “E vogla do të qëndrojë me ne. Ajo dhe Tori do të jenë pjesë e familjes tonë.” Nëna ime shtoi: “Ka mace me të gjitha llojet e ngjyrave, bardhë e zi, argjend dhe kuqërremtë, por nën lëkurën e tyre, të gjitha janë mace.” Unë isha shumë i lumtur të kem Torin tonë të vjetër dhe vëllain tim të vogël, të ri të kuqërremtë.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet të zhvillojë një diskutim duke i parashtruar pyetjet, sikurse këto në vijim:

- Pse kotelet e leshta e mbanin atë të kuqërremtë larg nënës dhe nuk i lejonin të pi qumështin?
- Si ndihej kotelja e kuqërremtë në atë moment?
- Si ndihej nëna për këtë?
- Çfarë ka bërë nëna?
- Cila do të ju pëlqente më shumë? Kotelja e leshtë apo ajo e kuqërremta? Pse?
- Nëse do të ju lejonim që të merrni dhe të adaptoni një kotele: Cilën do të dëshironit ta merrni në shtëpi, një kotele të leshtë apo të kuqërremtë? Pse?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 36

Grup moshë I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 11: Mos-diskriminimi dhe mos-stigmatizimi

Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Titulli

“Tjetri ndryshe nga ti”

Objektivat e mësim nxënies

- ofrimi i kohës së caktuar dhe hapësirës së duhur në të cilën fëmijët mund të shprehin emocionet e tyre dhe merren me të tjerët për të përmirësuar shkathtësitë e tyre të komunikimit verbal dhe jo verbal duke u njohur me përvojën e tyre emocionale dhe trupore, shtimi i aftësive fizike të të shprehurit;
- perceptimi i llojllojshmërie të shkallës së dytë në kuptim të saktësisë në gjuhë dhe pjesëmarrje, vëmendja që iu kushtohet të tjerëve, duke supozuar se shkathtësitë njohëse dhe sociale janë ndërlidhura ngushtë;
- integrimi i atij që është ndryshe nga ata për të mos i diskriminuar

Rasti

Na ishte njëherë një ujk i cili kishte lindur i bardhë. Asnjëri nga ujqit tjerë nuk kishte parë një gjë të tillë ndonjëherë. Nëna e ujkut e shikonte birin e saj me interesim dhe kënaqësi. Megjithatë, me t'u rritur të gjithë e refuzonin ujkun e bardhë. Madje edhe prindërit e tij nuk e përfillnin atë, duke mos i dhënë as emër.

Prandaj, një ditë ujku i bardhë pa emër u largua nga kopeja. Në udhëtimet e tij ai u takua me një ujk të zi të quajtur Leo. Ujku i bardhë pa emër dëshironte të bëhej miku i tij, por pa pasur emër për vete, ai ndihej i pikëlluar dhe në siklet pasi që nuk kishte identitet. Por ujku i zi ia dha një emër, e quajti atë “Borë”, sepse ishte i bardhë si bora. Që nga ai moment e tutje ata jetuan të lumtur dhe ishin bashkudhëtarë të pandashëm të shumë aventurave të mrekullueshme.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Çfarë mendojmë kur e takojmë dikë i cili është ndryshe nga ne? Sa jemi të ngjashëm, dhe sa jemi të ndryshëm? Nëse ai nuk është krejt si ne, sa i ndryshëm është? Për të promovuar një proces të mësim nxënies gjithëpërfshirëse dhe për të kuptuar debatet dhe ushtrimin, fletat mund të jenë mjet i dobishëm ku, për të shkruar pyetje të sakta për llojllojshmërinë fëmijët stimulohen të japin përgjigje dhe të krijojnë shkallën e tyre të vlerësimit. Qëllimi nuk është për të gjykuar, por për t'iu ndihmuar atyre të zhvillojnë hartën e tyre duke e përfshirë tjetrin, duke kërkuar vetëm emocionet e vërteta.

Fëmijët e fillojnë debatin të ulur në rreth për të sjellë emocione të ndryshme. Pyetja e parë e mësimdhënësit do të prezantojë punimet e fëmijëve: kur e takojmë dikë i cili është shumë i ndryshëm nga ne, çfarë mendojmë?

Pyetjet drejtuese: Kur jemi të pikëlluar, a buzëqeshim? Kur jemi të lumtur, çfarë shprehje tregon fytyra jonë? Çfarë bënë fytyra jonë pastaj? Kur dështojmë të bëjmë diçka me përpjekjen e parë, si ndihemi? Kur dikush na ndihmon, si e dimë nëse jemi të lumtur apo të pikëlluar?

Në bazë të përgjigjeve të dhëna nga fëmijët: 1) ai/ajo është i huaj, ai/ajo nuk është nga shteti im, ai/ajo nuk është në rregull. 2) Nëse ajo/ai është i huaj, nuk e flet gjuhën time. Si mund të komunikoj? 3) Nëse ajo/ai nuk e flet gjuhën time, a do të thotë ai/ajo nuk mund të flasë? 4) Ajo/ai nuk më kupton mua gjithashtu; për këtë arsye nuk mund të flas me të. Si komunikojmë nëpërmjet emocioneve?

Tregojuni fëmijëve si t'i shprehin emocionet e tyre. Aktivitet do të ndihmojnë kërkimin për zgjidhje të dilemave me anë të lojërave, "zbulimit", trajtimit, pyetjeve, kuriozitetëve dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve.

Francesca Piccolo
francescapiccolo90@gmail.com



NJËSIA 37

Grup moshë III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr.11: Mos-diskriminimi dhe mos-stigmatizimi

Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Titulli

“Cili është ndëshkimi i duhur i cili duhet të caktohet?”

Objektivat e mësim nxënies

- Njohja e konceptit të diskriminimit dhe asaj çfarë e përcakton neni 11 i Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut.
- Njohja me faktin se asnjë qenie njerëzore nuk duhet të diskriminohet, sepse të gjithë kanë të drejtë për trajtim të barabartë.
- Aftësia për të dalluar se çfarë është diskriminimi real – që do të thotë një veprim i kryer me paramendim nga një qenie njerëzore ndaj një personi tjetër – nga diskriminimi i qartë, i pa shkaktuar nga vullneti specifik, sikurse në rastin në vijim ku përdorimi i llojeve të ndryshme të ndëshkimit nuk mund të konsiderohet diskriminues

Rasti

Andrea dhe Marko, dy djem të moshës 14 vjeçare janë shokë të klasës. Për shkak të veprimit të tyre të pasjellshëm, ata janë ndëshkuar nga mësimdhënësi i matematikës, i cili iu ka dhënë atyre shumë ushtrime shtesë, duke i detyruar ata të kalojnë fundjavën duke i kryer detyrat e shtëpisë. Dy djemtë, si hakmarrje për mësimdhënësin vendosën t’ia shqyejnë katër gomat e veturës të parkuar në oborrin e shkollës, duke mos e vënë re që me të vërtetë e tërë hapësira është e pajisur me sistem të vëzhgimit të kamerave të sigurisë. Si pasojë, ata janë vënë re lehtë dhe janë konstatuar fajtor.

Drejtori i shkollës, duke e pasur parasysh lartësinë e veprës së kryer i tubon të gjithë mësimdhënësit lëndor për të vendosur se çfarë veprimi duhet të merret. Të gjithë pajtohen se është e nevojshme t’iu caktohet të dy nxënësve dënim i njëjtë, fajtor në mënyrë të barabartë, që përbënë suspendim nga klasa për një javë. Mësimdhënësi i muzikës thekson se, megjithatë babai i Andreas njihet si person shumë i dhunshëm i cili shpesh e rrahë djalin e tij për arsye të parëndësishme, andaj ndëshkimi i caktuar nga shkolla do të mund ta rrezikonte djalin seriozisht. Kjo deklaratë e ngjallë një debat të gjatë ndërmjet mësimdhënësve. Mësimdhënësi i edukatës fizike argumenton se në këtë situatë, për gabimin e njëjtë Andrea do t’i nënshtrohej një ndëshkimi më të rëndë se sa Marko dhe do të diskriminohej. Mësimdhënësi i gjeografisë beson se është qenësore të garantohet siguria fizike e Andreas dhe mendon se djali, që jeton në një mjedis të dhunshëm familjar, nuk e meriton ndonjë sanksion të mëtejshëm dhe sugjeron që ndëshkimi t’i caktohet vetëm Markos. Menjëherë, mësimdhënësi i matematikës përgjigjet se në këtë rast do të kishte diskriminim ndaj tjetrit. Mësimdhënësi i edukatës fizike flet duke argumentuar sërish se, në këtë pikë, në vend të marrjes së rrezikut të diskriminimit

të njërit prej djemve, është më mirë të mos ndëshkohet askush. Drejtori i shkollës, duke e konsideruar ngjarjen shumë serioze për ta injoruar e përjashton mundësinë e mos marrjes së veprimit disiplinor: kjo do të krijonte precedent të rrezikshëm. Duke i marrë parasysh faktet dhe mendimet e ndryshme të shprehura, cili do të ishte vendimi më i drejtë etik të cilin duhet ta marrin mësimdhënësit?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi e prezanton këtë rast në klasë. Për të lehtësuar debatin, ai i krijon dy grupe dhe i fton ata të reflektojnë se cila zgjidhje do të ishte më e përshtatshme nga këndvështrimi etik.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep ndonjë këshillë konkrete, dhe thjeshtë e moderon diskutimin. Pas vendosjes për zgjidhjen (sigurisht me shumicë) e cila konsiderohet më e mira, secili grup ia prezanton atë tjetrit duke përdorur lojën me role. Në veçanti, disa nxënës i marrin rolet e aktorëve të ndryshëm të ngjarjes, duke i mbështetur qëndrimet e tyre deri sa të arrijnë të përfaqësojnë zgjidhjen për të cilën kanë arritur pajtim.

Në fund të prezantimit, një fëmijë në secilin grup deklaron nëse ai/ajo pajtohet apo jo me zgjidhjen e propozuar nga grupi tjetër, duke e arsyetuar zgjedhjen e tij/saj.

Në këtë pikë, mësimdhënësi e shpjegon kuptimin e “diskriminimit”, term i cili paraqitet disa herë në tekstet që e përshkruajnë rastin dhe e prezanton nenin 11 të Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut, e cila thotë:

“Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet në çfarëdo sferë”

Mësimdhënësi jep disa shembuj konkret të diskriminimit të cilët mund të jenë për shkak të dallimit në gjini, fe apo pozitë shoqërore. Në dritë të këtyre fakteve të reja, ai e fton klasën që të shqyrtojnë sërish zgjedhjet e bëra më herët dhe të ndryshojnë ato nëse konsiderohet e nevojshme, në lidhje me rastin e prezantuar dhe i parashtrojnë këto pyetje:

A do të ishte diskriminim i vërtetë nëse Andrea dhe Marko do të ndëshkoheshin në mënyrë të ndryshme për shkak të situatave të ndryshme?

Në këtë fazë, mësimdhënësi e udhëheqë diskutimin dhe e shfrytëzon këtë mundësi që të thellohen konceptet e prezantuara.

Në rastin e shqyrtuar nuk ka diskriminim: caktimi i ndëshkimeve të ndryshme për veprimin e njëjtë është thjeshtë pasojë e situatave të ndryshme të jetesës së personave të përfshirë.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 38

Grup moshë III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 11: Mos-diskriminimi dhe mos-stigmatizimi

Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet mbi çfarëdo baze, në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Titulli

“A është e drejtë të bëhet ai udhëtim shkollor?”

Objektivat e mësim nxënies

- Njohja e konceptit të diskriminimit dhe çfarë thotë neni 11 i Deklaratës Universale për Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut.
- Vetëdijesimi se asnjë qenie njerëzore nuk duhet të diskriminohet, sepse të gjithë kanë të drejtë të kenë trajtim të njëjtë.
- Aftësia për të dalluar çfarë është diskriminim i vërtetë, i cili me paramendim ushtrohet nga një qenie njerëzore ndaj një personi tjetër, nga diskriminimi i dukshëm i shkaktuar nga një dëshirë specifike, por nga ndikimi i kushteve negative të jetesës së një individi të caktuar.

Rasti

Mësimdhënësi i artit e sugjeron një projekt të klasës që ka të bëjë me studimin në thellësi të strukturës arkitektonike mesjetare të një kështjelle të shekullit të trembëdhjetë e cila ndodhet rreth pesëdhjetë kilometra nga shkolla. Projekti kërkon jo vetëm vizitën tek kështjella, por gjithashtu që nxënësit gjatë gjithë ditës të kryejnë rolin e cicëronit për vizitorët. Të gjithë nxënësit janë entuziast dhe punojnë shumë për rreth dy muaj.

Në fund të punës teorike, mësimdhënësi e organizon vizitën te kështjella dhe vetëm atëherë e kupton se ka bërë një pakujdesi serioze. Në të vërtetë, kështjella gjendet mbi një shkëmb dhe mund të arrihet në pjesën e fundit vetëm nëpërmjet një rrugice të ngushtë dhe me bunga. Në mesin e nxënësve është edhe një nxënëse me aftësi të kufizuara e cila është e lidhur për karroce dhe e cila në të vërtetë do të mbetej e përjashtuar nga aktiviteti. Babai i vajzës nuk pranon që ajo të përjashtohet nga ky aktivitet, duke e parë këtë si diskriminim dhe ankohet te drejtori i shkollës. Preokupimi i tij arrin te profesori i artit i cili e arsyeton veten duke thënë se përzgjedhja ka ardhur te kështjella për shkak se është shembull tipik i arkitekturës mesjetare, në këtë mënyrë është e përshtatshme nga aspekti arsimor sipas programit mësimor, dhe për shkak se mund të shkohet gjatë ditës dhe me shpenzime të vogla, brenda buxhetit të ‘familjeve’ të tërë nxënësve.

Babai i nxënëses insiston se vajza e tij e ka të drejtën e njëjtë sikurse nxënësit e klasës së saj për të marrë pjesë në aktivitetin mësimor në të cilin ajo ka qenë e përfshirë dhe e angazhuar me entuziazëm dhe thekson se ajo nuk mund të diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar, prandaj sugjeron që klasa të vizitojë një kështjellë tjetër edhe pse gjendet shumë më larg, që do të jetë shpenzim më i madh për familjen pasi nevojitet qëndrimi për një natë.

Mësimdhënësi përgjigjet se me veprimin e tillë puna arsimore e bërë deri më tani do të

humbte pjesën më të madhe të kuptimit të saj, dhe sigurisht nxënësit nuk do të kishin mundësi të vepronin si cicëron për vizitorët. Për më tepër, ai vazhdon duke pohuar se disa familje mund të mos jenë në gjendje t'ia dalin me shpenzime më të mëdha dhe në këtë mënyrë disa nxënës mund të përjashtohen nga aktiviteti dhe të diskriminohen për shkaqe ekonomike. Ai vjen në përfundim duke thënë se në këtë pikë, megjithëse me keqardhje ai beson se është më mirë të anulohet udhëtimi shkollor. Babai i vajzës thotë se ai nuk ka këshillë tjetër për të dhënë, por nuk do të dëshironte që anulimi i udhëtimit të teren t'i atribuohet vajzës së tij nga nxënësit tjerë me pasoja të mundshme negative për të. Duke u ballafaquar me këtë situatë, drejtori i shkollës nuk ka ndonjë zgjidhje të menjëhershme dhe e rezervon të drejtën për të dhënë një përgjigje. Çfarë këshille mund të jepni në mënyrë që ai të merr një vendim më të drejtë etik?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi ia prezanton klasës dy rastet. Ai i krijon dy grupe të nxënësve, secila nga ato ftohet të reflektojë se cila do të mund të ishte zgjidhja më e përshtatshme etike.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep sugjerime konkrete, por thjeshtë e udhëheq diskutimin. Secili grup, pasi të kenë vendosur (me siguri me shumicë) për zgjidhjen që e konsiderojnë si më të mirën, ia prezanton grupit tjetër me anë të një prezantimi të shkurtër. Në veçanti, disa nxënës i marrin rolet e aktorëve të ndryshëm të tregimit duke i mbështetur pozicionet e tyre deri sa të prezantojnë zgjidhjen për të cilën janë pajtuar.

Në fund të prezantimit, një nxënës/e në secilin grup deklaron nëse ai/ajo pajtohet apo jo me zgjidhjen e propozuar nga grupi tjetër, dhe mundësisht të thuhet arsyet.

Vetëm në këtë pikë, mësimdhënësi do të shpjegojë kuptimin e “diskriminimit”, term i cili paraqitet disa herë në tekstet që e përshkruajnë rastin dhe e prezanton nenin 11 të Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut, e cila thotë:

“Asnjë individ apo grup nuk duhet të diskriminohet apo stigmatizohet në çfarëdo baze (...)”

Në kuptim të kësaj njohurie të re, mësimdhënësi e pyet klasën që të mendojnë për përfundimet për rastin e marrë më herët dhe të ndryshohet nëse konsiderohet i nevojshëm. Në këtë fazë, mësimdhënësi e udhëheq diskutimin dhe e shfrytëzon rastin për të thelluar konceptet e prezantuara.

Në të dyja rastet dhe në veçanti në të parën, është një situatë diskriminimi, madje edhe nëse në realitet disa karaktere, varësisht nga situatat e krijuara mund t'i nënshtrohen trajtimit të ndryshëm. Mësimdhënësi, siç përmendet më lartë, megjithatë e ka mundësinë që, me tërheqjen e vëmendjes në mënyrë të sigurt dhe me motivimin e nxënësve me diskutimin e rasteve, të shqyrtojë forma të ndryshme të diskriminimit të cilat ende ekzistojnë në botë dhe të cilat duhet të luftohen.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



Deklarata Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 12
Respekti për diversitetin kulturor dhe pluralizmin

Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre.



NJËSIA 39

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 12: Respekti për diversitetin kulturor dhe pluralizmin

Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre

Titulli

“Flamujt”

Objektivat e mësim nxënies

Duke qenë të vetëdijshëm se i përkasim një bote ku njerëzit me gjuhë, zakone dhe tradita të ndryshme mund të jetojnë së bashku dhe ku flamujt e përfaqësojnë identitetin e tyre, kjo na e hapë mendjen tonë për stile të ndryshme të jetës dhe mënyra të ndryshme për t’u shprehur me respekt reciprok. Krejt në fund, përkundër dallimeve tona, ne të gjithë i përkasim një familje të madhe njerëzore.

Loja

Shembulli nr. 1

Për të mësuar dhe për të njohur flamujt e ndryshëm, së pari nevojitet vizatimi dhe ngjyrosja e tyre. Pastaj i prezantojmë në grupe të vogla, duke filluar nga ata më karakteristik (të cilët do të mbahen në mend më lehtë, siç është për shembull flamuri kanadez, i cili e ka një gjethe të kuqe panje, apo flamurin japonez me një rreth të kuq në qendër), dhe të vazhdohet me ata që kanë ngjyra të njëjta, por me shirita horizontal apo vertikal (siç janë për shembull ai i Belgjikës dhe i Gjermanisë). Sapo të ngjyrosen, mund të prehen. Pastaj secili mund të vendoset mbi hartë, tek shteti që e përfaqëson. Varësisht nga mosha dhe karakteristikat e grupit, mund të japim më shumë informata, për shembull emrin e kryeqytetit dhe gjuhen e cila flitet. Secili fëmijë me rend do të përsërisë këto informata, pasi të qëllonjë shtetin të cilit i përket flamuri. Madje edhe mund të mësojmë tri apo katër fjalë nga disa prej gjuhëve të huaja të shteteve të cilat përfaqësohen me flamuj. Këto fjalë mund të jenë: MIRËSERDHE, FALEMINDERIT, DASHURI, PAQE, sepse ato ndihmojnë në shprehjen e shoqërisë dhe solidaritetit tek të gjithë fëmijët. Për më tepër, disa nga fjalët mund të shkruhen në alfabetin e tyre origjinal, duke e përdorur për shembull ideogramët kinez apo skriptet arabe. Një lojë shumë e dobishme për të mbajtur në mend flamujt e ndryshëm dhe fjalët do të jetë loja e memories: për secilin flamur (njëzet së paku) ne do të riprodhojmë dhe premë nga dy mostra në karton, derisa për disa fjalë do të bëjmë vetëm një kopje. Ana tjetër e kartonit do ta ketë ngjyrën e njëjtë për të gjithë flamujt dhe fjalët. Sapo të jenë gati të gjithë flamujt në karton dhe të përzihen, secili fëmijë pastaj do të rrotullojë dy prej tyre për të kërkuar dy mostra të flamurit të njëjtë, pasi ta njeh emrin e shtetit. Loja do të fitohet duke e vendosur se kush ka më së shumti flamuj. Kartonët që i përfaqësojnë fjalët i lejojnë lojtarit që të marrë kartonin e dytë të cilën dëshiron ta rrotullojë. Kjo duhet të jetë metaforë se si fjalët gjithnjë ofrojnë zgjidhje të suksesshme. Përdorimi i fjalëve të duhura do të ofrojë shansin për të zgjidhur problemet në të gjithë botën.

Shembulli nr. 2

Loja e dytë, paksa më dramatike, do të kërkojë ndarjen e fëmijëve në dy grupe: në secilin grup një fëmijë e përfaqëson një shtet, flamuri i të cilit do të shtypet në maicën e tij/saj, apo më thjeshtë, të vizatohet në një pjesë kartoni që të varet rreth qafës së fëmijës. Dy fëmijë, një nga secili grup do ta përfaqësojë shtetin e njëjtë. Mësimdhënësi apo fëmija i pa përfshirë në dy grupet do të përzgjedhë një ngjyrë dhe të gjithë ata që e kanë atë ngjyrë në flamurin e tyre duhet të vrapojnë sa më shpejtë që është e mundur që të marrin shallin me ngjyrë të njëjtë, të vendosur në distance të barabartë brenda dy grupeve. Para marrjes së shallit, fëmija duhet të shqiptojë njërën nga fjalët e shtetit të cilin e përfaqëson. Loja fitohet nga grupi i cili ka grumbulluar më së shumti shalle të ngjyrës së duhur. Një opsion tjetër do të mund të ishte përzgjedhja e kryeqytetit të një shteti, përfaqësuesit e të cilit në secilin grup duhet të vrapojnë në një rrugë duke u kthyer sa më shpejtë që është e mundur në ulëset e veta. Para se të ulet në ulësen e duhur, fëmija duhet gjithnjë të shqiptojë disa nga fjalët e shtetit që e përfaqëson. Kjo nuk është vetëm mënyrë për të mësuar një gjuhë, por edhe mënyrë e shprehjes së mesazhit pozitiv në të gjitha gjuhët e botës. Më i shpejti do të fitojë një pikë. Loja mund të luhet në mënyra shumë të ndryshme: qëllimi është që të mësohen dhe të dallohen flamujt, duke u argëtuar.

Shembulli nr. 3

Të luhet loja “po shëtisim nëpër pyje” e cila luhet duke i mbajtur të gjithë fëmijët në një rreth, secili prej tyre me flamur të ndryshëm, një shtet pran tjetrit, sipas pozitës së tyre në hartë. Sikurse në lojën e mëhershme, secili fëmijë e përfaqëson një shtet të ndryshëm flamuri i të cilit do të shtypet në maicë apo thjeshtë të varet në qafë. Fëmija pa flamur i radhitë nxënësit e klasës sipas vendit që e ka secili shtet në hartë. Sapo ai/ajo të ia dalë, do të vendosë se cili fëmijë do të zë vendin e tij/saj, duka ia dhënë flamurin e vet. Gjatë këtij hapi, fëmijët duhet të këmbëjnë disa nga fjalët e shtetit, vendin e të cilit ai/ajo e merr. Shfrytëzimi i këtyre fjalëve paraqet qasje të sjellshme e cila duhet gjithnjë të merret parasysh për t’iu dëshiruar mirëseardhje njerëzve të huaj dhe për të komunikuar me ata. Në fund të lojës, të gjithë fëmijët do të luajnë lojën po shëtisim nëpër pyje duke kënduar këngë apo duke e përsëritur vjershë për fëmijë për botën.

Metodologjia e mësimdhënies

Fëmijët gjithnjë janë fascinuar me flamuj. Ngjyrat e tyre dhe shenjat e tyre e rrisin kuriozitetin e fëmijëve dhe mund të mundësojnë lojëra të ndryshme dhe krijojnë momente argëtuese. Nuk duhet të harrojmë se flamujt përfaqësojnë kombe të ndryshme të botës, andaj ata janë mjet praktik për prezantimin e diversitetit kulturor dhe pluralizmit.

Flamujt mund të përdoren në mënyra të shumta. Gjëja më e rëndësishme është se secila lojë nuk është fund në vetvete. Në të vërtetë, qëllimi themelor duhet theksohet, që është për të promovuar diversitetin kulturor dhe pluralizmin, solidaritetin dhe respektin në mesin e kombeve të ndryshme. Për më tepër, përdorimi i disa fjalëve të huaja nuk është lojë e memories, por e përfaqëson mënyrën për të mësuar se si të mirëpreten njerëzit që vijnë nga e tërë bota. Të mësuarit për të njohur dhe riprodhuar flamuj të ndryshëm është vetëm hapi i parë në mësimin për botën e cila na rrethon dhe e cila e përbën trashëgiminë e vërtetë njerëzore.

Për lexim

Vjersha për fëmijë rreth botës (Gianni Rodari) – Eskimo (Gianni Rodari) - Udhëtimi i gjatë (Gianni Rodari)

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com

NJËSIA 40

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 12: Respekti për diversitetin kulturor dhe pluralizmin

Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre

Titulli

“Një nxënës i huaj i është bashkuar klasës tuaj”

Objektivat e mësim nxënies

- Njohja e përmbajtjes së nenit përkatës 12 të Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut.
- Përvetësimi i rëndësisë së respektimit të diversiteteve kulturore dhe pluralizmit

Rasti

Një nxënës nga Kina i quajtur Dong është caktuar në klasën e nxënësve dymbëdhjetë vjeçar në shkollën e një fshati të vogël të një shteti evropian, i cili ka ardhur vetëm me anë të imigrimit. Mësimdhënësi rekomandon që nxënësit të i dëshirojnë mirëseardhje nxënësit të ri të klasës, në mënyrë që ai të ndihet i pranueshëm, përkundër vështirësive të pashmangshme të komunikimit për shkak të dallimeve në mes të dy gjuhëve. Kur Dongu hyn në klasë për herë të parë, ai i përshëndet të gjithë me një buzëqeshje të theksuar dhe me përkulje. Giovanni, nxënës i sjellshëm dhe i shoqërueshëm menjëherë shkon te ai dhe e përqafton dhe e puthë në faqe. Dongu nuk e vlerëson fare dashamirësinë e Giovannit dhe reagon duke e shtyrë atë shumë, kështu që Giovanni rrëzohet përtokë. I tronditur dhe i nervozuar, Giovanni reagon dhunshëm dhe e grushton Dongun.

Mësimdhënësi shpejtë i ndanë të dy djemtë dhe paralajmëron masë disiplinore pasi që rregullat e shkollës qartë e ndalojnë dhe ndëshkojnë çfarëdo lloj të sjelljes së dhunshme në mes të nxënësve. Kjo në mënyrë të pashmangshme nxitë diskutim të ashër dhe të gjithë nxënësit e mbrojnë Giovannin dhe konsiderojnë se ndëshkimi i tij është plotësisht i padrejtë. Në këtë pikë, mësimdhënësi i thekson arsyet e reagimit të çuditshëm të Dongut, duke thënë se në shtetin e tij kontakti fizik është i paqortueshëm dhe i pasjellshëm, i cili shpjegon se pse ai në mënyrë të befasishme e shtyu Giovannin.

Mësimdhënësi shton se megjithatë Dongu nuk do të duhej të reagoje ashtu si reagoi, sepse edhe nëse kemi të drejtë, nuk na lejohej që të marrim ligjin në duart tona vetëm pse jemi të ofenduar. Nxënësit nuk binden plotësisht me argumentet e mësimdhënësit, por japin mendime të ndryshme. Njëri mendon se Giovanni nuk duhet të ndëshkohet pasi që ai reagoi në një situatë të pakuptueshme për të, pasi që ai tregoi miqësi dhe kishte një reagim të

pasjellshëm.

Një tjetër thotë se nëse Giovanni duhet të ndëshkohet patjetër, po ashtu duhet të ndëshkohet edhe Dongu. Një i tretë vlerëson se nëse dhuna është shkaktuar për shkak të keqkuptimit të zakoneve të ndryshme, askush nuk duhet të ndëshkohet.

Dikush tjetër mendon se mësimdhënësi menjëherë do të duhej të nënvizonte këto dallime kulturore, në mënyrë që të parandalonte të ndodhte çfarëdo keqkuptimi.

Në fund, njëri gjithashtu pohon se Dongu më herët do të duhej të njoftohej për zakonet e vendit se ku do të vendosej, t'i pranojë ato dhe të përshtatej.

Çfarë opinioni keni? A pajtoheni me disa nga argumentet e përmendura më lartë? A keni ndonjë propozim tjetër?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi ia prezanton klasës këtë rast. Për të lehtësuar debatin, ai i krijohen dy grupe dhe i fton ata të reflektojnë për atë se cila situatë do të ishte më e përshtatshme, nga këndvështrimi etik.

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep ndonjë këshillë konkrete, dhe thjeshtë e moderon diskutimin. Pas vendosjes për zgjidhjen (me siguri me shumicë) e cila konsiderohet të jetë situata e dhënë më e përshtatshme. Në fund të prezantimit, nëse të dy palët kanë bërë zgjidhje të ndryshme, secili nxënës i grupit e jep mendimin e vet personal për përzgjedhjen e bërë nga grupi tjetër.

Në këtë pikë, mësimdhënësi e prezanton dhe e komenton nenin 12 të Deklaratës Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut, e cila thotë se:

“Theks i duhur duhet t’i vihet rëndësisë së respektimit të kulturave të ndryshme nga tonat dhe pluralizmit, por në të njëjtën kohë, kjo nuk duhet të cenoj respektin për dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.”

Në dritën e fakteve të reja, mësimdhënësi e fton klasën që të rishqyrtojë zgjidhjet e bëra më herët dhe t’i ndryshojnë ato nëse konsiderohet e nevojshme. Në këtë fazë, mësimdhënësi e udhëheq diskutimin dhe në veçanti e thekson rëndësinë e njohjes së kulturave dhe zakoneve të njerëzve tjerë.

Lexim

Nëpërmjet Google-it, është e mundshme në internet të gjenden zakone të ndryshme të njerëzve të cilat mund t’i konsiderojmë si bizare dhe ndoshta qesharake, por njohja me to mund të parandalojë keqkuptime të pakëndshme. Më poshtë gjenden disa shembuj:

Në Spanjë, hedhja e letrave mbeturina në dysheme në një kafene do të thotë se e kemi vlerësuar ushqimin. Sa më shumë bërlllok, më shumë njerëz do të ndalen te kafeneja!

Në Kinë dhe Tajvan shkopinjë, që përdoren për të ngrënë oriz mund të përdoren edhe për të larguar ushqimin që mbetet në mes të dhëmbëve. Madje është e pranueshme që njerëzit të pështynë në njërin qosh të pjatës.

Në Togo veshja e gjerdanit të bërë nga rruazat do t’i bënte të qeshin të gjithë, pasi që rruazat përdoren ekskluzivisht për mbërthyer rrobat e brendshme me rrip.

Në Indi nusja duhet ta pret dhëndrin. Ai mund të vijë në këmbë, me kali apo me elefant dhe ia sjellë vjehrrës një arrë kokosi në mënyrë që të mos duket i pasjellshëm.

Në Azinë Qendrore, është e ndaluar t'iu fryhet hundëve para njerëzve tjerë, konsiderohet veprim i marrshëm dhe i turpshëm, në veçanti nëse përdorni shami të hundëve. Aziatikët kanë prirje të mos iu fryjnë hundëve, por nëse me të vërtetë iu duhet, ata fshihen dhe i përdorin duart.

Në Australi, ekziston një ligj i pakëndshëm sipas së cilit fëmijët mund të pinë duhan por nuk mund të blejnë duhan.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it

NJËSIA 41

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 12: Respekti për diversitetin kulturor dhe pluralizmin

Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre

Titulli

“Ejani të luajmë për të njohur njëri tjetrin”

Objektivat e mësim nxënies

- Parimi i diversitetit si pasuri
- Rëndësia e ndërtimit të identitetit personal
- Respekti për dallimet

Rasti

Marku është i mbijetuar nga një aksident në një ishull. Ai është i frikësuar dhe ecën përreth për të kërkuar strehim dhe diçka për të ngrënë. Së shpejti, ai e kupton se nuk është i vetëm: në të vërtetë, në ishull jeton një fis i cili e mirëpret. Në fillim Marku frikësohet sepse gjithçka i duket aq ndryshe nga njerëzit që i ka takuar më herët: ata nuk përdorin rroba, por lëkurë kafshësh, ata vrapojnë këmbë zbathur, hanë vetëm fruta dhe perime të kultivuara në pyll dhe jetojnë në kasolle. Fëmijët e moshës së tij nuk kanë as telefona dhe as kompjuterë andaj ai ndihet i mërzitur, duke e konsideruar jetën e fisit si tepër të pasigurt. Një ditë, ai e kupton se një grup i fëmijëve po e përqeshin: udhëheqësi i fisit ia shpjegon se edhe fëmijët e tyre mendojnë se ai është i çuditshëm sepse ai veshë gjithnjë shumë rroba, nuk mund të vrapojë nëpër dru dhe nuk i di emrat e kafshëve apo bimëve. Marku dhe fëmijët nuk i respektojnë dallimet e tyre dhe e përqeshin njëri tjetrin. Por me kalimin e kohës, ata e njohin njëri tjetrin, duke mësuar shumë gjëra dhe loja të reja. Për shembull: Marku e kupton se ecja këmbë zbathur mbi barë është shumë e këndshme dhe fëmijët e kuptojnë se kur është ftohtë është më mirë të vishen me rroba. Në fund të gjithë e kuptojnë pasurinë dhe rëndësinë e vlerësimit të dallimeve të tyre, duke e respektuar njëri tjetrin.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

- A do të ishte më mirë për Markun të jetojë në ishull apo të kthehet në shtëpi?
- Cili është dallimi në mes të jetës në ishull dhe jetës në qytet? A munden njerëzit me prejardhje të ndryshme të bashkëjetojnë si grup apo duhet të ndryshojnë për të shmangur konfliktet? **(Pika 1)**
- Dhe ti, (duke iu drejtuar secilit nxënës në klasë) a ke ndonjë veçori prej të cilës mund të

heqësh dorë? (Pika 2)

Në këtë pikë, fëmijët do të shkruajnë në ditarin e tyre përgjigjen, si bazë solide mbi të cilën ata mund të ndërtojnë identitetin e tyre.

- Çfarë do të mund ta mësoje shokun tuaj të klasës? (Pika 3) Secili adoleshent do të shkruaj gjithashtu përgjigjen e kësaj pyetje në fletore.

- A ke qenë ndonjëherë në një kontekst tërësisht të ndryshëm nga ai në të cilin jeton normalisht? Nëse po, si je sjellë? Çfarë lloj vështirësisë ke hasur dhe kush të ka ndihmuar apo mërzhitur? Paramendojeni veten në një shtet të huaj, shumë të ndryshëm nga i juaji: çfarë dëshironi të dini për të? Prej çfarë do të frikësoheshe? Kush do të bëhej shok i yti dhe kush jo? (Hapi 4) Nxënësit duhet të shkruajnë një punim të shkurtër në ditarin e tyre për këtë çështje.

Në fund të diskutimit, nxënësit me ndihmën e ditarëve të tyre dhe duke punuar në grupe do të bëjnë një përshkrim të “botës së klasës së tyre”:

- Klasa do të përfaqësojë botën e saj të identifikuar nga mbiemrat e përdorur në përgjigjet në ditar në hapin 2.

- Në “botën e klasës” do të përfshihen “miqtë” dhe “frikët” të cilat dalin nga pika 3 dhe 4.

- Secili “mbiemër që e identifikon një person” do të bashkohet, nëpërmjet një vektorit lidhës, me një tjetër, sipas veçorisë së vet: përzgjedhja e këtyre fjalëve e ka për qëllim të reagojë ndaj një “frike” të caktuar. Në këtë mënyrë, do të paraqitet një grup tjetër, i formuar nga individët të cilët, varësisht nga karakteristikat e tyre të ndryshme, do të ndihmojnë njëri tjetrin për tu marrë problemet e përditshme, duke e shndërruar diversitetin si mjet esencial për të arritur sukses. Disa “mbiemra” apo disa “frika” me siguri nuk do të kenë lidhje me elementët tjerë të këtij diagrami, duke përfaqësuar minoritetet tolerante.

Në fund, fëmijët do të mund të paramendonin fundit e tregimit, duke shpjeguar se çfarë ka ndodhur kur është kthyer Marku në shtëpi. A ka gjetur shokë të ri? A e ka ndryshuar atë ajo përvojë?

Në këtë moment, mësimitdhënësi do të shpjegojë kuptimin e nenit 12 dhe fëmijët do të mund të rishkruanin tregimin, duke i përdorë informatat e dhëna gjatë diskutimit.

Antonella Zapparrata
antonella230383z@yahoo.it

antonella230383z@yahoo.it



NJËSIA 42

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 12: Respekti për diversitetin kulturor dhe pluralizmin

Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre

Titulli

“Diversiteti kulturor është pasuri në jetën e secilit”

Objektivat e mësim nxënies

Njohja e konceptit të “pluralizmit kulturor” dhe çfarë pritet nga neni 12 i Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut.

- Rëndësia e diversitetit kulturor dhe pluralizmit
- Diversiteti, kur është pasuri nënkupton barazi
- Në shkollë askush nuk është i huaj

Rasti

Tregimi 1

Diversiteti është një nga vlerat themelore të shekullit tonë. Diversiteti nënkupton ngjyrë, kulturë, pasuri, këmbim, rritje: të gjithë këta elementë janë pjesë e historisë së secilit, por gjithashtu bëhet edhe histori e botës.

Iliasi është fëmijë me lëkurë me ngjyrë ulliri, flokë të zeza të dredhura dhe nuk veshë rroba të modës.

Ai ka lindur në Evropë dhe këtu ka filluar dhe ka vazhduar të shkojë në shkollë.

Familja e tij është e huaj. Nëna e tij nganjëherë punon si pastruese, babai i tij është punëtor dhe motra më e vogël e tij është studente.

Në familjen e tij të gjithë ata e flasin gjuhën amtare dhe i ndjekin traditat e veta.

Në shkollë nuk është pjesë e ndonjë grupi të veçantë të nxënësve, por nxënësit e klasës shpesh flasin me të edhe pse ata ankohen se i “vjen” era e ushqimit pasi që jeton brenda një qebaptoreje. Jashtë shkolle, Iliasi ka vetëm shokë që vijnë nga shteti i tij i origjinës.

Ai shihet si nxënës i “huaj”..., andaj mësimdhënësit përgatisin mësimet të thjeshtësuara për të, duke përdorë gjuhë të thjeshtë, duke i dhënë shpjegime shtesë, sepse ata frikësohen se ai nuk mund t’i ndjek mësimet si duhet, për shkak të kulturës dhe origjinës së ndryshme.

Nga një këndvështrim i caktuar, nxënësit tjerë të cilët më herët kanë pranuar mësimet të thjeshtësuara filluan të ankoheshin. Pse ky nxënës e meriton tërë vëmendjen? Ai ka lindur këtu, andaj duhet ta dijë gjuhën sikurse nxënësit tjerë! Pse ai nuk ka respekt për të tjerët dhe pse nuk vjen në shkollë i pastër dhe i veshur si duhet sikurse të gjithë të tjerët? Pse nganjëherë merr nota më të larta se sa i meriton? Pse nuk ka qëndruar në shtetin e vet, nëse vazhdon të

jetojë sikurse të ishte ende atje?

Mësimdhënësi e ndërpret tregimin dhe e sugjeron aktivitetin A të prezantuar në metodologjinë e mësimdhënies.

PJESA E DYTË

Mësimdhënësi, pas dëgjimit të kundërshtimeve të nxënësve shpjegon se Iliasi njëjtë sikurse djemtë dhe vajzat tjera jeton në mesin e dy kulturave të ndryshme; gjuhë e ndryshme, fe, traditë dhe i përmend si shembull gratë në shtetet tjera gatujnë ushqim shumë pikantë në mëngjes, për këtë arsye Iliasi vjen në shkollë me erë ushqimi, jo sepse ai nuk lahet, por se në familjen e tij ende e bëjnë këtë gjë. Shumë nxënës ende nuk janë të bindur dhe insistojnë se të gjithë duhet të jetojnë në shtetin e tyre të origjinës.

Mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse iu pëlqejnë qebapët apo roletë pranverore apo kuskusi kinez: këto janë të gjitha ushqime që vijnë nga shtetet tjera të cilët janë mësuar për të ngrënë dhe vlerësuar. Ai i pyet dy djem se pse veshin “kefiah” i cili është shall tradicional i Lindjes së Mesme të përdorur si mbrojtje nga era dhe rëra e shkretëtirës.

Nxënësit fillojnë të vështrojnë se ata kanë të veshur një rrobë arabe, derisa Iliasi ka të veshur rroba perëndimore dhe ata e mendojnë faktin se kur të shkojnë në drekë, Iliasi ha pica derisa të tjerët porosisin qebapë.

Mësimdhënësi e ndërpret tregimin dhe sugjeron aktivitetin B të prezantuar në metodologjinë e mësimdhënies.

Metodologjia e mësimdhënies

Këto pyetje duhet t’iu ndihmojnë nxënësve që të mendojnë për përmbajtjen e nenit 12 “Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre.”

Mësimdhënësi sugjeron aktivitetin B të prezantuar në metodën e mësimdhënies.

Aktiviteti A

Mësimdhënësi ia prezanton klasës pjesën e parë të tregimit. Ai e pyet secilin nxënës që të shprehë marrëveshjet apo mosmarrëveshjet për atë që e kanë thënë nxënësit e klasës së Iliasit:

- A është e drejtë që mësimdhënësit t’i kushtojnë vëmendje të veçantë Iliasit?

Iliasi ka lindur në këtë shtet, andaj ai duhet ta dijë gjuhën njëjtë sikurse nxënësit tjerë.

- A duhet ata të tolerojnë mungesën e respektit që e ka Iliasi ndaj nxënësve të klasës së tij kur ai vjen në shkollë me aromë të ushqimit?

- A është e drejtë që mësimdhënësit t’i japin nota më të larta se sa që ai e meriton? – Pse ai nuk ka qëndruar në shtetin e tij nëse vazhdon të jetojë sikur të ishte ende atje?

Në këtë mënyrë, mësimdhënësi mund të kuptojë nëse shumica e nxënësve pajtohen apo nuk pajtohen me nxënësit e shkollës së Iliasit.

Në këtë pjesë të aktivitetit, mësimdhënësit duhet të moderojnë diskutimin.

Aktiviteti B

Mësimdhënësi e prezanton pjesën e dytë të tregimit dhe i pyet nxënësit që të konfirmojnë apo të mos konfirmojnë atë që e kanë thënë gjatë aktivitetit A.

Pastaj, ai e pyet klasën, e ndanë në dy grupe në mënyrë që të japin mendimin e tyre për problemet e theksuara në pjesën e dytë të tregimit:

- Cilat lloje të traditave e dimë se iu përkasin kulturave të ndryshme?

- A ka disa pika të përbashkëta me traditat tona dhe të tjerave të shteteve të ndryshme?
- Cilat janë dinamikat dhe motivimet e flukseve migruese?
- A mund të matim nivelin e civilizimit të një kombi në bazë të asaj se si kulturat tjera pranohen në të?
- Çfarë nënkupton respekti i dinjitetit dhe i të drejtave të njeriut?
- Respekti dhe dinjiteti = liria?
- A mund që mundësia e kontaktit me një person tjetër nga një kulturë e ndryshme nga e jona të konsiderohet pasuri?

Në këtë fazë, mësimdhënësi nuk jep sugjerim të posaçëm, por ai e mbikëqyr diskutimin dhe punën. Pas këtij hapi, mësimdhënësi i thekson aspektet e mendimeve që janë shfaqur më së shumti gjatë këtij aktiviteti në klasë.

Në këtë moment, mësimdhënësi e shpjegon kuptimin e “diversitetit kulturor dhe pluralizmit” dhe e prezanton nenin 12 të Deklaratës Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut e cila thotë: “Duhet të ketë konsideratë të duhur për rëndësinë e diversitetit kulturor dhe pluralizmit. Megjithatë, konsiderata e tillë nuk duhet të shfaqet për të shkelur dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as për parimet e përcaktuara në këtë deklaratë dhe as për të kufizuar fushëveprimin e tyre.”

Ornella Salvetti
ornisal@libero.it



Deklarata Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005)

Parimi nr. 13
Solidariteti dhe Bashkëpunimi

Duhet të inkurajohet solidariteti ndërmjet qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për atë qëllim



NJËSIA 43

Grup mosha I: 3 - 5 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Duhet të inkurajohet solidariteti ndërmjet qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë për atë qëllim

Titulli

“Duaje vetveten”

Objektivat e mësim nxënies

Njësia e paradigmës së mësim nxënies për zhvillimin e harmonishëm dhe integrale të personit – identiteti:

- Krijimi i identitetit të vet
- Zbatimi i marrëdhënieve pozitive në mes të fëmijëve dhe në mes të fëmijëve dhe të rriturve.
- Të kuptuarit dhe reagimi i duhur ndaj pyetjeve që kanë të bëjnë me ndjenjat dhe emocionet e shprehura.
- Fitimi i shkathtësive në dëgjim dhe kuptimi i vetvetes dhe të tjerëve.
- Fitimi i shkathtësive të sjelljes pro sociale dhe sociale.

Rasti

Rosa dhe rosa

Një rikë humbi në fushë, dhe kërkon ndihmë nga kafshët mike të cilat i takon. Aty gjendet një mace të cilën ai e pyet:

- “A e di se ku është nëna ime?”

Macja përgjigjet: “Nuk e di se kush je, largohu!” Pastaj ai e takon një bretkosë:

- “Më ka humbur nëna, a e ke parë?”

Bretkosa përgjigjet: “Jam me nxitim, nuk kam kohë për të ndihmuar”.

Rika bëhet më e pikëlluar dhe dëshpëruar, por nuk dorëzohet.

- Ai e vazhdon kërkimin dhe e gjenë edhe një rikë të cilën e pyet: “Tung, kam humbur, a e ke parë nënën time??”

Rika përgjigjet: “Mos u brengos, eja dhe ta kërkojmë.”

Tregimi mund të vazhdojë duke takuar kafshë tjera të imagjinuara nga mësimdhënësi apo t’iu kërkojë fëmijëve që ata të përfundojnë tregimin.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

PO KËRKOJ NJERËZ, TË CILËT KËRKOJNË MIQ

- A duhet ta ndihmojmë rikën?
- Çfarë duhet të bëjnë kafshët të cilat i takon rika?
- Pse?
- Pyetni fëmijët 5 vjeçar se çfarë do të bënin në vend të rikës?
- Cila kafshë, në mesin e atyre që i ka takuar rika kishte sjellje të mirë?
- A është e drejtë t'i ndihmohet dikujt i cili ka telashe dhe t'ia mbash anën?

Historiku

Në një hapësirë të dedikuar për lexim, me një tepih, apo duke u ulur në rreth me fëmijët;

Grup i fëmijëve të moshave të ndryshme (3-5 vjet), ku fëmijët më të vjetër do t'i stimulonin më të rinjtë, të cilët do t'i dëgjojnë dhe imitojnë sjelljet e tyre.

Materialet

- përdorimi i figurave të krijuara për këtë qëllim nga i rrituri/mësimdhënësi, loja me kartën e “kujtesës” që përputhet me tregimin apo t'iu lejojë fëmijëve që të hulumtojnë zgjidhej të ndryshme për të përfunduar tregimin:
- fleta dhe ngjyra për të gjithë fëmijët për të përfaqësuar tregimin.

Aktivitetet

- Ndërtimi i dizajnit të skenës së bashku me fëmijët: sfondi i peizazhit, incizimi i tingujve/zërave që do të përfshihen derisa të tregohet apo aktrohet ngjarja;
- Pas kërkesës së mësimdhënësit, iu kërkohet fëmijëve të performojnë ngjarjen, duke e përzgjedhur rolin që do të dëshironin ta luanin;
- Të pyeten fëmijët që të luajnë karaktere të ndryshme dhe rolet e tyre.

Mjetet

1. Librat me fotografitë e kafshëve të përmendura në vjersha;
2. Imazhet multimediale;
3. Përdorimi i tingujve, muzikës, shprehjeve të fytyrës dhe duarve;
4. Prezantimi grafik i vjershave me përdorimin e fletave të madhësive të ndryshme, lapsave, markerëve të cilët do të ishin në dispozicion të fëmijëve.
5. Konet

Qasja e mësimdhënies është për të strukturuar përvojën në perspektivë socio-kulturore, me theks tek individët dhe ndërveprimin me të tjerët, dhe më në përgjithësi me kontekstin. Ne i analizojmë veprimet të lehtësuara nga mjetet dhe të zbatuara me qëllim të arritjes së synimit të theksueshëm dhe të përbashkët për tërë klasën. Në dimensionin socio-kulturor, mësimi nga natyra është aktivitet social: nuk ka mësim pa ndërveprim me një partner i cili na ndihmon të krijojmë njohuritë.

Lexim

Nga Princi i vogël ku në pyetjen e dhelpërës “çfarë po kërkon?” u përgjigj: “Po kërkojë njerëz, të cilët kërkojnë miq”, është nga bota e kafshëve, nga e cila shumë shkrimtar të letërsisë për fëmijë kanë marrë sinjalin që e arrin vlerën e miqësisë, solidaritetit, këmbimit dhe reflektimit. Vjershat, rimat, tregimet, asonancat onomatopeike, të cilat mund të përdoren për t'iu treguar fëmijëve se vlerat bioetike janë të pafund. Vetëm të kërkohet inspirimi nga natyra dhe kafshët të cilat përkujdesen për njëra tjetrën dhe të cilat madje nuk janë indiferente për problemet njerëzore mund të jetë e dobishme. Në natyrë mund të hasni ujë, kurthe dhe gracka, por në të njëjtën kohë kjo tregon se ekziston bota e solidaritetit, dhe solidariteti ekziston në shumë pjesë të tokës; propozimi për fëmijët i një përralle, vjershe për fëmijë, një rreth, një poezi mund të paraqet

bazën për të mësuar parimet e bioetikës dhe për të ndërtuar shpresë për të ardhmen. Por edhe në veçanti për fëmijët të cilëve iu mungon ushqimi, dhe të cilët ballafaqohen me situata të vështira në të cilat tingujt e ziles nuk e lajmërojnë arritjen e miqve, por fshehin rreziqet, veprimet të cilat ne i propozojmë në njësitë e mësimdhënies mund të ndihmojnë dhe përkrahin fëmijët e ditës së sotme në ndërtimin e një bote më të mirë për nesër.

Ndryshimet e shpejta në zhvillimet sociale, kulturore dhe teknologjike kanë ndryshuar në shtimin e formave të dhunës së hershme. Ky fenomen është i ndërlidhur ngushtë me humbjen e identitetit personal dhe në veçanti humbjen e vlerave morale tek shumë fëmijë, nganjëherë viktimë apo kryes të dhunës.

Mungesa e politikave, koordinimit në mes të institucioneve, strategjive, instrumenteve, vazhdimësisë edukative në mes të shkollës dhe shtëpisë, dhe në mesë të palëve të interesit të përfshira në zhvillim në edukimin e fëmijëve kanë shpie në rënien e vlerave morale dhe në rritje të dhunës. Shpesh të rriturit nuk kanë mundësi për të ndihmuar dhe drejtuar sjelljet e fëmijëve, për këtë arsye është e rëndësishme të strukturohen projekte edukative dhe njësi specifike të mësimdhënies në shërbimet edukative (0-3 vjet) në vazhdim me ato parashkollore (3-6 vjet).

Hartimi i një programi arsimor i cili këmbëngul në transmetimin e vlerave bioetike, respektin për të tjerët të ndryshëm nga vetvetja, shoqërinë, bashkëpunimin, këmbimin dhe reflektimin, solidaritetin në plan programin arsimor dhe udhëzimin në brezin shkollor 0-6 vjet, kërkon trajnimin e të rriturve të përfshirë në arsim për të transmetuar kulturën edukative nga fëmijëria e hershme, duke e respektuar parimin e shtimit të specifikimit, prejardhjen e nevojave dhe rrugët e mësim nxënies, dhe diversitetin e secilit fëmijë individualisht.

Antonella Migliore
antonella.migliore@icloud.it



NJËSIA 44

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Duhet të inkurajohet solidariteti ndërmjet qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë për atë qëllim

Titulli

“Vendi i ngjyrave”

Objektivat e mësim nxënies

- Të mësuarit dhe arsimimi i nxënësve për ngjyrat përfaqëson një burim të paçmueshëm nga i cili do të mund të merrnin edukatorët. Ato i përkasin botës e cila na rrethon: nëpërmjet tyre ne mund të shprehim emocionet tona dhe të krijojmë hapësirë për fantazitë tona.
- Për më tepër, ngjyrat mund të shndërrohen në simbol të besueshëm të solidaritetit dhe bashkëpunimit. Në të vërtetë, duke shpjeguar se çfarë janë ngjyrat primare, sekondare dhe terciare, ne lehtë mund të tregojmë se sa e rëndësishme është secila ngjyrë, jo vetëm vet duke qenë pjesë e natyrës, por në veçanti për të krijuar ngjyrat tjera me të gjitha nuancat e tyre të ndryshme. Bota nuk do të ishte aq e bukur dhe e llojllojshme nëse secila ngjyrë nuk do të mund të kombinohej me një tjetër, dhe në sasi më të madhe apo më të vogël krijojnë një spektër të madhe të tonalitetëve të ndryshme.
- Për më tepër, fenomeni i dritës dhe ylberit e fuqizojnë këtë koncept themelor: nga natyra ne mund të mësojmë se vetëm me kontributin e secilit dhe me bashkëpunimin e të gjithëve ne mund të krijojmë dritën e cila është burim qenësor i jetës. Solidariteti do të thotë të ndërtojmë së bashku, me vlerën e secilit, diçka më të fuqishme dhe më të rëndësishme si rezultat i vlerës së secilit.

SHEMBULLI nr. 1

Të mësuarit për të njohur ngjyrat sipas emrit të tyre, pranisë së tyre në natyrë dhe karakteristikave të tyre mund të shndërrohet në lojë argëtimi me plotë kuptim. Ne do të prezantojmë ngjyrat primare, sekondare dhe terciare duke iu falënderuar një shpjegimi të shkurtër, duke përdorur tabela me poster të cilët mund të ndërtohen me fëmijët. Sapo të përgatitet tabelat, do të mund t'i varnim në mur si memorandum për hapat vijues.

Pikturat temper janë të përkryera për këtë aktivitet, në veçanti sepse iu lejojnë fëmijëve që drejtpërdrejtë të shohin se si dy ngjyra e krijojnë një të tretë, dhe varësisht nga sasia e tyre, ne mund të fitojmë nuanca të ndryshme. Ne mund të organizojmë grupe pune të vogla që t'i mundësohet fëmijëve të eksperimentojnë, duke iu ndihmuar atyre të mbajnë në mend skema të ndryshme të ngjyrave derisa argëtohen. Ne mund të fillojmë nga bota që na rrethon, duke iu kërkuar fëmijëve të përshkruajnë se cilat “objekte” kanë ngjyrën e verdhë, të kuqe dhe kështu me radhë. Fëmijët dinë t'i vizatojnë dhe ngjyrosin ato përnjëherë. Përndryshe, ne mund të vizatojmë disa objekte dhe t'i ngjyrosim ato, duke përzgjedhur ngjyrat tona të preferuara. Gjëja më e rëndësishme është të theksohet rëndësia dhe bukuria e të gjitha ngjyrave, në veçanti kur të kombinohen, ato mund të krijojnë mjaft ngjyra tjera me nuancat e tyre, duke e bërë botën përreth nesh të bukur dhe të larmishme. Në mënyrë figurative kjo është si rezultat i solidaritetit dhe bashkëpunimit.

SHEMBULLI nr. 2

Sapo fëmijët të mësohen me ngjyrat primare, sekondare, terciare apo çfarëdo qoftë, ne do të

mund të fuqizonin konceptin e bashkëpunimit dhe solidaritetit duke e treguar një tregim/ngjarje të thjeshtë ndërveprues të quajtur “rrota magjike”. Na nevojitet një karton i gjerë për të krijuar një poster në të cilin do të vizatojmë një rreth sa vet posteri. Ky rreth do të ndahet në sektorë, dhe secili sektor do të plotësohet me një ngjyrë të ndryshme dhe nuancat e veta të shumëfishta (sipas diagramit të rrethit të ngjyrave të Isak Njutonit) nga fëmijët gjatë tregimit. “Na ishte njëherë një botë e bukur dhe me ngjyra saktësisht sikurse kjo e jona ...” tani do t’i pyesim fëmijët që të përzgjedhin një ngjyrë dhe të përshkruajnë se cilat objekte që na rrethojnë e kanë këtë ngjyrë. Sugjerimet dhe idetë janë gjithnjë të mirëseardhura. Disa fëmijë të grupit mund të “përfshijnë” ngjyrat për të cilat po flasim në sektorin e duhur, duke e përcjellë diagramin të cilin më herët është dashur që t’ua tregojë mësimdhënësi.

“Një ditë një magjistar vendosi t’i vjedhë të gjitha ngjyrat e botës. Kurdoherë që prekte diçka, ai objekt e humbte ngjyrën e vet, duke u bërë transparent. Lulet, frutat, lëndinat, lopët, qentë, macet, retë, zogjtë, detet dhe peshqit: të gjitha mbeten pa ngjyra, të pikëlluara dhe transparente me ecjen e magjistarit. Dukej të mos kishte zgjidhje për këtë fatkeqësi. Ngjyrat e dëshpëruara u afruan dhe u mblidhen së bashku. Por, sapo ato e krijuan një rreth, ato u ndjenë aq të fuqishme, të mençura dhe me plotë energji, duke filluar të rrotulloheshin çdo herë e më shpejtë. Ato u bënë më trimëresha, dhe duke u afruar më afër u shndërruan në rrotë magjike nga e cila një rreze e bardhë drite bëri që magjistari të humbë fuqinë e tij. Bota ishte e sigurt: bashkimi bënë fuqinë!”

Tani duhet të demonstrojmë atë që e kemi përshkruar në tregim: ne duhet të krijojmë rrotën magjike. Rrethi i madh i vizatuar në karton dhe i ngjyrosur në secilin sektor do të pritët. Pastaj ne do të bëjmë një vrimë në qendër, ku buceta e rrotës e lejon rrotën të sillet. Nëse e bëjmë rrotën e kartonit të lëvizë më shpejtë, ngjyrat e saj do të zhduken duke shfaqur një rreth të bardhë: së bashku do të fitojmë, do të jemi më të fuqishëm, më trima dhe do të përkrahim njëri tjetrin.

SHEMBULLI nr. 3

Ylberet gjithnjë e kanë pasur një rol të rëndësishëm në botën imagjinare të të rriturve dhe fëmijëve. Ky hark i bukur shumëngjyrësh është si urë në mes të botës reale dhe fantazisë sonë: duket të ketë diçka magjike. Ekzistojnë mjaft shumë legjenda, përralla, vjersha për fëmijë, këngë dhe poezi të cilat flasin për fenomenin natyror. Për shembull, ne mund të tregojmë një përrallë ku ngjyrat dhe stuhia do të jenë karakteret kryesore. Secili fëmijë do të luajë një pjesë të ngjyrave të ylberit dhe ai/ajo mund të veshë një maicë të asaj ngjyre përkatëse. Andaj, secila ngjyrë, secili fëmijë duhet të paraqesë cilësitë e saj dhe cilat objekte janë të ngjyrosura me të. Një fëmijë tjetër ose mësimdhënësi mund të luajë rolin e stuhisë e cila i bënë të gjitha ngjyrat të mbajnë duart, duke iu shpjeguar atyre se sa të bukura dhe se të rëndësishme janë, kur ata të gjithë janë së bashku e krijojnë një ylber, etj. Në fund, të gjithë do të mund të këndojnë një këngë apo të përsërisin një vjershë për fëmijë për ylberin. Ky do të jetë vetëm një sugjerim nga i cili do të mund të zhvillojë shumë lloje të temave.

Gjëja më e rëndësishme është sërish të theksohet se bashkëpunimi dhe solidariteti e përfaqësojnë përzgjedhjen themelore për të jetuar së bashku në harmoni, sikurse na tregon vet natyra.

Metodologjia e mësimdhënies

Ngjyrat, drita, ylberi: çfarë mund të jetë më e bukur dhe më e thjeshtë? Edhe një herë, Natyra na jep mundësinë të përfitojmë nga burime të pashtershme. Mësimdhënësi/edukatori nuk do të ketë mungesë të zgjidhjeve, duke i përdorur mjetet që i ka dhe ato që i shpikë për ta realizuar qëllimin e kësaj njësie. Në bazë të moshave të ndryshme dhe karakteristikave të grupit ju mund të zgjidhni aktivitete të dëgjimit, vizuale, të prekjes, varësisht nga predispozitat e ndryshme të fëmijëve.

Parimi i solidaritetit dhe bashkëpunimit duhet të fuqizohet nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë i ngjyrave, të fenomenit të dritës dhe ylberit, dhe duke e realizuar aktivitetin vetvetiu sepse kërkon kontributin e të gjithëve dhe bashkëpunimin në harmoni.

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com

NJËSIA 45

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“Siguria në rrugë”

Objektivat e mësim-nxënies

“Për t’i edukuar fëmijët që të bëhen qytetarë të mirë do të thotë në thelb për t’i mësuar ata se si të jetojnë në një komunitet të njerëzve të cilët janë ndryshe nga ti: ky është angazhimi i shkollës ... Sot, sfida është për ta gjetur rëndësinë e pakrahasueshme të shkollës me mënyrat tjera të mësuarit.” (intervista e Howard Gardner në “La Repubblica” gazetë italiane më 17.04.2004)

Ky lloj i aktivitetit në lidhje me rregullat në trafik ofron shumë mundësi për të trajtuar respektin dhe autonominë, ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

- Fëmijët do të jenë të angazhuar në aktivitete fizike dhe koordinuese që nxisin sjellje të civilizuar dhe të saktë, dhe përfundimisht të bëhen natyra e dytë e tyre.
- Nuk ka mënyrë më të mirë për t’i mësuar për rregullat e sigurisë në rrugë se sa duke i lënë fëmijët që të jenë akterë në një lojë, ku jeta e përditshme mund të aktërohet. Duke përdorur lojën e roleve për sensibilizimin e fëmijëve lidhur me sigurinë në rrugë dhe për t’i mësuar ata se si të bëhen qytetarë të mirë është një nga metodat më të mira për ta përqendruar vëmendjen e fëmijëve në këtë temë.
- Fëmijët, përderisa ndjejnë kënaqësi duke aktëruar, do të mësojnë për t’i kuptuar se si rregullat e mëposhtme do ta bëjnë të mundur që ata t’i mbrojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve. Në teori, ata do të jenë në gjendje t’i sensibilizojnë anëtarët e tjerë të familjes sa herë që ata vërejnë sjellje potencialisht të rrezikshme kur jashtë në rrugë, ose në një veturë, si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në këtë aktivitet të luajtjes së roleve.

Loja

HAPI I PARË

Mësimdhënësi duhet t’i përmbledhë vëzhgimet dhe sugjerimet e fëmijëve gjatë përshkrimit të “jetës së rrugës”: cilët janë të akterët e “trafikut rrugor”, (polici i trafikut, këmbësorët, vozitësit, motoçiklistët, etj.) dhe mjetet (semaforët, kalimet për këmbësorë, veturat, vend-parkingjet, etj.)? Pas kësaj, shenjat e trafikut thjeshtë paraqiten dhe shpjegohet përdorimi i tyre (duke filluar nga ato më të thjeshta që janë të njohura për fëmijët siç janë shenja e ndalimit, parkingu për makinat e personave me aftësi të kufizuara, e kështu me radhë), mësimdhënësi mund t’i prezantojë shenjat e reja dhe më të ndërlikuara të trafikut.

HAPI I DYTË

Tani ne kemi duhet t’i kuptojmë mjetet e dobishme të trafikut rrugor që do të përdoren për t’i njohur akterët e ndryshëm në trafikun rrugor. Ajo që ne kemi nevojë nuk është e kushtueshme dhe është e lehtë për ta gjetur, dhe mjetet janë të thjeshta dhe me ngjyra. Deri sa punojmë me

to, ne duhet t’jua përkujtojmë fëmijëve emrave e këtyre mjeteve dhe për çfarë shërbejnë. Çdo akter në trafik do ta ketë mjetin e vetë që e bën atë të dallueshëm. Për shembull, polici trafiku ka një kapelë me ngjyrë dhe një bilbil, ndihmës i tij ka një laps dhe një fletore për të shkruar gjoba, shoferët mbajnë rripa sigurie dhe e kanë timonin, motoçiklisti ka një helm të kartoni, këmbësorët mnajnë rripa të bardhë, si kalimi mbi zebër, dhe gjithmonë ecin së bashku dorë për dorë. Shenjat e rrugëve janë të “gjalla”: secili fëmijë ka një të tillë dhe luan këtë rol. Semaforët dhe kalimet për këmbësorë janë të “gjallë”, së bashku me opsionet e tyre karakteristike (gjelbër, portokalltë dhe të kuqe apo ec dhe mos ec).

HAPI I TRETË

Sa i përket organizimit të lojës, këshillohet që të ketë hapësirë të mjaftueshme, si për shembull, hapësirë e hapur (obbori i shkollës ku mund të përdorën shkumësa me ngjyrë për t’i shënuar vend-parkingjet dhe kalimet e këmbësorëve në tokë). Përndryshe, është e mundshme që kjo lojë të organizohet edhe në një hapësirë më të ngushtë siç është klasa, ku mund të përdorën qilima të ngjyrave të ndryshme si vend-parkingje apo kalimet e këmbësorve.

HAPI I KATËRT

Fëmijët ndahen në grupe të vogëla dhe ndërrohen gjatë lojës me role. Secili fëmijë fillon të luajë një rol i cili vendoset në mënyrë kolektive. Secili aktor i ka mjetet e tij/saj karakteristike.

HAPI I PESTË

Tani loja do të fillojë. Në fillim, mësimdhënësi duhet ngadalë ta drejtojë trafikun rrugor, duke i treguar secilit fëmijë lëvizjet e mundshme që ai mund t’i bëjë në përputhje me rolin e tij. Është më mirë që loja të fillojë me grupe të vogla të fëmijëve në mënyrë që të kemi kontroll më rrjedhën e trafikur rrugor. Në çdo shkelje të rregullave të trafikut, loja ndalet dhe mësimdhënësi shpjegon se çfarë gabimi ishte kryer çfarë ndikimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të ketë (për shembull, tejkalimi i shpejtësisë së lejuar apo vozitja nëpër dritën e kuqe të semaforit). Me kohë fëmijët do të njoftohen me lojën, duke u ndjerë të lirë të luajnë vetvetiu dhe më shpejtë. Pas një trajnimi përkatës, udhëzimet e mësimdhënësit më nuk do të jenë të nevojshme, dhe trafiku rrugor do të rrjedhë në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me rregullat e trafikut. Autonomia dhe përgjegjësia individuale janë thelbësore në sigurinë në trafik, dhe jo vetëm kaq. Aftësia për të kuptuar se vendimet tona do të kenë ndikim për ne dhe për të tjerët do të qartësohet gjatë lojës. Ne do t’i shohim drejtpërdrejtë pasojat e veprimeve tona: nëse ne lëvizim shumë shpejt, ne rrezikojmë jetën tonë; nëse e kalojmë rrugën në dritë të kuqe, ne mund të na shkelë ndonjë veturë. Çdo vendim i ka efektet e veta të drejtpërdrejta, jo vetëm për jetën tonë, por edhe për jetën e fqinjëve tanë. Ne vërtetë jemi personalisht përgjegjës për veten tonë dhe për të tjerët. Çfarë bëjmë ne ka një efekt domino. Kjo duhet të mbahet në mend kur i marrin vendimet tona: prej më të thjeshtave deri tek vendimet më të vështira. Nëpërmjet kësaj loje, ne do të jetë në gjendje ta kuptojnë qartë rëndësinë e përgjegjësisë individuale.

Metodologjia e mësimdhënies

Projekti “Siguria në rrugë”, duhet t’u prezantohet fëmijëve. Duke filluar nga ajo që fëmijët dinë për trafikun rrugor, personat që janë të përfshirë, dhe mjetet që ata i përdorin, ne duhet t’i mbledhim vëzhgimet dhe sugjerimet e tyre në përshkrimin e “jetës në rrugë”.

Pas kësaj, rregullat themelore të trafikut duhet të shpjegohen në mënyrë të thjeshtë, duke paraqitur mjetet që aplikohen. Edhe gjatë krijimit të këtyre instrumenteve, ne duhet ta stimulojmë kureshtjen e fëmijëve, duke i lënë që të mendojnë për: Për çfarë shërbejnë semaforët? Si punojnë ata? Ose për çfarë shërbejnë rripat e sigurisë? Duke e realizuar këtë “lojë” fëmijët drejtpërdrejtë mund ta paramendojnë se për çfarë shërbejnë rregullat dhe si mund të përdorën dhe nga kush. Vetë fëmijët do të vetëdijësohen shpejtë, përmes përvojave


të tyre direkte, sa sa e rëndësishme është të respektohen të drejtat/detyrat e një qytetari të mirë, sipas roleve të ndryshme që janë luajtur (polic trafiku, shoferi, këmbësori, etj.). Për më tepër, do të jetë e rëndësishme të kuptohet rëndësia e gjobave në përmirësimin e sjelljeve të gabuara dhe shpesh të dëmshme për të dhe për të tjerët (tejkalimi i shpejtësisë së lejuar, mos parkimi në vend-parkingje për personat me aftësi të kufizuara, e kështu me radhë). Ky aktivitet është mjaft i thjeshtë për ta aplikuar kudo në botë: në fakt, rregullat e sigurisë në trafik janë identike në tërë botën, përveç disa ndryshimeve të vogëla (shih Mbretërinë e Bashkuar).

Materialet:

- karton, letër, ngjyra, kashtë plastike, ngjitës, ngjitës plastik dhe gërrshërë (për të vizatuar, ngjyrosur dhe prerë kapelën e policit të trafikut dhe fletoren për t'i shkruar gjobat, rripat e sigurisë, timonin, semaforët me tri ngjyra, kalimin për këmbësorë me dy opsione, shenjat e trafikut, etj.):
- një bilbil, një bori, shkumsa me ngjyra (për t'i vizatuar, nëse është e mundur, kalimin zebër dhe vend-parkingjet).

Për këtë aktivitet duhet të keni hapësirë të mjaftueshme, mundësisht hapësirë të hapur (kjo varet se sa fëmijë janë duke luajtur së bashku në të njëjtën kohë). Është e mundur që të luhet edhe brenda në klasë (qilimat mund të përdoren si vend-parkingje apo kalim këmbësorësh) ose në oborr të shkollës (ku mund të përdoren shkumsat me ngjyrë për t'i shënuar vend-parkingjet apo kalimet e këmbësorëve në tokë).

Alessandra Pentone
alesspent@hotmail.com



NJËSIA 46

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“Të gjithë jemi Ditta”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e vuajtjes dhe vetmisë në botë, dhe të dijnë se këto ndjenja kanë të bëjnë me të rriturit dhe me fëmijët. Ndjenja e empatisë për në këto situata duhet të inkurajohet dhe të zhvillohet.

Rasti

Ditta, shoqja ime më e mirë, nuk erdhi sot në shkollë. Ajo kishte munguar edhe dje dhe një ditë më parë. Nëna e Dittas i tha Linnes, mësimdhënëses sonë, se Ditta është shumë e sëmurë dhe ka nevojë për trajtim mjekësor. Pas një muaji të tërë, Ditta u kthye në klasë, por ajo nuk dukej si dikur. Ajo ishte shumë e zbehtë, e qetë dhe e pikëlluar. Koka e saj ishte e mbuluar me një shami. “A ke të ftohtë?” e pyeti Dani. “Jo”, pëshpëriti ajo. “A e ke lënduar kokën?” pyeti Roni. “Jo”, tha ajo. “Mos i bëni pyetje!” urdhëroi Linna, mësimdhënësjë jonë. “Ditta ka qenë shumë e sëmurë dhe flokët e saj të bukur kanë humbur, por flokët do t’i dalin prap. Ajo është e hutuar dhe në siklet”.

Disa fëmijë qeshnin dhe kërkuan nga Ditta që t’jua kokën e saj tullace. Debby, vajza më e vogël në klasën tonë, iu afrua Dittas dhe i tha me zë të butë, “Mos u mërzit, Ditta, flokët do të rriten përsëri shumë shpejt dhe do të jenë më të bukura se kurrë”. Ajo i mbledhi shumë fëmijë jashtë klasës dhe u tha në mënyrë të vendosur: “Nesër, të gjithë ne do të vijmë në klasë me shamia në kokë, ndërsa djemtë do të vejnë kapela. Të gjithë ne do të jemi si Ditta. Ne nuk do të lejojmë që Ditta të ndjehet ndryshe. Ne do të vejmë shamia dhe kapele deri sa flokët e saj të rriten përsëri”. Të nesërmen dhe gjatë tërë muajit që pasoi, të gjithë ne erdhëm në klasë me shamia dhe kapele. Linna i zbukuroi ato me lule dhe me pupla ngjyra-ngjyra. Flokët e Dittas u rrit përsëri ngadalë, kështu që ajo e hoqi shaminë e saj. Ajo ditë ishte një ditë e madhe për të gjithë ne. Ditta ishte shumë e lumtur, nëna dhe babai i Dittas solli një tortë të madhe ku kishin shkruar “Shoqëria - mbi të gjitha”.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta fillojë diskutimin duke paraqitur pyetje të tilla si në vijim:

- Çfarë ka ndodhur me flokët e Ditta-së? Pse?
- Pse ishte Ditta e pakënaqur? E pikëlluar?
- Pse disa fëmijë qeshën me të?
- Çfarë i shtyu fëmijët ta ndryshojnë sjelljen?
- Si ndjehej Ditta në fillim dhe si në fund të tregimit?

Solidaritet do të thotë të ndjesh.. të ndjesh për ne ... të shprehësh empati.

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 47

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“Bashkëpunimi”

Objektivat e mësim-nxënies

- Heqja dorë nga opinionet individuale për të mirën e grupit.
- Aplikimi i një mendësie bashkëpunuese.
- Zhvillimi i kohezionit dhe koncepti i punës së përbashkët.
- Të mësuarit për të jetuar së bashku.
- Koordinimi i lëvizjeve dhe ekuilibri.
- Zhvillimi i shkathtësive për reagim.
- Forcimi vëmendjes.

Loja

“Maca magjike”

VENDI: palestra apo hapësirë e hapur

STRUKTURA: nxënësit që aktrojnë minjtë vendosen në një rresht, përballë nxënësit që aktron macen, i cili qëndron 5 m larg tyre.

Minjtë janë të rreshtuar në një anë të fushës, ndërsa macja është e vendosur në anën tjetër të fushës, dhe thotë: “Minjtë hyjnë në mbretërinë time” dhe vrapon drejt tyre për t’i kapur. Minjtë duhet të ikin nga macja në anën e kundërt të fushës. Kur macja e zë një mi, atëherë miu bëhet kurth për minj. Kurthet për minj nuk mund të lëvizin, ata qëndrojnë aty ku janë, duke u përpjekur që t’i zëjnë minjtë tjerë që kalojnë pranë duke përdorur vetëm duart e tyre. Sa herë që kapet një mi, miu kurth kthehet në drejtim të pjesës së fushës ku vrapojnë minjtë tjerë. Mi u që mbetet i fundit bëhet mace e re.

Pyetjet e mëposhtme ndihmojnë për t’i shprehur përvojat emocionale, vëzhgimet e fëmijëve (ndaj njërit dhe ndaj të tjerëve) në lidhje me atë që ka ndodhur në lojë:

- A ju ka pëlqyer loja?
- A ka pasur momente ku ju keni hasur në vështirësi?
- A mendoni si ju kanë ndihmuar edhe të tjerët? E ju, a e keni ndihmuar?

Dilema

- A është e drejtë të bashkëpunosh me të tjerët për të arritur një qëllim të përbashkët?
- Kur qëllimi është i përbashkët, nëse vetëm një person në grup e arrinë këtë qëllim, a dominon ndjenja sikur të gjithë në grup e kanë arritur atë qëllim?

- A na bënë të ndjehemi më të sigurt dhe më të relaksuar në jetë ndjenja se mund të llogarisim në njerëz tjerë?
- A mund të ndjehen të gjithë si elemente të rëndësishëm nëse të gjithë janë pjesë e grupit?
- A mund veprimet e çdo personi të ndikojnë në jetën e njerëzve tjerë?

Donatella Borney
d.borney@mail.scuole.vda.it



NJËSIA 48

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“Solidariteti dhe bashkëpunimi”

Objektivat e mësim-nxënies

- Njohja e Neni 13 të Deklaratës Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut.
- Njohja me kuptimin e solidaritetit dhe bashkëpunimit.
- Vetëdijesimi se çdo individ duhet të jetë mbështetës dhe duhet të di se si të bashkëpunojë me të tjerët.

Rasti

Charles, George, Elizabeth dhe Henry jetojnë në të njëjtin fshat, që është disa milje larg nga shkolla e tyre, dhe vijnë në të njëjtën klasë. Një ditë, Charles duke bërë çiklizëm, lëndohet keq dhe e thyen këmbën. Pas operacionit, ai është i detyruar të qëndrojë në shtëpi një kohë të gjatë për t’u shëruar. Mësimdhënësit e tij, të shqetësuar se Charles mund të mbetet shumë me mësim, kërkojnë nga George, Elizabeth dhe Henry, jo vetëm që t’ia dërgojnë Charles-it detyrat e shtëpisë, por edhe t’ia shpjegojnë atij temat që i kanë mësuar në klasë.

Reagimet e tre fëmijëve ndaj kërkesës së mësimdhënësve janë të ndryshme. George thotë se ai nuk do ta ndihmojë Charles-in sepse, në një situatë të ngjashme, ai nuk e kishte ndihmuar një shok klase. Ai e arsyetoi qëndrimin e tij duke thënë se ky nuk është një sulm personal, por një mënyrë për ta shtyrë atë ta kuptojë sjelljen e tij të keqe në të kaluarën. Në thelb, ai dëshiron që t’ia jep atij një leksion për jetën. Henry tha se pajtohet që Charles ka nevojë për ndihmë, por shtoi se as ai dhe as Elizabeth nuk do të jenë në gjendje ta përsërisin njësinë mësimore nga matematika, fjalë për fjalë, për të. Për ta bërë këtë, disa nxënës tjerë nga qyteti do të duhej të përfshihen, tha Charles-i, megjithatë, ai nuk ishte i mendimit që t’i përfshijë njerëzit tjerë dhe t’i lus që të bashkëpunojnë duke e shpenzuar kohën e tyre në një detyrë të tillë.

Elizabeth pohoi se ajo nuk ndjehej e aftë për t’i ndihmuar Charles-it në lëndën e matematikës, mirëpo tha se është e domosdoshme që të ndërmerren hapa për t’i ndihmuar atij, edhe nëse kjo nënkupton përfshirjen e njerëzve tjerë. Ajo është e sigurt se, duke vepruar kështu, Charles-i do ta ketë mundësinë ta kuptojë rëndësinë për t’u ndihmuar të tjerëve në rast nevojë.

Sipas mendimit tuaj, cili do të ishte qëndrimi më i duhur? A keni ndonjë zgjidhje tjetër për të propozuar?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi ia paraqet rastin klasës. Ai/ajo formon grupe të vogla prej tre ose katër nxënësve, dhe i fton ata për të reflektuar për çdo qëndrim që tri personazhet e tregimit e kanë shprehur, dhe në veçanti, të kërkoj prej tyre t’i identifikojnë aspektet e mundshme negative apo pozitive,

të cilat do të paraqiten në tabelë për çdo zgjidhje të propozuar.

Duke pasur parasysh se cili do të jetë rezultati, çdo nxënës ftohet ta thotë se cila sjellje, sipas tyre, është më e mira. Kështu, qartësohet mendimi i shumicës.

Në këtë fazë, mësimitdhënësi nuk i jep sugjerime konkrete, por thjesht e moderon diskutimin, e pastaj e shpjegon kuptimin e “solidaritetit” dhe “bashkëpunimit”, fjalë që shfaqen në Nenin 13 të Deklaratës Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut që thotë:

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Në dritën e njohurive të reja, mësimitdhënësi e pyet klasën të mendojnë për zgjidhjet që i kanë bërë më parë dhe t’i ndryshojnë ato, nëse e shohin të nevojshme. Në këtë fazë, mësimitdhënësi e drejton diskutimin dhe thekson se ky tregim ka të bëjë me solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet individëve, por i njëjti parim duhet gjithmonë të zbatohet edhe ndërmjet komuniteteve dhe popujve. Për ta bërë këtë koncept edhe më të qartë, paraqiten edhe disa shembuj konkretë.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 49

Grup mosha II: 6 – 10 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“A e ka marrë ai vendimin e duhur?”

Objektivat e mësim-nxënies

- Njohja me nenin 13 të Deklaratës Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut.
- Të kuptuarit e solidaritetit dhe bashkëpunimit.
- Njohja me faktin se çdo individ duhet të jetë përkrahës dhe duhet të dijë si të bashkëpunojë me të tjerët.

Rasti

Mësimdhënësi i matematikës u jep detyra të klasës nxënësve të tij/saj. Giovanni, një nxënës shumë i zellshëm, kalon nëpër atë në mënyrë të përsosur dhe me shpejtësi. Shoku i tij i bankës Angelo, i cili gjatë mësimit nuk dëgjon asnjëherë, pengon orën mësimore dhe nuk mëson, i cili nuk është në gjendje ta kryejë atë, kërkon nga Giovanni të ia jap atij testin. Ngjashëm, Luigi i cili përballet me vështirësi dhe që nuk është i aftë për ta bërë këtë punë po ashtu, kërkon ndihmë.

Giovanni, pavarësisht nga këmbëngulja e dy shokëve të tij të klasës, vendos të mos plotësojë kërkesat e tyre. Në fund të mësimit, posa dalin nga shkolla, Giovanni kritikohet nga shokët e tij për vendimin e tij dhe akuzohet se nuk është mbështetës apo bashkëpunuese.

Ai kritikohet veçanërisht se nuk ndihmon Luigin, vështirësitë e të cilit dihen mirë. Giovanni mbron të drejtën e tij për të marrë vendime autonome dhe pohon se sjellja e tij nuk zbulon mungesën e solidaritetit apo bashkëpunimit sepse Angelo do të mund ta kryente testin vet nëse ai do të kishte mësuar mjaftueshëm.

Sa i përket Luigit, edhe pse i di vështirësitë e tij, Giovanni thotë se dhënia e testit atij nuk do të zgjidhte problemet e të mësuarit që ai ka. Giovanni shton se vetëm Mësimdhënësi mund të ndihmojë Luigin duke i dhënë detyra më të lehta që ai mund të kryejë duke pasur parasysh aftësitë e tij.

A mendoni se sjellja e Giovanni ishte krejtësisht e duhur dhe arsyet e tij korrekte?
A pajtoheni vetëm me disa aspekte të qëndrimit të Giovanni dhe jo me të tjerët? Nëse është kështu, cilat dhe pse?

A mendoni se sjellja e Giovanni nuk ishte e drejtë dhe se ai ka dëshmuar se nuk është mbështetës apo bashkëpunuese ndaj Angelos dhe Luigit? Shpjegoni zgjedhjen tuaj.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi prezanton rastin para klasës. Ai/ajo shkruan tri përgjigje në tabelë dhe kërkon nga secili fëmijë të zgjedhin njëren që ata mendojnë të jetë më e mira dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Në këtë fazë, Mësimdhënësi nuk jep sugjerime konkrete. Ai/ajo pastaj krijon një “hartë” të mendimeve të klasës lidhur me rastin e zgjedhur.

Në këtë pikë, Mësimdhënësi shpjegon kuptimin e “solidaritetit” dhe “bashkëpunimit”, fjalët që paraqiten në nenin 13 të Deklaratës Universale për Bioetikë dhe të Drejtat e Njeriut ku thuhet: Solidariteti ndërmjet qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar drejt atij synimi duhet të inkurajohen.

Në dritën e njohurive të reja, ai/ajo kërkon nga secili fëmijë ose të konfirmojë ose të ndryshojë mendimin e tij të shprehur më parë, duke marrë kështu një hartë të dytë të mendimit të klasës për rastin e studiuar. Në këtë pikë, Mësimdhënësi krahason dy hartat duke nënvizuar ndonjë dallim të mundshëm. Ai/ajo shpjegon se si solidariteti dhe bashkëpunimi me të vërtet nuk kanë munguar në tregimin e paraqitur dhe jep disa shembuj praktik të solidaritetit të vërtetë mes individëve duke nënvizuar rëndësinë që një qëndrim i tillë duhet të ketë në jetën e secilit. Ai/ajo përfundon duke kërkuar vëmendjen e nxënësve për faktin se solidariteti dhe bashkëpunimi jo vetëm që duhet të ekzistojë midis individëve, por edhe në komunitete dhe popullata të ndryshme.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 50

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 13: Solidariteti dhe bashkëpunimi

Solidariteti në mes të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për këtë qëllim duhet të inkurajohen.

Titulli

“Tregimi i myslimanëve që shpëtuan hebrenjtë”

Objektivat e mësim-nxënies

Tregimi në vijim nga holokausti tregon se nuk ka armiqësi të thellë midis myslimanëve dhe hebrenjve kur kthehemi mijëra vite më parë, një urrejtje që bën konfliktin të pashmangshëm. Njerëzit të cilët kanë mbështetur nazistët (si myftiu i madh i Jerusalemit) ose ata që janë përfshirë në hasmëritë e antisemitizmit në Irak nuk kanë bërë këtë për shkak të urrejtjes së gjatë fetare, por për shkak të rivaliteteve politike moderne.

Pra, objektivat mësimore për këtë rast janë:

- Të tregohet se cilat dhe sa shumë aspekte të traditave myslimane favorizojnë tolerancën dhe bashkëjetesën
- Gjenocidet nuk janë të paevitueshëm apo të pandalshëm.
- Të shihen individët të cilët kanë bërë një ndryshim që tregon saktësisht se individët mund të bëjnë dallimin.
- Kuptimi i solidaritetit.

Rasti

Në Bosnje, kanë qenë tri grupe të mëdha “kombëtare” (përcaktuar për nga feja pasi që të gjithë ata flisnin të njëjtën gjuhë dhe kanë jetuar në të njëjtin vend): Serbët (ortodoks), kroatët (katolikë), dhe myslimanët. Hebrenjtë ishin një grup më i vogël (40,000 në Bosnjë dhe Kroaci bashkë; rreth 11,000 vetëm në Bosnje), por ata gjithashtu konsideroheshin si një komunitet i ndryshëm kombëtar. Pas pushtimit gjerman të Jugosllavisë në vitin 1941, Bosnja dhe Kroacia u bashkuan për të formuar një “shtet të pavarur të Kroacisë.” Fashistët kroatë (ustashët) udhëhoqën por myslimanët boshnjakë u shpallën gjithashtu “arianë.” Armiqtë kryesorë të kroatëve ishin serbët (dhe nëse gjermanët u bënë nën presion të mjaftueshëm atyre, hebrenjtë ishin të dytët), kështu që ishte një sundim brutal terrori me kampe të tmerrshme të përqendrimit për serbët, çifutët, romët, dhe të burgosur politikë, të cilët protestuan kundër regjimit.

Myslimanët boshnjakë formuan një pjesë të rëndësishme të një force rezistence shumë-etnike kundër nazistëve që shpëtuan shumë çifutë, disa histori po ashtu tregojnë rrëfime për trimëri të vërtetë. Hebrenjtë jetonin dhe kishin lulëzuar në Sarajevë që prej shekullit të gjashtëmbëdhjetë, por kur Lufta e Dytë Botërore shpërtheu gjërat morën një kthesë tragjike. Qyteti ishte bombarduar nga gjermanët në vitin 1942 dhe shtëpia e Josef Kavilio, një burrë çifut, u shkatërrua gjatë sulmit. Ai u kap nga ustashët, një lëvizje separatiste kroate ideologjia e së cilës ishte një përzierje e fashizmit dhe nazizmit. Ai u bashkua me të burgosurit e tjerë, u prangos në një të këmbëve, për të pastruar rrugët nga reshjet e mëdha të borës që do të shpinte ata tek tmerret e Jasenovacit, një kamp masiv i përqendrimit i shpërndarë në nëntëdhjetë e tri milje katrorë. Zejneba, gruaja e mikut mysliman

të Josefit, Mustafa Hardagës, hasi në vendngjarje, nën lot, dhe u kthye për të sjellë ushqim për të gjithë të burgosurit. Josefi ia doli të shpëtojë. I dobët dhe i paushqyer, ai kërkoi strehim tek Hardagët ku u kujdesën për të dhe iu kthye shëndeti. Hardagët nuk përfillën paralajmërimet e ngjitura në mure të selisë së Gestapos, të cilat ishin afër dhe me rrezik, pasi që oficerët kërcënuan të vrasin ata që do të mbronin hebrenjtë. Josef kishte frikë për mbrojtësit e tij dhe iku në Mostar. Pas luftës, ai mësoi se babai i Zejnebas ishte transportuar në kampin e përqendrimit të Jasenovacit për shpëtimin e një familjeje hebraike. Kishte po ashtu të tillë që kanë mbrojtur trashëgiminë kulturore të popullit hebre. Dervish Korkut ishte krye-bibliotekar i Muzeut Kombëtar Boshnjak. Ai ka shpëtuar një dorëshkrim të çmuar mesjetar hebraik, Haggadah, nga duart e nazistëve, të cilët dëshironin të “spastronin” Bosnjen jo vetëm nga jeta hebraike por edhe nga historia e tyre. Haggadah, hebre për të ‘treguar’, përfshinte tregimin e ilustruar të Pashkëve çifute, dhe ishte një nga Haggadahët më të vjetër në botë. Korkut e ka fshehur librin në xhaketën e tij kur nazistët erdhën për ta kërkuar atë, ai e ka kontrabanduar atë jashtë Sarajevës dhe e ka vendosur atë në kujdesin e një imami mysliman në Zenicë, i cili e fshehu dorëshkrimin e shekulli të katërmëdhjetë nën dërrasat e dyshemesë së një xhamie. Haggadahu i mbijetoi luftës dhe u kthye në Muzeun Kombëtar të Bosnjës.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Solidariteti bazohet në kombinimin e ndjenjave, qëllimeve, përgjegjësi dhe/ose interesave, ku në frymën e bashkëpunimit, njerëzit shqetësohen për ata që janë me më pak fat apo të pambrojtur dhe përpiqen për barazi dhe drejtësi për të gjithë.

A duhet të zbatojmë këtë parim në jetën e përditshme? A do të mund të jetë një mënyrë për të mbrojtur dhe shpëtuar njerëzimin nga luftërat dhe çdo lloj dhune dhe persekutimi?

Duke filluar nga historia e Josef Kavilio, Mësimdhënësi do të prezantojë temën e myslimanëve që shpëtuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore; atëherë nxënësit do të ftohen të shikojnë një video interesante lidhur me temën (*sugjerim: <https://www.youtube.com/watch?v=2MdxW6SnVNI>*), (burim pa pagesë)

U kërkoni nxënësve të shkruajnë një tregim të shkurtër për atë që ata e kanë kuptuar, atëherë ata do të ftohen për të treguar një histori të ngjashme që ata mund të dinë të cilat janë simbolikë e parimit të “solidaritetit dhe bashkëpunimit”.

Në fund nxënësit duhet të shkruajnë dy lista; e para duhet të përmbajë disa fjalë të cilat kanë një kuptim të ngjashëm me atë të solidaritetit, e dyta do të përfshijë fjalët në kundërshtim me të parën *p.sh.: bashkëpunues/pengues; vetëmohim/egoizëm; tolerancë/paragjykim* dhe kështu me radhë... Qëllimi i këtij aktiviteti është të tregojë se sa të rëndësishme janë fjalët dhe çka mund të paraqesin ato

në nxjerrjen e kornizave konceptuale; çdo student duhet të pyesë veten në një situatë të caktuar nëse ata janë duke vepruar në mënyrë bashkëpunuese dhe mbështetës apo jo.

Për lexim

http://www.yadvashem.org/yv/en/righteous/stories/related/kavilo_testimony.asp

<http://en.qantara.de/content/muslims-who-saved-jews-during-world-war-ii-the-forgotten-schindlersp://>

www.pbs.org/newshour/bb/social_issues-jan-june10-righteous_04-05/

<http://www.bbc.com/news/uk-england-london-22176928>

<http://www.jta.org/2010/07/21/life-religion/with-an-eye-toward-cooperation-recalling-the-holocaust-heroism-of-muslims>

<http://discover-the-truth.com/tag/josef-kavilio/>

Daniela Caruso

daniela.caruso@unipegaso.it

Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 16

Mbrojtja e gjeneratave të ardhshme

Ndikimit të shkencave të jetës në gjeneratat e ardhshme, duke përfshirë edhe ndikimin në përbërjen e tyre gjenetike, duhet t'i jepet vëmendje e duhur.



NJËSIA 51

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 16: Mbrojtja e gjeneratave të ardhshme

Ndikimit të shkencave të jetës në gjeneratat e ardhshme, duke përfshirë edhe ndikimin në përbërjen e tyre gjenetike, duhet t'i jepet vëmendje e duhur.

Titulli

“A mundet një zbulim shkencor me të vërtetë të zgjidhë një problem të madh që prekë njerëzimin?”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të njihet përmbajtja e nenit 5 e Deklaratës Universale për bioetikën dhe të drejtat e njeriut
- të vetëdijesohemi se:
 - a) përparimi i njohurive shkencore ndikon drejtpërdrejt në jetën e njerëzve dhe, për rrjedhojë, edhe për brezat e ardhshëm.
 - b) është e rëndësishme që të ndjekim me vëmendjen e duhur ndikimin e mundur negativ që një përparim i tillë mund të ketë tek njerëzimi.

Rasti

Është viti 2080. Një botë tërësisht e automatizuar kërkon një sasi të madhe të energjisë për të funksionuar, por nga ana tjetër, burimet jo të ripërtëritshme të energjisë (thëngjilli, nafta, gazi) do të harxhohen dhe ato të ripërtëritshme nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e planetit. Energjia bërthamore është ndaluar në çdo vend, për shkak të shumë aksidenteve katastrofale që kishte shkaktuar. Të gjitha qeveritë janë shumë të shqetësuara. Mungesa e tillë e energjisë do të kthente njerëzimin prapa te epoka e gurit. Një zbulim i madh shkencor mund të jetë në gjendje të zgjidhë problemin: është një proces që përfshinë një transformim të shpejtë të drurëve në qymyr, në mënyrë që të përfitohet karburant i efikasitetit të lartë për prodhimin e nxehtësisë. Për fat të keq, prodhimi i një karburanti të tillë kërkon një sasi të madhe druri dhe në disa dekada planeti do të përfundonte pa vegetacion, madje edhe me mbëltrimin sistematik të pemëve për të zëvendësuar ato të prerat dhe kjo do të ishte një problem i tmerrshëm për brezat e ardhshëm. Kjo çështje pashmangshëm hapë një debat serioz jo vetëm mes qeverive të ndryshme, por edhe në opinionin publik universal. Pyetja është: “A është e drejtë të zgjidhet një problem aktual në dëm të brezave të ardhshëm?”.

Mendimet e ndryshme të shprehura janë padyshim, shumë të ndryshëm dhe kundërshtues:

- Disa njerëz mendojnë se është e drejtë sepse ata besojnë se është e rëndësishme të zgjidhen problemet aktuale të qenieve njerëzore që jetojnë: çdo qytetërim që i përket një periudhe të ndryshme historike duhet të zgjidhë problemet e veta.
- Dikush pajtohet që motivimi i zgjedhjes së tij/saj me idenë se përparimi shkencor mund t'i zgjidhë, në të ardhmen, një gjendje negative të shkaktuar nga një mjet i nevojshëm i tanishëm.
- Disa njerëz të tjerë mendojnë se nuk është e drejtë që të zgjidhen problemet aktuale në dëm të atyre që do të vijnë më pas.
- Dikush ka një mendim madje edhe më pak fleksibil sesa ai i mëparshmi, duke thënë se kërkimet shkencore që mund të çojnë në zbulime të dëmshme as që duhet të bëhen dhe

rezultatet e tyre duhet të censurohen gjithsesi.

Cili është pikë-vështrimi yt?

A ndani ndonjë nga pikëpamjet e përmendura më sipër ose a mund të jepni një tjetër mendim?

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi prezanton rastin para klasës. Me qëllim që të lehtësojë debatin, ai ndan dy grupe dhe i fton ata që të reflektojnë në atë se cilat zgjidhje mund të jenë më të përshtatshmet nga pikëpamja etike.

Në këtë fazë Mësimdhënësi nuk jep ndonjë këshillë konkrete, dhe thjesht lehtëson bisedën. Pas zgjedhjes (me siguri nga shumica) zgjidhjen që konsiderohet si më e mira duke pasur parasysh rrethanat, secili grup i prezanton atë grupit tjetër. Në fund të prezantimit, nëse të dy palët kanë propozuar zgjidhje të ndryshme, secili nxënës i një grupi jep mendimin e tij/saj personal për zgjedhjen që ka bërë nga grupi tjetër.

Në këtë pikë, Mësimdhënësi prezanton nenin 16 të Deklaratës Universale për bioetikë dhe të drejtat e njeriut, ku thuhet:

“Është e rëndësishme që të ndjekim me mjaft kujdes ndikimin e shkencës jetësore për brezat e ardhshëm, duke përfshirë natyrën e tyre gjenetike”

dhe komenton vet nenin.

Në dritën e këtyre fakteve, Mësimdhënësi fton klasën të rishikojnë zgjidhjet e bëra më parë dhe të ndryshojnë ato nëse vlerësohet e nevojshme. Në këtë fazë, Mësimdhënësi udhëheqë diskutimin.

Claudio Todesco
todesco50@libero.it



NJËSIA 52

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 16: Mbrojtja e gjeneratave të ardhshme

Ndikimit të shkencave të jetës në gjeneratat e ardhshme, duke përfshirë edhe ndikimin në përbërjen e tyre gjenetike, duhet t'i jepet vëmendje e duhur.

Titulli

“Ruajtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e brezave të ardhshëm”

Objektivat e mësim-nxënies

- Nxitja e nxënësve për të reflektuar mbi jetën dhe mjedisin e tyre, për njohjen e padrejtësisë, mënjanimin e rrezikut, marrjen e përgjegjësisë, për të kërkuar bashkëpunim, dhe për të demonstruar moral, e cila na mundëson që të zhvillojmë më tej parimet etike;
- Ngritja e vetëdijes për pjesën e rëndësishme të luajtur nga bashkësia ndërkombëtare në vendosjen e parimeve universale që sigurojnë një bazë për përgjigjen e njerëzimit ndaj dilemave gjithnjë e më të ngutshme dhe polemikave që shkenca dhe teknologjia paraqesin për racën njerëzore dhe mjedisin;
- Vetëdijesimi për faktin se qeniet njerëzore janë pjesë përbërëse e biosferës, që kanë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e njëri-tjetrit si dhe format tjera të jetës dhe në ruajtjen e planetit për brezat e ardhshëm.

Rasti

Historia e Ishullit të Pashkëve

“Në fund të mijëvjeçarit të parë, kur njerëzit shkelën në të, Ishulli i Pashkëve ishte një tokë e lulëzuar e mbuluar me pyje, me burime të pasura ushqimore nga toka, deti dhe ajri. Në të banonin disa mijëra njerëz, të ndarë në dymbëdhjetë klane që jetonin së bashku në paqe. Kur lundruesit e parë evropianë zbarkuan aty, ata gjetën një tokë djerrinë si në ditët e sotme: krejtësisht e shpyllëzuar me tokë shterpë, ku vetëm disa qindra njerëz kishin mbijetuar me vështirësi. Enigma e Ishullit të Pashkëve, sipas shkencëtarëve që u përpoqën ta zgjidhin atë, është një alegori ogurzezë për atë se si vetë shoqëritë mund të shkatërrojnë të ardhmen e tyre për iluzione të madhështisë dhe mosparashikimit. Rrërimi thuhet kryesisht të ketë rrjedhur për shkak të shpyllëzimit, gjegjësisht shkatërrimit të burimit kryesor natyror në të cilin bazohej jeta e ishullit. “nel-nome-dei-figli-se-il-diritto-ha-il- dovere-di- pensare-al-futuro/ Gustavo Zagrebelsky

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

Historia e Ishullit të Pashkëve është një paralajmërim. Ajo nuk flet vetëm për polinezianët që kanë jetuar njëmijë vjet më parë. Ajo flet për ne: shfrytëzimi e paplanifikuar të resurseve me efektet shkatërruese për brezat që vijnë.

Si mund ta përmbledhim tregimin e Ishullit të Pashkëve në një fjali? Për të kënaqur orekset e të sotmes, nuk u kushtohet vëmendje nevojave të së nesërme. A ka vepruar secila gjeneratë

sikur ajo të ishte e fundit, duke trajtuar burimet natyrore sikur të ishin pronarët e vetëm? A kanë mundur ato të përdoren dhe keqpërdoren me vullnetin e tyre? A duhet të merremi sot me ruajtjen ndër breza? A janë njerëzit e sotshëm dhe të nesërm të pajisur me të njëjtat të drejta për respekt të barabartë sepse dinjiteti i tyre është i barabartë me tonin? Historia e Ishullit të Pashkëve na detyron të pyesim veten dhe për detyrat tona.

Puna do të kryhet duke përdorur metodologji aktive dhe eksperimentale, duke promovuar mundësitë interaktive me pjesëmarrësit.

Metoda e mësimdhënies nuk do të jetë teorike dhe abstrakte, por përkundrazi do të përfshijë një “laborator të përvojave” dhe “strategji arsimore” nëpërmjet:

- luftimit të problemeve në lidhje me situatat reale
- punës në grupe në mënyrë bashkëpunuese
- mbledhjes së të dhënave dhe formulimit të hipotezave
- ndarjes së përvojave arsimore.


Ueb-faqja e internetit do të përdoret si: 1) arkiv për të punuar me materiale mësimore; 2) një redaktues për mbledhjen dhe shtypjen e materialeve në letër; 3) Një mjet i komunikimit të menjëhershëm midis nxënësve dhe mes nxënësve dhe arsimtarëve (blog, email, Skype, etj.).

Për lexim

- Ese mbi shkatërrimin e Civilizimit në ishullin e Pashkëve - Clio 92 www.clio92.it/public/.../DIAMOND_PASQUA_COLLASSO.pdf
- www.libertaegiustizia.it/.../nel-nome-dei-figli-se-il-diritto-ha-il-dovere-di-pensare-al-futuro/ Gustavo Zagrebelsky
- www.youtube.com/watch?v=oktdSO-j3Vc the history of things.

Ida Appignani

idaappignani@gmail.com




Deklarata Universale mbi Bio-etikën dhe të Drejtat e Njeriut
[UNESCO, 2005]

Parimi nr. 17

Mbrojtja e Mjedisit, Biosferës dhe Biodiversitetit

Vëmendje e duhur duhet t'i jepet ndërlidhjes ndërmjet qenieve njerëzore dhe formave tjera të jetës, rëndësisë dhe qasjes së duhur dhe shfrytëzimit të burimeve biologjike dhe gjenetike, respektimit të njohurive tradicionale dhe rolit të qenieve njerëzore në mbrojtjen e mjedisit, biosferës dhe biodiversitetit.



NJËSIA 53

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 17: Mbrojtja e Mjedisit, Biosferës dhe Biodiversitetit

Vëmendje e duhur duhet t'i jepet ndërlidhjes ndërmjet qenieve njerëzore dhe formave tjera të jetës, rëndësisë dhe qasjes së duhur dhe shfrytëzimit të burimeve biologjike dhe gjenetike, respektimit të njohurive tradicionale dhe rolit të qenieve njerëzore në mbrojtjen e mjedisit, biosferës dhe biodiversitetit.

Titulli

“Ta ndajmë bukën”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë se mjedisi përbëhet nga lloje të ndryshme të kafshëve, dhe se kafshët kanë të drejta, dhe se këto të drejta duhet të respektohen.

Rasti

Afër shtëpisë sonë, gjendet një lis i madh. Mua më pëlqen të ulem nën degët e tij. Nganjëherë, unë shtrihen nën hijen e tij dhe ëndërroj, lexoj apo i shikoj zogjtë, ketrat dhe milingonat nën këmbët e mia. Më së shumti më pëlqen t'i shikojë këto milingona të imëta dhe të zeza duke punuar pa nda prej mëngjesit e deri në mbrëmje. Ato i kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në një çarje nën një gur të madh. Ato që hynin në atë plasaritje mbanin kokrra drithi në gojët e tyre; mendoj se ishin kokrra orizi. Ato që dilnin nga ajo plasaritje nuk bartnin asgjë. Ato tashmë i kishin vendosur kokrrat në vrimë dhe nxitonin të sillnin kokrra tjera.

“Prej nga po e sjellin këtë ushqim të çmueshëm?” e pyetja veten. Vendosa ta përcjellë këtë rresht të gjatë e të zi të milingonave. Iu bashkova karvanit të milingonave hap pas hapi duke pasur kujdes të mos i shkelë. Ato ngjiteshin mbi gurë, i binin rrotull shkurreve dhe pemëve. U shkoja pas, duke shikuar në tokë. Nuk e vura re se kishim arritur drejtë në shtëpinë time. Milingonat ishin në dysHEME, duke kaluar nëpër një vrimë në dollapin e ushqimeve.

“Ku ke qene?” e dëgjova zërin e nënës papritur.

“Sh ... sh ... sh ...” i pëshpërita, “mos i trazo ato, vetëm shikoji shokët e mi”.

“Çfarë shokësh?” pyeti nëna. Pastaj, papritmas ajo i pa milingonat në raftin e dollapit të ushqimeve. Ajo vrapoi në kuzhinë dhe u kthye me kanaçe insekticidi. “Jo, mami! Mos i spërkat! Këto janë milingonat e mia.

“Ato po u sjellin ushqim bebeve të tyre”, thashë unë. “Nuk i dua milingonat në shtëpinë tonë”, tha nëna ime. “Dje e kam blerë këtë oriz për ne”. “Jo, jo, mos i spërkat”, iu luta unë. “Kush është më i rëndësishëm?”, pyeti nëna ime, “ne apo milingonat”? Unë nuk dija çfarë përgjigje t'i jap. Më duhet të mendoj për këtë, më duhet të gjejë një zgjidhje.

Nëna e mori torbën e shqyer me oriz dhe e vendosi pranë rrethojës së kopshtit. “Kjo është për milingonat e tua”, tha ajo. Unë i mblodha milingonat nga dollapi i ushqimit dhe i çova tek torba. “Merrni ushqim për bebet tuaja” u thashë, “por mos hyni në shtëpinë tonë më”. Nëna

ime i pastroi raftet dhe më dërgoi në shitore për të blerë një qese me oriz. Unë e bleva qesen, u ktheva në shtëpi dhe e luta nënën që ta ndajmë orizin me milingonat e mia.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë një diskutim duke i paraqitur pyetje të tilla si në vijim:

- A ka milingonat në shtëpinë tuaj?
- Si i trajtoni ato?
- A i keni parë se nga vijnë?
- Çfarë ushqimi hanë milingonat?
- Ku rrinë milingonat gjatë dimrit?
- Çfarë mund të mësojmë nga milingonat?
- A duhet të hedhim helm në milingona? Pse?

Udhëzim: Dil nga shtëpia, kërkoji milingonat, përcillni disa nga ato dhe na tregoni se çfarë keni parë?

Çfarë keni zbuluar?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 54

Grup mosha I: 3 – 5 vjet

Parimi etik nr. 17: Mbrojtja e Mjedisit, Biosferës dhe Biodiversitetit

Vëmendje e duhur duhet t'i jepet ndërlidhjes ndërmjet qenieve njerëzore dhe formave tjera të jetës, rëndësisë dhe qasjes së duhur dhe shfrytëzimit të burimeve biologjike dhe gjenetike, respektimit të njohurive tradicionale dhe rolit të qenieve njerëzore në mbrojtjen e mjedisit, biosferës dhe biodiversitetit.

Titulli

“Breshka në kuti”

Objektivat e mësim-nxënies

Fëmijët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë se mjedisi përbëhet nga lloje të ndryshme të kafshëve, dhe se kafshët kanë të drejta, dhe se këto të drejta duhet të respektohen.

Rasti

“Sally! Koha është për ta kosit lëndinë. Merre kositësin e vogël dhe fillo nga puna!”. Nëna ime më tha, deri sa unë luaja me qenin tim Bonny.

E mora kositësin tim të vogël dhe doli në kopsht. Qeni im Bonny më erdhi pas, duke kërcyer dhe duke lehur në diçka të fshehur në kopsht. U afrova dhe pashë diçka të rrumbullakët dhe gri duke u zvarritur nëpër barin e gjelbër. U afrova edhe më shumë dhe u befasova! Ishte një breshkë e vogël duke lëvizur zvarrë ngadalë. Vrapova në shtëpi duke e thirrur vëllain, motrën dhe prindërit: “Breshka, breshka në kopshtin tonë” thirra me zë të lartë. Fëmijët e fqinjëve tanë e dëgjuan britmën time dhe erdhën me vrap në kopshtin tonë të parë breshkën. Breshka u ndalë dhe u fsheh në guaskën e saj. “Dil jashtë! Dil jashtë!” ne e lutëm. Por breshka nuk tregonte shenja jete. “Ajo po frikësohet”, tha babai im. “Vetëm mos bëni zhurmë!”. Lizi, motra ime, propozoi që ta mbajmë breshkën e vogël në një kuti të madhe, ta ushqejmë dhe të luajmë me të. Ajo solli nga prapa shtëpisë një kuti të madhe kartoni dhe me kujdes e vendosi breshkën në të. Fqinjët tanë vrapuan në shtëpinë e tyre dhe sollën karota, gjethet, copa buke ujë në një pjatë të vogël. Lizi i vendosi të gjitha ushqimet rreth breshkës së vogël. Ne të gjithë u ulëm rreth kutisë, në pritje të lëvizjeve të breshkës.

Ne pritëm një kohë të gjatë, por breshka nuk lëvizte dhe nuk tregonte asnjë shenjë jete. Ne ishim të zhgënjyer. Babai im na shikonte. “Mendoj”, tha ai, “se breshka dëshiron të kthehet në familjen e saj. Ajo me gjasë e ka humbur rrugën e vetë, dhe nuk do të donte ta kalojë jetën në një kuti kartoni, po ju?”. “A duhet ta kthejmë atje ku edhe e kemi gjetur?” pyeta unë. Disa fëmijë nuk u pajtuan me mua, por motra ime Lizi nuk u kushtoi vëmendje. Ajo me kujdes e mori breshkën dhe u largua nga kopshti. Të gjithë fëmijët i shkuan pas, disa prej tyre ishin të zemëruar, e disa ishin të lumtur. “Hesht!”, tha ajo duke e lëshuar breshkën në shkurre. Të gjithë heshtën duke pritur të ndodhë diçka. Papritmas, ne pamë një kokë dhe katër këmbët duke dalë nga guaca. Breshka filloi të lëvizë dhe pas pak u zhduk. Ne ishim të sigurt se ajo ishte shumë e lumtur.

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi duhet ta zhvillojë një diskutim duke i paraqitur pyetje të tilla si në vijim:

- A ke hasur ndonjëherë në breshkë?
- Çfarë ke bërë në atë rast?
- Çfarë ha breshka?
- A është e drejtë të mbahet breshka në kuti?
- Cili është dallimi ndërmjet adoptimit të një qeni dhe adoptimit të një breshke?
- Pse ishte breshka e pikëlluar në kuti?

Pse ishte breshka e lumtur kur u kthye në shkurre?

Hanna Carmi
amnoncarmi@gmail.com



NJËSIA 55

Grup mosha III: 11 – 14 vjet

Parimi etik nr. 17: Mbrojtja e Mjedisit, Biosferës dhe Biodiversitetit

Vëmendje e duhur duhet t'i jepet ndërlidhjes ndërmjet qenieve njerëzore dhe formave tjera të jetës, rëndësisë dhe qasjes së duhur dhe shfrytëzimit të burimeve biologjike dhe gjenetike, respektimit të njohurive tradicionale dhe rolit të qenieve njerëzore në mbrojtjen e mjedisit, biosferës dhe biodiversitetit.

Titulli

“Loja e jetës në botë”

Objektivat e mësim-nxënies

- krijimi i një loje interaktive për të edukuar dhe argëtuar nxënësit
- mësimi më me lehtësi i rregullave themelore të edukimit mjedisor
- përqendrimi në konceptin e përgjegjësisë sociale “si një objektiv themelor i veprimit njerëzor në të gjitha nivelet”

Lojërat

Mësimdhënësi vazhdon me formimin e katër ekipeve: secilit prej tyre do të i caktohet një element i natyrës (ajri, uji, toka apo zjarri), lehtë të dallueshëm për nga ngjyrat e tyre përkatëse. Një arsimtar që udhëheqë lojën do të ofrojë për të gjitha ekipet shumë shenja që tregojnë origjinën e mbeturinave të ndryshme: pjesëmarrësit do të duhet të zgjedhin llojet e mbeturinave që bashkëveprojnë dhe kanë të bëjnë me një element themelor të natyrës që ato përfaqësojnë. Në lojën e parë, sa më shpejt të jetë e mundur nxënësit do të përmendin numrin më të madh të produkteve që kalojnë “nga mbeturinat shtëpiake në materiale të reja të ripërdorura dhe të ricikluara” dhe ngjarjet më të dëmshme të shkaktuara nga mungesa e respektit apo rregullat e ruajtjes, të tilla si derdhjet industriale të hedhura në lumenj dhe përrenj, mos-riciklimi i qelqit apo plastikës, etj. Në lojën e dytë, dy ekipet që kanë marrë pikët më të larta në lojën e parë do të garojnë kundër njëri-tjetrit duke shkruar një tekst ilustrues, si një skenë e thjeshtë teatrale dhe/ose kabare, apo edhe një video - spot që zgjatë 180 sekonda. Përmbajtja e tij, me mbështetjen e arsimtarëve të përfshirë, mund të tërheqin vëmendjen ndaj disa sjelljeve dhe si rrjedhojë për përparësitë dhe/ose mangësitë e ndryshme për mbledhjen e mbeturinave organike dhe shkarkimin nga burimet industriale, duke theksuar përfitimet e ciklit efektiv të mbeturinave, potencialin e tyre për mjedisin tonë, dhe përparësitë e tyre për ruajtje të hapësirës sonë për banim.” Një juri do të zgjidhet sipas rastit në mesin e nxënësve që u përkasin ekipeve që tashmë kanë marrë pjesë në lojën e parë. Në fund, juria do të zgjedhë mes katër teksteve më kreative që do të prezantohen. Njëri prej tyre do të shpërblehet dhe do të marrë një çmim/titulli si më i miri në lëndën mësimore.

Metodologjia e mësimdhënies


Dilema

Nga zhvillimet e shpejta në shkencë dhe teknologji janë paraqitur dilemat etike, duke krijuar një kontrast midis efekteve të dobishme dhe të dëmshme të këtyre avancimeve për njeriun si dhe ambientin e tij natyror. Është e domosdoshme që të ekzistojë një këndvështrim i përgjithshëm që shkon përtej kufijve kombëtar dhe që themelon parime të njohura botërisht. Debat i krijuar nga ky artikull ka një vlerë të lartë edukative për nxënësit, varësisht nga secila rrugë e mësim-nxënies, e cila mund të mbështetet nga letërsia klasike dhe moderne dhe kontributi i filmit dhe teatrit. Por ajo që është më interesante janë përgjigjet e nxënësve ndaj pyetjeve, mendimet e brezit të sotëm të ri, “njohësit e fushës digjitale”, të cilët një mënyrë të re të të menduarit për vet arsimtarët. Është me rëndësi përqendrimi në hulumtimin në një mënyrë që është sa më e gjerë dhe e hollësishme që është e mundur, duke nënvizuar konceptin e “intervenimit njerëzor në hapësirën e tij jetësore, duke qenë vet ai, si përdorues dhe përfitues, një pjesë përbërëse e tij.” Qëllimi kryesor është të jepen shumë më tepër të dhëna në mënyrë që të nxitet aftësia e thjeshtë por ekzistuese e fëmijës për të arsyetuar, duke orientuar debatin drejt zbatimit të parimeve etike. Në këtë kuptim, Deklarata e UNESCO-s lë një hapësirë për ndërtimin e një forme realiste të “shtetësisë”. Rëndësia e një kurrikule të përbashkët mes shteteve anëtare të UNESCO-s është e nevojshme, edhe në qoftë se secili shtet ka mundësinë e miratimit të teksteve të veta ligjore dhe i zbaton ato sipas kulturës së vet, me qëllim të përcaktimit të “sundimit të duhur ligjor”.

Falë lojës në ekip dhe simulimit të nxënësve me elementet natyrore, materialet e studiuara dhe produktet e ricikluara nxisin fëmijët të shprehin mendimet origjinale dhe të dalin me zgjidhje të mundshme për problemin e dhënë. Elementi krijues i lojës testuese ofron një efekt pastrues, është mjaft edukativ dhe promovon një kohezion të madh në mesin e nxënësve. Por mbi të gjitha, mund të ndriçojë një vetëdije të natyrshme që të rinjtë kanë lidhur me obligimet e njerëzimit për të përdorur burimet e tokës me përgjegjësi.

Mësimdhënësi prezanton një debat të hapur mbi vlerën e nenit 17 të deklaratës së UNESCO-s për mbrojtjen e mjedisit dhe hapësirën e jetesës përmes edukimit mjedisor. Mësimdhënësi njofton nxënësit për ekzistimin e krimeve ndaj mjedisit, duke u ndalur tek koncepti i “materialeve organike dhe produkteve të krijuara nga njeriu”. Kështu nxënësit do të marrin pjesë në një proces logjik për fitimin e njohurive shkencore që lidhen me ndotjen e ujit nëntokësor, tokës, ajrit dhe pasojat shkatërruese që rezultojnë në rritjen e lartë të sëmundjeve vdekjeprurëse, duke qenë aspekti më i dëmshëm se këto sëmundje mund të depërtojnë tek përbërja gjenetike e individit dhe të kalojnë tek brezat e ardhshëm.

Francesca Piccolo
francescapiccolo90@gmail.com



NJËSIA 56

Grup mosha IV: 15 – 19 vjet

Parimi etik nr. 17: Mbrojtja e Mjedisit, Biosferës dhe Biodiversitetit

Vëmendje e duhur duhet t'i jepet ndërlidhjes ndërmjet qenieve njerëzore dhe formave tjera të jetës, rëndësisë dhe qasjes së duhur dhe shfrytëzimit të burimeve biologjike dhe gjenetike, respektimit të njohurive tradicionale dhe rolit të qenieve njerëzore në mbrojtjen e mjedisit, biosferës dhe biodiversitetit.

Titulli

“Ta shpëtojmë planetin tonë”

Objektivat e mësim-nxënies

- Të theksohet rëndësia e parimit të masave paraprake për mbrojtjen e mjedisit, si një udhëzues për zhvillimin shkencor dhe teknologjik, si dhe për transformimin social, ekonomik dhe mjedisor.
- Të reflektojmë lidhur me jetën tonë në mjedisin që na rrethon.
- Të paraqitet roli i rëndësishëm që e luan komuniteti ndërkombëtar në vendosjen e parimeve universale që sigurojnë një bazë për reagimin e njerëzimit ndaj dilemave gjithnjë në rritje dhe polemikave që shkenca dhe teknologjia i ballafaqon qeniet njerëzore dhe mjedisin tonë.
- Të pranohet që shëndeti nuk varet vetëm nga zhvillimi i hulumtimeve shkencore dhe teknologjike, por edhe nga faktorët psiko-social dhe kulturor: e drejta për një mjedis të shëndetshëm nënkuptohet si pjesë e të drejtës për shëndet.

Rasti

Katastrofa mjedisore në Gjirin e Meksikës e shkaktuar platformën për shpimet e thella nënujore të naftës. 20 prill 2010, ora 9:47 para dite, Gjiri i Meksikës.

Platforma për shpime të thella nënujore të naftës kishte shpërthyer duke shkaktuar katastrofën më të madhe mjedisore në historinë e SHBA-ve. Për shkak të shpërthimit, e gjithë struktura e ndryshoi pozicionin e vetë, dhe përfundimisht u fundos pasi që tubat si pasojë e lëvizjes, tërheqjes dhe shtrembërimit u shkatërruan dhe vaji filloi të derdhet në det pandërprerë.

Pas operacionit të parë të shpëtimit - 11 të vdekur dhe 115 punëtorë të lënduar - e gjithë vëmendja ishte përqendruar në ndaljen e rrjedhjes masive të naftës së papërpunuar që dilte nga rezervuari me një kapacitet prej rreth 10 milion litra në ditë.

Derdhja të naftës u ndërpre më 19 shtator të atij viti. Pasojat mjedisore, ekonomike dhe shëndetësore që pasuan kanë qenë të mëdha dhe shumë serioze.

Metodologjia e mësimdhënies

Dilema

- A kufizohemi shpesh vetëm në pastrimin e fatkeqësive?

- A janë bërë shoqëritë tona të varura nga rreziku ekstrem?
- A ka një plan rezervë?

Ne kemi vënë në praktikë parimin parandalues, parimin që na kujton se jeta është tepër e çmuar për ta vënë në rrezik në emër të çfarëdo profiti.

Metodologjia pedagogjike do të jetë aktive dhe eksperimentale në mënyrë që të ofrojë mjete interaktive për pjesëmarrësit.

Metoda e mësimdhënies nuk do të jetë teorike dhe abstrakte, por do të përbëhet në një “laborator të përvojave” dhe në “strategjitë arsimore” nëpërmjet:

- punës për t’i zgjidhur problemet që lidhen me situata reale;
- punën në grupe që duhet të bashkëpunojnë;
- mbledhjen e të dhënave dhe formulimin e hipotezave;
- ndarjen e përvojave arsimore.

Ueb-faqja do të përdoret si: 1) një arkiv për ruajtjen e materialeve mësimore; 2) një redaktor për të mbledhur dhe shtypur materialet në letër; 3) një mjet i komunikimit të menjëhershëm ndërmjet nxënësve dhe ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve (blogu, emaili, skype, etj).

Ida Appignani
idaappignani@gmail.com



TABELA E PËRMBAJTJEVE

Plan programi i parë për arsimin e të rinjve në bio-etikë - Hyrje

4

NJËSIA 1	Kutia e sekreteve (Neni 3)	3-5 vjet	7
NJËSIA 2	Arti & llojet tjera (Neni 3)	3-5 vjet	10
NJËSIA 3	Giogiò dhe qentë e tij (Neni 3)	3-5 vjet	13
NJËSIA 4	Një tregim fantastik-shkencor (Art. 3)	11—14 vjet	15
NJËSIA 5	Ruleti rus: të drejtat e mohuara në CDA (Neni 3)	11—14 vjet	17
NJËSIA 6	Gjithë çfarë dua është arsimimi (Neni 3)	15—19 vjet	20
NJËSIA 7	Muzika dhe vallëzimet nga mbarë bota (Neni 4)	3—5 vjet	24
NJËSIA 8	Ëndrra e madhe e Pasit dhe Tatit (Neni 4)	6 —10 vjet	26
NJËSIA 9	Pasqyra: të mësojmë të komunikojmë (Neni 5)	3 —5 vjet	29
NJËSIA 10	Ishulli: mesazhi në shishe (Neni 5)	3 —5 vjet	31
NJËSIA 11	Ora e rërës (Neni 5)	6 —10 vjet	34
NJËSIA 12	Për t’u ndjerë mirë, çdo gjë varet nga unë (Neni 5)	15—19 vjet	36
NJËSIA 13	Pjetri i guximshëm (Neni 6)	3 —5 vjet	39
NJËSIA 14	Unë vendosi vet (Neni 6)	3 —5 vjet	41
NJËSIA 15	Pëlqimi i informuar, e drejta e zgjedhjes (Neni 6)	11—14 vjet	43
NJËSIA 16	Panairi i librave të përdorura (Neni 6)	11 —14 vjet	45
NJËSIA 17	Çfarë ndodhi me flokët e Sofisë? (Neni 7)	3 —5 vjet	48
NJËSIA 18	Lejleku në çati (Neni 7)	3 —5 vjet	50
NJËSIA 19	Nuk po të shoh, por po të ndjejë (Neni 7)	11 —14 vjet	52
NJËSIA 20	Autizmi — një mënyrë e re e komunikimit (Neni 7)	15—19 vjet	55
NJËSIA 21	Dhe nëse vendosi t’ia falë veshkën vëllait tim (Neni 7)	15—19 vjet	58
NJËSIA 22	Bota e gjelbër (Neni 8)	3 —5 vjet	62

NJËSIA 23	Partoshi nuk ka shokë (Neni 8)	3 —5 vjet	64
NJËSIA 24	Në vendin e Woodland (Neni 8)	3 —5 vjet	66
NJËSIA 25	]Fëmija i ndarë në dysh (Neni 8)	6 —10 vjet	68
NJËSIA 26	Në kërkim të dritës... (Neni 8)	6 —10 vjet	70
NJËSIA 27	Një vendim i dhembshëm (Neni 8)	11 —14 vjet	72
NJËSIA 28	Qepe që të jetë e pastër (Neni 8)	15—19 vjet	74
NJËSIA 29	Gjithëpërfshirja, parim themelor i të jetuarit së bashku (Neni 8)	15—19 vjet	76
NJËSIA 30	Shkallët e drejtësisë (Neni 10)	3 —5 vjet	86
NJËSIA 31	Udhëtimi me tepih fluturues (Neni 10)	6 —10 vjet	89
NJËSIA 32	Barazia, drejtësia dhe paanshmëria (Neni 10)	11 —14 vjet	91
NJËSIA 33	Sjellja e njëjtë: ndëshkimi i njëjtë? (Neni 10)	11 —14 vjet	93
NJËSIA 34	Unë, si qenie njerëzore (Neni 10)	15—19 vjet	95
NJËSIA 35	Macja ime e vogël e kuqërremtë (Neni 11)	3 —5 vjet	98
NJËSIA 36	Tjetri ndryshe nga ti (Neni 11)	3 —5 vjet	100
NJËSIA 37	Cili është ndëshkimi i duhur i cili duhet të caktohet? (Neni 11)	11 —14 vjet	102
NJËSIA 38	A është e drejtë të bëhet ai udhëtim shkollor?” (Neni 11)	11 —14 vjet	104
NJËSIA 39	Flamujt (Neni 12)	6 —10 vjet	107
NJËSIA 40	Një nxënës i huaj i është bashkuar klasës tuaj (Neni 12)	11 —14 vjet	109
NJËSIA 41	Ejani të luajmë për të njohur njëri tjetrin (Neni 12)	11 —14 vjet	112
NJËSIA 42	Diversiteti kulturor është pasuri në jetën e secilit (Neni 12)	15—19 vjet	114
NJËSIA 43	Duaje vetveten (Neni 13)	3 —5 vjet	118
NJËSIA 44	Vendi i ngjyrave (Neni 12)	3 —5 vjet	121
NJËSIA 45	Siguria në rrugë (Neni 13)	6 —10 vjet	123
NJËSIA 46	Ne të gjithë jemi Ditta (Neni 13)	6 —10 vjet	126

NJËSIA 47	Bashkëpunimi (Neni 13)	6 —10 vjet	128
NJËSIA 48	Solidariteti dhe bashkëpunimi (Neni 13)	11 —14 vjet	130
NJËSIA 49	A e ka marrë ai vendimin e duhur? (Neni 12)	11 —14 vjet	132
NJËSIA 50	Tregimi i myslimanëve që shpëtuan hebrenjtë (Neni 13)	15—19 vjet	134
NJËSIA 51	A mundet një zbulim shkencor me të vërtetë të zgjidhë një problem të madh që prekë nierëzimin? (Neni 16)	11 —14 vjet	137
NJËSIA 52	Ruajtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e brezave të ardhshëm (Neni 16)	15—19 vjet	139
NJËSIA 53	Ta ndajmë bukën (Neni 17)	3 —5 vjet	142
NJËSIA 54	Breshka në kuti (Neni 17)	3 —5 vjet	144
NJËSIA 55	Loja e jetës në botë (Neni 17)	11 —14 vjet	146
NJËSIA 56	Ta shpëtojmë planetin tonë (Neni 17)	15—19 vjet	148

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes apo të transmetohet në çfarëdo formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, fotokopjim mekanik, incizim ose përndryshe, pa lejen paraprake me shkrim dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i UNESCO-s për Bio-etikë (Haifa). Si rregull, leja do të jepet për shqyrtim, abstraksionit, riprodhim dhe përkthim të këtij botimi, pjesërisht ose në tërësi, por jo për shitje e as për përdorim për qëllime komerciale, dhe i nënshtrohet njohjes së botimit origjinal nga Kryesuesi i UNESCO-s për Bio-etikë (Haifa).

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ekskluzivisht përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjen e UNESCO-s, Kryesuesit të UNESCO-s në Haifa, apo organizatave tjera me të cilat ata bashkëpunojnë. E drejta e autorit: Kryesuesi i UNESCO-s për Bio-etikë (Haifa).

Prof. Amnon Carmi

Udhëheqës i Njesisë së Bioetikës së UNESCO-s (Haifa)

Kryeredaktor

amnoncarmi@gmail.com

SEKRETARIATI REDAKTUES

Alessandra Pentone, International Adviser

firstsyllabus@gmail.com

